

Kapitulli 1. Konceptet bazë të ekonomikut. Kërkesa dhe oferta. Ekuilibri në treg. Elasticiteti.

Pyetja 1

Mikroekonomia I referohet:

- A) Studimit të fenomenit ekonomik në kontekstin agregat
- B) Njësive individuale ekonomike dhe vendimeve të tyre
- C) Politikave qeveritare për stabilizimin e ekonomisë
- D) Tregut ndërkombëtar dhe normës së këmbimit

Pyetja 2

Kosto oportune përcaktohet më mirë si :

- A) Kosto totale e prodhimit të një të mire apo shërbimi
- B) Kosto shtesë e prodhimit të një njësi më shumë nga një e mirë
- C) Vlera e alternativës më të mirë nga e cila është hequr dorë pasi vendimi është marrë
- D) Kosto e lëndës së parë të përdorur në procesin e prodhimit

Pyetja 3

Cilat nga të mëposhtmet konsiderohet faktor prodhimi:

- A) Puna
- B) Paraja
- C) Kapitali financiar
- D) Norma e interesit

Pyetja 4

Aftësia sipërmarrëse përfshin:

- A) Përpjekjet fizike dhe mendore të individëve të përfshirë në aktivitete prodhuese
- B) Aftësia për të qënë inovator, për të marrë rreziqe dhe për të organizuar burime për të krijuar sipërmarrje të reja biznesi
- C) Burimet natyrore si minerale, pyje dhe uji
- D) Fondet e përdorura për investime në makineri dhe pajisje

Pyetja 5

Në një situatë ku një kompani duhet të zgjedhë midis zgjerimit të kapacitetit të saj të prodhues dhe investimit në trajnimin e punonjësve, kjo vendimarrje përbën:

- A) Pamjaftueshmëri
- B) Kosto oportune
- C) Shkëmbim (trade-off)
- D) Makroekonomi

Pyetja 6

Ekonomiksi është studimi se si:

- A) Biznesmenët mund të jenë menaxherë më të mirë
- B) Njerëzit zhvillojnë institucionet për të shpërndarë burimet e kufizuara
- C) Individët, firmat dhe qeveritë bëjnë zgjedhje optimale ndërmjet një grupi alternativash me të cilat përballen në kushtet e burimeve të pamjaftueshme
- D) Faktorët që çojnë në mungesë dhe si mund të reduktohet kjo mungesë

Pyetja 7

Nëse shpërndarja e dhomave të konviktit realizohet nga tregu, e cila është e ndryshne nga shpërndarja me short atëherë kemi të bëjmë:

- A) Me një problem të pamjaftueshmërisë
- B) Me një problem politik por jo problem ekonomik
- C) Me një problem social por jo problem ekonomik
- D) Problemi i shpërndarjes është ende një problem ekonomik

Pyetja 8

Efiçenca ekonomike ekziston kur:

- A) Një shoqëri vuan nga padrejtësia ekonomike
- B) Nuk ekziston mundësia që dikush të fitojë pa humbur dikush tjetër
- C) Më shumë output mund të prodhohet me kosto më të ulët
- D) Sigurohen përfitime neto për një kosto të specifikuar

Pyetja 9

Faktorët e prodhimit në një ekonomi të komanduar zotërohen nga:

- A) Qeveria
- B) Konsumatori
- C) Biznesi
- D) Familja

Pyetja 10

Ekonomiksi është studimi i situatave ku:

- A) Njerëzit kanë burime të kufizuara
- B) Mungesa nuk është problem
- C) Individët nuk kanë zgjidhje tjetër veçse të ndjekin këshillat e korporatave të mëdha dhe qeverisë.
- D) Individët marrin vendime të gabuara që nuk janë në interesin e tyre

Pyetja 11

Shkëmbimi i mallrave ose shërbimeve në një treg të lirë ka të ngjarë të rrisë mirëqenien e të dyja palëve sepse

- A) Shumica e individëve në një ekonomi të tregut të lirë mund të marrin atë që duan
- B) Në tregjet e lira shkëmbimi është vullnetar
- C) Shkëmbimi i lirë eliminon varfërinë
- D) Në tregjet e lira individët priren të njohin njerëzit me të cilët tregtojnë

Pyetja 12

Fakti që burimet janë të rralla nënkupton që kurba e mundësive të prodhimit:

- A) Do të ketë pjerrësi negative
- B) Do të jetë një vijë e drejtë
- C) Do të zhvendoset me kalimin e kohës
- D) Do të ketë një formë të mysët ndaj origjinës

Pyetja 13

Cila nga alternativat e mëposhtme do të shkaktojë një zhvendosje djathtas të kurbës së mundësive të prodhimit?

- A) Një rritje e të ardhurave të konsumatorit
- B) Një rritje e eksporteve
- C) Një rritje e produktivitetit të punës
- D) Një ulje e të ardhurave të konsumatorit

Pyetja 14

Kosto oportune për një student që ndjek universitetin është:

- A) E barabartë me pagën që do të përfitojë kur të diplomohet
- B) E barabartë me shpenzimet gjatë viteve të studimit
- C) Alternativa më e mirë nga e cila ka hequr dorë për studimet
- D) E barabartë me kostot e shprehura dhe të nënkuptuara

Pyetja 15

Ekonomiksi është studimi i:

- A) Teknologjisë së prodhimit
- B) Vendimeve të konsumit
- C) Si vendos shoqëria se çfarë, si dhe për kë të prodhojë
- D) Mënyrës më të mirë për të drejtuar shoqërinë

Pyetja 16

Kosto oportune e një të mire është:

- A) Koha e humbur për ta gjetur atë në treg
- B) Sasia e mallrave të tjera të sakrifikuara për të marrë një njësi më shumë nga ai produkt
- C) Shpenzimet për të blerë të mirën në treg
- D) Humbja e interesit për përdorimin e kursimeve

Pyetja 17

Një treg mund të përshkruhet saktësisht si:

- A) Një vend për të blerë të mira dhe shërbime
- B) Një vend për të shitur të mira
- C) Procesi me të cilin çmimet përshtaten për të harmonizuar shpërndarjen e burimeve
- D) Një vend ku takohen blerësit dhe shitësit

Pyetja 18

Në një treg të lirë:

- A) Qeveritë ndërhyjnë
- B) Qeveritë planifikojnë prodhimin
- C) Qeveritë vendosin çmimet
- D) Çmimet përshtaten për të përshtatur mungesën me dëshirat

Pyetja 19

Në ekonomitë mikse:

- A) Problemet ekonomike zgjidhen nga qeveria dhe tregu
- B) Vendimet ekonomike merren nga sektori privat dhe tregu i lirë
- C) Shpërndarja ekonomike arrihet nga dora e padukshme
- D) Çështjet ekonomike zgjidhen nga qeveria

Pyetja 20

Makroekonomia është studimi i:

- A) Sjelljes individuale në ekonomi
- B) Marrëdhënieve ndërmjet sektorëve të ndryshëm të ekonomisë
- C) Vendimeve për blerjet familjare
- D) Ekonomisë në tërësi

Pyetja 21

Ekonomiksi supozon se njerëzit konsumojnë mallra dhe shërbime për të arritur

- A) Status social
- B) Mirëqenie
- C) Dobishmëri
- D) Vetëvlerësim

Pyetja 22

Puna si faktor prodhimi përfshin:

- A) Aftësitë fizike dhe mendore të individëve të përfshirë në aktivitete prodhuese
- B) Aftësia për të qënë inovator, për të marrë rreziqe dhe për të organizuar burime për të krijuar sipërmarrje të reja biznesi
- C) Burimet natyrore si minerale, pyje dhe uji

D) Fondet e përdorura për investime në makineri dhe pajisje

Pyetja 23

Toka si faktor prodhimi përfshin:

- A) Aftësitë fizike dhe mendore të individëve të përfshirë në aktivitete prodhuese
- B) Aftësia për të qënë inovator, për të marrë rreziqe dhe për të organizuar burime për të krijuar sipërmarrje të reja biznesi
- C) Burimet natyrore si minerale, pyje dhe truall ndërtimi
- D) Investimet në makineri dhe pajisje

Pyetja 24

Çmimi ekuilibër i faktorëve të prodhimit në një ekonomi të tregut vendosen nga:

- A) Qeveria
- B) Konsumatori
- C) Biznesi
- D) Tregu nëpërmjet bashkëveprimit të kërkesë dhe ofertës

Pyetja 25

Cila nga alternativat e mëposhtme do të shkaktojë një zhvendosje majtas të kurbës së mundësive të prodhimit?

- A) Një ulje e të ardhurave të konsumatorit
- B) Një rritje e importeve
- C) Një rritje e produktivitetit të punës
- D) Një përkeqësim teknologjik

Pyetja 26

Ekonomia nuk po prodhon në maksimumin e mundshëm. Kjo ndodh kur:

- A) Produktet nuk po prodhohen me një teknologji eficiente
- B) Produktet po prodhohen me një teknologji eficiente
- C) Të ardhurat e konsumatorëve janë reduktuar
- D) Të ardhurat e prodhuesve janë rritur

Pyetja 27

Kurba e mundësive të prodhimit do të zhvendoset nëse:

- A) Forcat e punës dyfishohen
- B) Oferta monetare dyfishohet
- C) Oferta monetare bie
- D) Të ardhurat e konsumatorit rriten

Pyetja 28

Burimi më i madh i të ardhurave familjare është:

- A) Dividenti nga aksionet
- B) Pagat
- C) Fitimet nga interesi
- D) Të ardhurat nga qiraja

Pyetja 29

Pamjaftueshmëria është situata në të cilën:

- A) Dëshirat janë të pakufizuara ndërsa burimet të kufizuara
- B) Njerëzit janë të varfër
- C) Në treg ka mungesë të produktit
- D) Në kushtet e mungesës sasia e kërkuar është më e madhe se sasia e ofruar

Pyetja 30

Një ekonomi mund të prodhojë:

- A) Vetëm në kufirin e mundësive të prodhimit
- B) Në çdo pikë brenda ose jashtë kufirit të mundësive të prodhimit
- C) Në çdo pikë poshtë dhe në kufirin e mundësive të prodhimit
- D) Vetëm në pikat poshtë kufirin të mundësive të prodhimit

Pyetja 31

Kur shohim se kërkesa për një produkt rritet, kjo nënkupton se:

- A) Kurba e kërkesës për produktin është zhvendosur në të majtë
- B) Produkti është mall normal
- C) Çmimi është rritur dhe konsumatori do të blejë më pak nga produkti
- D) Konsumatorët janë në gjëndje dhe dëshirojnë të blejnë më tepër për çdo çmim të dhënë të mundshëm.

Pyetja 32

Nëse të gjithë faktorët e tjerë mbahen konstantë, cila nga alternativat e mëposhtme do të zhvendoste majtas kurbën e kërkesës për benzinë:

- A) Zbulimi i rezervave të reja të naftës
- B) Zhvillimi i automobilave elektrikë me kosto të ulët
- C) Rritja e çmimit të transportit ajror dhe hekurudhor
- D) Rënia e madhe në çmimin e automobilave

Pyetja 33


Kurba e kërkesës do të zhvendoset nëse kemi ndryshime në:

- A) Shijet dhe preferencat e konsumatorit
- B) Rritjen e PBB

- C) Çmimin e mallit
- D) Të ardhurat e ofruesit

Pyetja 34

Jemi në tregun e mishit të viçit. Cila nga shprehjet e mëposhtme mund të ketë shkaktuar ndryshimin e paraqitur në grafik?



- A) Konsumatorët kanë përjetuar rritje të të ardhurave, ndërkohë që është përmirësuar edhe teknologjia e prodhimit të mishit
- B) Çmimi i mishit të pulës është rritur
- C) Studimet e reja mjekësore dëshmojnë që ekziston një lidhje negative midis konsumit të mishit dhe jetëgjatësisë.
- D) Kurba e kërkesës për mish duhet të jetë me pjerrësi positive.

Pyetja 35

Nëse çmimi i karburanteve ulet me 4%, atëherë në tregun e makinave mund të pritët që:

- A) Oferta e makinave të rritet
- B) Oferta e makinave të ulet
- C) Kërkesa e makinave të rritet
- D) Kërkesa e makinave të ulet

Pyetja 36

Kurba e kërkesës për një produkt do të zhvendoset nëse kemi ndryshime në:

- A) Sasinë e produktit të prodhuar
- B) Çmimin e mallit
- C) Çmimin e faktorit punë
- D) Masën ose shpërndarjen e të ardhurave kombëtare

Pyetja 37

Nëse çmimi i karburanteve rritet me 6%, atëherë në tregun e makinave mund të pritët që:

- A) Oferta e makinave të rritet
- B) Oferta e makinave të ulet

- C) Kërkesa e makinave të rritet
- D) Kërkesa e makinave të ulet

Pyetja 38

Kërkesa dhe oferta për sheqer paraqiten në tabelë si më poshtë. Niveli i sasisë dhe i çmimit në ekuilibër është përkatësisht në kordinatat: (milion ton)

Çmimi	Sasia e kërkuar	Sasia e ofruar
18	1	5
17	2	4
16	3	3
15	4	2
14	5	1

- A) (3,3)
- B) (3;16)
- C) (4;17)
- D) (16;16)

Pyetja 39

Kërkesa dhe oferta për sheqer paraqiten në tabelë si më poshtë. Teprica konsumatore që përftohet nga blerja e mallit me cmimin e tregut është : (milion ton)

Çmimi	Sasia e kërkuar	Sasia e ofruar
18	1	5
17	2	4
16	3	3
15	4	2
14	5	1

- A) 1 lekë
- B) 2 lekë
- C) 3 lekë
- D) 4 lekë

Pyetja 40

Një kurbë e ofertës së tregut përmbledh informacionin rreth:

- A) Sasisë totale të shitur.
- B) Mënyrës së prodhimit.
- C) Sasi të shitura në çdo periudhë kohore të kaluar dhe të ardhshme.
- D) Gadishmërisë së ofruesve për të shitur sasi të ndryshme me çmime të ndryshme.

Pyetja 41

Supozoni se çmimi ekuilibër i baguettes (bukës) në Francë është 2 €, por qeveria franceze vendos një çmimi tavan prej 1 € për baguette. Një arsye e rëndësishme pse kjo është joefikase mund të jetë:

- A) Konsumatorët që marrin këtë lloj buke, mund t'i vlerësojnë më pak se ata që nuk i marrin
- B) Çmimi tavan bën që çmimi i shitjes me shumicë të baguettes të rritet
- C) Do të prodhohen shumë bukë.
- D) Një pjesë e tepricës do të transferohet nga prodhuesit te konsumatorët.


Pyetja 42

Kërkesa për një mall përcaktohet nga:

- A) Ata që blejnë mallra dhe shërbime
- B) Qeveria
- C) Prodhuesit që prodhojnë këto mallra dhe shërbime
- D) Ata që ofrojnë lëndën e parë për prodhimin e tyre

Pyetja 43

Supozojmë se qeveria vendos tax \$10 për cdo njësi të mallit të shitur. Paga e taksës ndahet midis konsumatorit dhe ofruesit në masën:



- A) 50% konsumatori, 50% ofruesi
- B) 60% konsumatori, 40% ofruesi
- C) 40% konsumatori, 60% ofruesi
- D) 30% konsumatori, 70% ofruesi

Pyetja 44

Nëse malli A dhe B janë plotësues të njëri-tjetrit në konsum, ulja e çmimit të mallit A do të sjellë:

- A) Zhvendosjen në të djathtë të kurbës së ofertës për mallin B;
- B) Zhvendosjen në të djathtë të kurbës së kërkesës për mallin B;
- C) Zhvendosjen në të majtë të kurbës së ofertës për mallin B;
- D) Zhvendosjen në të majtë të kurbës së kërkesës për mallin B.

Pyetja 45

Nëse në një treg konkurues, sasia e ofruar është më e madhe se sasia e kërkuar, atëherë:

- A) Çmimi i tregut do të ulet
- B) Çmimi i tregut do të rritet
- C) Konsumatorët do të kërkojnë më shumë produkte
- D) Ofruesit do të ulin sasinë e produkteve të ofruara në treg

Pyetja 46

Cila nga thëniet e mëposhtme është e saktë për kurbën individuale të ofertës:

- A) Mund të jetë me pjerrësi negative
- B) Shpreh lidhjen negative ndërmjet çmimit dhe sasisë së kërkuar
- C) Marrëdhënia ndërmjet çmimit dhe sasisë së ofruar është pozitive
- D) Sasia e ofruar nuk varet nga çmimi i produktit

Pyetja 47

Çmimi i një produkti do të tentojë të bjerë nëse:

- A) Për çmimin aktual ka një tepriçë
- B) Çmimi aktual është i barabartë me çmimin ekuilibër
- C) Për çmimin aktual sasia e kërkuar është më e madhe se sasia e ofruar
- D) Çmimi aktual është nën çmimin ekuilibër

Pyetja 48

Një rritje në të ardhurat e konsumatorit do të rrisë kërkesën për një _____ por do të ulë kërkesën për një _____

- A) Të mirë zëvendësuese në konsum, të mirë inferiore
- B) Të mirë normale, të mirë inferiore
- C) Të mirë inferiore, të mirë normale
- D) Të mirë normale, të mirë plotësuese në konsum

Pyetja 49

Nëse rritja e çmimit të mallit A rrit sasinë e kërkuar për mallin B kur çmimi i B nuk ka ndryshuar, atëherë malli B është:

- A) Zëvendësues në konsum i mallit A
- B) Plotësues në konsum i mallit A
- C) E mirë normale
- D) E mirë inferiore

Pyetja 50

Në qoftë se kërkesa dhe oferta për një mall rriten njëkohësisht në të njëjtën masë atëherë:

- A) Çmimi do të rritet
- B) Sasia do të rritet, çmimi do të mbetet i pandryshuar

- C) Sasia do të ulet, çmimi do të mbetet i pandryshuar
- D) Nuk kemi informacion të mjaftueshëm për zhvendosjet

Pyetja 51

Në qoftë se kërkesa dhe oferta për një mall ulen njëkohësisht atëherë:

- A) Çmimi do të rritet
- B) Sasia do të rritet
- C) Çmimi do të mbetet i pandryshuar
- D) Nuk kemi informacion të mjaftueshëm për zhvendosjet

Pyetja 52

Kërkesa e tregut për një mall është e ndikuar nga:

- A) Të ardhurat e konsumatorit
- B) Çmimi i mallit
- C) Ndryshimi i çmimit të faktorit punë
- D) Ndryshimet teknologjike

Pyetja 53

Çmimi i mallit do të tentojë të bjerë nëse:

- A) Për çmimin aktual kemi një tepicë
- B) Për çmimin aktual kemi një mungesë
- C) Çmimi aktual është i barabartë me çmimin ekuilibër
- D) Për çmimin korrent sasia e kërkuar është më e madhe se sasia e ofruar

Pyetja 54

Marrim në shqyrtim tregun e bukës. Në qoftë se çmimi i miellit ulet, atëherë mund të pritët që:

- A) Oferta për bukë të rritet
- B) Oferta për bukë të ulet
- C) Kërkesa për bukë të rritet
- D) Kërkesa për bukë të ulet

Pyetja 55

Kur shohim që kërkesa për një produkt rritet, ne mendojmë që:

- A) Kurba e kërkesës për produktin është zhvendosur në të majtë
- B) Çmimi është rritur dhe konsumatori do të blejë më pak nga produkti
- C) Produkti është mall normal
- D) Konsumatorët janë në gjendje dhe dëshirojnë të blejnë më shumë për çdo çmim të dhënë

Pyetja 56

Kur shohim se kërkesa për një produkt bie, kjo nënkupton se:

- A) Kurba e kërkesës për produktin është zhvendosur në të majtë

- B) Produkti është një e mirë normale
- C) Çmimi është rritur dhe konsumatori do të blejë më pak nga produkti
- D) Konsumatorët janë në gjendje dhe dëshirojnë të blejnë më tepër për çdo çmim të dhënë të mundshëm

Pyetja 57

Nëse çmimi i makinave rritet me 2%, atëherë në tregun e makinave mund të pritët që:

- A) Oferta e makinave të rritet
- B) Oferta e makinave të ulët
- C) Kërkesa e makinave të rritet
- D) Kërkesa dhe oferta për makina të mos ndryshojnë

Pyetja 58

Një ulje në të ardhurat e konsumatorit do të rrisë kërkesën për një _____ por do të ulë kërkesën për një _____

- A) Të mirë zëvendësuese në konsum, të mirë inferiore
- B) Të mirë normale, të mirë inferiore
- C) Të mirë inferiore, të mirë normale
- D) Të mirë normale, të mirë plotësuese në konsum

Pyetja 59

Kërkesa shpreh:

- A) Dëshirat e pakufizuara të konsumatorëve
- B) Marrëdhënien midis sasisë së kërkuar dhe çmimit për një mall
- C) Gadishmërinë për të paguar për një mall nëse të ardhurat janë rritur
- D) Aftësia për të paguar

Pyetja 60

Kur ne njohim sasinë e produktit që njerëzit janë të gatshëm dhe në gjendje të blejnë në çdo çmim të dhënë atëherë ne njohim:

- A) Kërkesën
- B) Ofertën
- C) Sasinë e kërkuar
- D) Sasinë e tepruar

Pyetja 61

Kur ne njohim sasinë e produktit që ofruesit janë të gatshëm dhe në gjendje të ofrojnë në çdo çmim të dhënë atëherë ne njohim:

- A) Kërkesën
- B) Ofertën
- C) Sasinë e kërkuar

D) Sasinë e tepruar

Pyetja 62

Kurba e kërkesës për celularë do të _____ , nëse parashikohet një ulje e çmimit të tyre në të ardhmen:

- A) Ulet
- B) Rritet
- C) Rritet fillimisht pastaj ulet
- D) Mbetet e pandryshuar

Pyetja 63

Në qoftë se një e mirë është inferiore, atëherë rritja e të ardhurave të konsumatorit do të çonte në:

- A) Rritjen e kërkesës për këtë të mirë
- B) Uljen e kërkesës për këtë të mirë
- C) Lëvizjen nga lart-poshtë në kurbën e kërkesës
- D) Lëvizjen nga poshtë-lart në kurbën e kërkesës

Pyetja 64

Ana ka mbetur pa punë, dhe blen më pak libra për të lexuar. Kjo do të thotë se libri është:

- A) E mirë luksi
- B) E mirë normale
- C) E mirë inferiore
- D) E mirë plotësuese

Pyetja 65

Nëse çmimi i një të mire rritet nga 4 në 6 lek, atëherë përqindja e ndryshimit në çmim është:

- A) 25%
- B) 30%
- C) 50%
- D) 75%

Pyetja 66

Nëse çmimi i një të mire ulet nga 6 në 4 lek, atëherë përqindja e ndryshimit në çmim është:

- A) 25.5%
- B) 33.3%
- C) 50%
- D) 75%

Pyetja 67

Një prodhues prodhon në tokën e tij mollë dhe limona. Nëse çmimi i mollëve rritet, ndërsa i limonave nuk ndryshon, atëherë fermeri:

- A) Do të prodhojë më shumë mollë e më pak limona
- B) Do të prodhojë më shumë limona e më pak mollë
- C) Do të prodhojë më shumë mollë dhe më shumë limona
- D) Do të shesë më shumë nga të dy produktet

Pyetja 68

Nëse shteti vendos një taksë mbi prodhuesin, atëherë në treg:

- A) Kërkesa do të rritet
- B) Kërkesa do të ulet
- C) Oferta do të rritet
- D) Oferta do të ulet

Pyetja 69

Nëse shteti vendos një taksë mbi prodhuesin, atëherë në treg:

- A) Çmimi dhe sasia ekuilibër do të rriten
- B) Çmimi dhe sasia ekuilibër do të ulen
- C) Çmimi do të rritet dhe sasia ekuilibër do të ulet
- D) Çmimi do të ulet dhe sasia ekuilibër do të rritet

Pyetja 70

Nëse shteti vendos një taksë mbi të ardhurat e konsumatorit, atëherë në treg:

- A) Kërkesa do të rritet
- B) Kërkesa do të ulet
- C) Oferta do të rritet
- D) Oferta do të ulet

Pyetja 71

Kur çmimi i fast - food është 1.50 dollarë secili, çdo ditë shiten 500 sanduiçë. Pasi çmimi bie në 1,35 dollarë secili, 510 sanduiçë shiten çdo ditë. Sa është elasticiteti i kërkesës në lidhje me çmimin për këtë produkt?

- A) -0.18
- B) 1.8
- C) 1
- D) -0,015

Pyetja 72

Nëse elasticiteti i ofertës në lidhje me çmimi për shërbimin celular është 3, një rritje prej 20% e çmimit do të bëjë që sasia e ofruar të rritet me:

- A) 3%
- B) 20%
- C) 6.67%
- D) 60%

Pyetja 73

Si ndikon koha në elasticitetin e kërkesës në lidhje me çmimin?

- A) Më shumë kohë shkakton një elasticitet më të madh të kërkesës.
- B) Koha nuk ndikon në elasticitetin e kërkesës.
- C) Një periudhë më e shkurtër kohe shkakton një elasticitet më të madh të kërkesës.
- D) Koha nuk është faktor i rëndësishëm për elasticitetin e kërkesës.

Pyetja 74

Cila thënie interpreton më mirë një koeficient elasticiteti të kërkesës 0.5?

- A) % e ndryshimit në sasinë e kërkuar është sa $\frac{1}{2}$ e % së ndryshimit në çmimin e produktit
- B) % e ndryshimit në sasinë e kërkuar është sa 2-fish i % së ndryshimit në çmimin e produktit
- C) % e ndryshimit në sasinë e kërkuar është e barabartë me % e ndryshimit në çmimin e produktit
- D) % e ndryshimit në sasinë e kërkuar është 0 ndërsa % e ndryshimit në çmimin e produktit është 1%

Pyetja 75

Një produkt me elasticitet të kërkesës -2 do të thotë që:

- A) Sasia e kërkuar zvogëlohet me 2% kur çmimi rritet me 1%.
- B) Sasia e kërkuar rritet me 2% kur çmimi rritet me 1%.
- C) Sasia e kërkuar nuk ndryshon kur çmimi ndryshon.
- D) Sasia e kërkuar rritet 2 herë më shumë sesa rritet çmimi

Pyetja 76

Cila prej këtyre shprehjeve paraqet një elasticitet të kërkesës të barabartë me zero?

- A) Koeficienti i elasticitetit të kërkesës në lidhje me çmimin është -0.5.
- B) Sasia e kërkuar është e pandryshuar me ndryshimin e çmimit.
- C) Sasia e kërkuar rritet kur çmimi rritet.
- D) Sasia e kërkuar zvogëlohet kur çmimi rritet, por jo shumë.

Pyetja 77

Elasticiteti i tërthortë i kërkesës për dy mallra që janë plotësues është:

- A) Zero
- B) Infinit
- C) Negativ

D) Positiv

Pyetja 78

Kur çmimi i i të mirës Y bien nga 2 \$ në 1.9 \$, sasia e kërkuar për Y rritet nga 110 në 118. Mund të arrijmë në përfundimin se elasticiteti i kërkesës në lidhje me cmimin është:

- A) -1.37
- B) -4.00
- C) -2.9
- D) -3.94

Pyetja 79

Fakti që molla ka dardhën një zëvendësues të afërt në konsum, e bën:

- A) Ofertën për mollë më elastike;
- B) Ofertën për mollë më pak elastike;
- C) Kërkesën për mollë më elastike;
- D) Kërkesën për mollë më pak elastike

Pyetja 80

Në qoftë se një mall e ka kërkesën elastike, atëherë:

- A) Një rritje 10% në çmimin e mallit shkakton një rritje 5% në sasinë e kërkuar;
- B) Një rritje 10% në çmimin e mallit shkakton një rritje 1% në sasinë e kërkuar;
- C) Një rritje 10% në çmimin e mallit shkakton një rënie 15% në sasinë e kërkuar;
- D) Një rritje 10% në çmimin e mallit shkakton një rënie 10% në sasinë e kërkuar.

Pyetja 81

Kur qeveria vendos një çmim dysHEME për një mall të caktuar, atëherë sasia e ofruar:

- A) Do të jetë më e vogël se sasia e ekuilibrit, ndërsa çmimi do të jetë më i vogël se çmimi i ekuilibrit;
- B) Do të jetë më e vogël se sasia e ekuilibrit, ndërsa çmimi do të jetë më i lartë se çmimi i ekuilibrit;
- C) Do të jetë më e madhe se sasia e ekuilibrit, ndërsa çmimi do të jetë më i vogël se çmimi i ekuilibrit;
- D) Do të jetë më e madhe se sasia e ekuilibrit, ndërsa çmimi do të jetë më i lartë se çmimi i ekuilibrit.

Pyetja 82

Në tregun e biçikletave, çmimi ka ndryshuar nga 50 euro në 100 euro dhe sasia ka ndryshuar nga 20 në 80 biçikleta në ditë. Në bazë të këtyre të dhënave rezulton se:

- A) Kërkesa për biçikleta është elastike
- B) Oferta për biçikleta është inelastike
- C) Kërkesa për produktin ka elasticitet unitar

D) Oferta për produktin ka elasticitet unitar

Pyetja 83

Produktet, kërkesa e të cilave rritet kur të ardhurat rriten, quhen:

- A) Të mira plotësuese
- B) Të mira zëvendësuese
- C) Të mira inferiore
- D) Të mira normale

Pyetja 84

Nëse elasticiteti i kërkesës në lidhje me çmimin për një produkt është -2 , kjo do të thotë se:

- A) Një ulje prej 10% e çmimit çon në një ulje prej 20% të sasisë së kërkuar
- B) Një rritje prej 2% në çmim çon në një ulje prej 1% të sasisë së kërkuar
- C) Kërkesa është plotësisht elastike
- D) Kërkesa është plotësisht joelastike

Pyetja 85

Elasticiteti i të kërkesës në lidhje me të ardhurat llogaritet:

- A) Reagimin e konsumatorit ndaj ndryshimit në të ardhurat e tij
- B) Reagimin e konsumatorit në sasinë e kërkuar ndaj ndryshimit në çmim
- C) Reagimin e ofruesit ndaj ndryshimit të të ardhurave të tij
- D) Reagimin e ofruesit ndaj ndryshimit në çmim

Pyetja 86

Elasticiteti i kërkesës në lidhje me çmimin:

- A) Mat reagimin e sasisë së kërkuar ndaj ndryshimit të çmimit
- A) Tregon sa larg zhvendoset një kurbë kërkesë
- B) Tregon një ndryshim në çmim
- C) Tregon një ndryshim në sasinë e kërkuar

Pyetja 87

Një koeficient elasticiteti i tërthortë i kërkesës pozitiv sygjeron që mallrat janë _____ dhe një koeficient elasticiteti i tërthortë i kërkesës negativ sygjeron që mallrat janë _____

- A) Zëvendësues, inferiorë
- B) Normale, plotësues të njëri tjetrit
- C) Zëvendësues, plotësues të njëri tjetrit
- D) Normale, inferiore

Pyetja 88

Nëse të ardhurat tuaja dyfishohen dhe çmimet e mallrave që blini dyfishohen, atëherë kërkesa juaj për këto mallra ka të ngjarë _____

- A) Të rritet
- B) Të mos ndryshojë
- C) Të ulet
- D) Të zhvendoset djathtas lart

Pyetja 89

Shtimi i sasisë së kërkuar për një mall nga konsumatorë të ndryshëm për të njëjtin çmim na jep

- A) Kurbën e ofertës individuale
- B) Kurbën e kërkesës së tregut
- C) Kurbën e kërkesës individuale
- D) Kurbën e ofertës së tregut

Pyetja 90

Nëse egziston një numër i madh firmash që shesin një produkt homogjen, kurba e kërkesës individuale të firmës është:

- A) Me elasticitet unitar
- B) Joelastike
- C) Plotësisht joelastike
- D) Plotësisht elastike

Pyetja 91

Nëse çmimi rritet përgjatë pjesës joelastike të një kurbe kërkesë lineare, atëherë të ardhurat totale do të:

- A) Rriten
- B) Mbeten të pandryshuara
- C) Ulen
- D) Bëhen 0

Pyetja 92

Nëse çmimi rritet përgjatë pjesës elastike të një kurbe kërkesë lineare, atëherë të ardhurat totale do të:

- A) Rriten
- B) Mbeten të pandryshuara
- C) Ulen
- D) Bëhen 0

Pyetja 93

Nëse 30% rritje në të ardhurat e konsumatorëve, çon në 20% rënie të sasisë së kërkuar për fast-food, kur kushtet e tjera të tregut nuk ndryshojnë, atëherë fast food është:

- A) E mirë normale
- B) E mirë luksi
- C) E mirë inferiore
- D) Ka zëvendësues të afërt në konsum

Pyetja 94

Shteti vendos një takse mbi prodhuesin në masën 5 lek për çdo njësi të shitur mbi mallin X.

Taksën do e paguaj komplet konsumatori nëse:

- A) Kërkesa dhe oferta kanë elasticitet të njëjtë
- B) Kërkesa është plotësisht inelastike
- C) Kërkesa është plotësisht elastike
- D) Oferta është plotësisht inelastike

Pyetja 95

Supozojmë se malli X ka një ofertë plotësisht elastike. Nëse çmimi i mallit Y zëvendësues me X në konsum, do të rritet, atëherë rezulton që:

- A) Të ardhurat totale të shitësit të mallit X do të bien
- B) Të ardhurat totale të shitësit të mallit X do të rriten
- C) Çmimi i mallit X do të rritet
- D) Sasia e kërkuar e mallit X do të bjerë
- E)

Pyetja 96

Supozojmë se malli X ka një ofertë plotësisht inelastike. Nëse çmimi i mallit Y zëvendësues me X në konsum, do të bjerë, atëherë rezulton që:

- A) Të ardhurat totale të shitësit të mallit X do të bien
- B) Të ardhurat totale të shitësit të mallit X do të rriten
- C) Çmimi i mallit X do të rritet
- D) Sasia e kërkuar e mallit X do të bjerë

Pyetja 97

Përcaktuesi kryesor i elasticitetit të ofertës për një produkt është:

- A) Numri i të mirave zëvendësuese që ka ky produkt
- B) Gjatësia e kohës që kanë në dispozicion prodhuesi për tëu përshtatur ndryshimit të çmimit
- C) Fakti nëse produkti është e mirë e domosdoshme apo luksi
- D) Pesha që zë në buxhetin e individit blerja e këtij produkti

Pyetja 98

Përcaktuesi kryesor i elasticitetit të kërkesës për një produkt është:

- A) Numri i të mirave zëvendësuese që ka ky produkt
- B) Gjatësia e kohës që kanë në dispozicion prodhuesi për t'iu përshtatur ndryshimit të çmimit
- C) Fakti nëse produkti është e mirë e normale apo inferiore
- D) Pësia që zë në buxhetin e ofruesit blerja e faktorëve të prodhimit

Pyetja 99

Një kurbë oferte plotësisht inelastike është:

- A) Me pjerrësi pozitive
- B) Me pjerrësi negative
- C) Horizontale me boshtin e sasisë
- D) Vertikale me boshtin e sasisë

Pyetja 100

Një kurbë kërkesë plotësisht elastike është:

- A) Me pjerrësi pozitive
- B) Me pjerrësi negative
- C) Horizontale me boshtin e sasisë
- D) Vertikale me boshtin e sasisë

Kapitulli 2. Sjellja konsumatore. Prodhimi dhe kostot e prodhimit

Pyetja 1

Jepen këto të dhëna: të ardhurat konsumatorit janë $m=15$ lekë, ndërsa cmimet e produkteve janë $PA=5$ lekë dhe $PB=4$ lekë. Bazuar në këto të dhëna ekuacioni i vijës së buxhetit për këtë konsumator është :

- A) $5QA + 4QB = 20$
- B) $5QA + 4QB = 15$
- C) $PA + PB = 15$
- D) $PA QA - QB PB = 20$

Pyetja 2

Beni maksimizon dobinë e tij totale në konsumin e mandarinave dhe mollëve. Nëse dobia marxhinale e mandarinës së fundit të blerë nga ai është dyfishi i dobisë marxhinale të mollës së fundit të blerë po nga Beni, atëherë ne dimë me siguri se:

- A) Beni blen dy herë më shumë mandarina se mollë
- B) Beni blen dy herë më shumë mollë se mandarina
- C) Cmimi i një molle është sa dyfishi i cmimit të një mandarine
- D) Cmimi i një mandarine është sa dyfishi i cmimit të një molle

Pyetja 3

Dobia shtesë nga konsumimi i një njësie më shumë të një malli quhet

- A) Dobi marxhinale
- B) Dobi totale
- C) Produkt marxhinal
- D) Produkt total

Pyetja 4

Të ardhurat marxhinale janë _____ kur prodhimi është _____:

- A) Ndryshimi i të ardhurave mesatare, rritur
- B) Ndryshimi i të ardhurave totale, rritur me një njësi
- C) Ndryshimi i të ardhurave mesatare, rritur me një njësi
- D) Ndryshim në të ardhurat totale, rritur

Pyetja 5

Nëse çmimi i të mirës që matet në boshtin vertikal rritet, vija e buxhetit do të:

- A) Bëhet më e pjerrët
- B) Më e sheshtë
- C) Zhvendoset pararelisht djathtas
- D) Zhvendoset paralelisht majtas

Pyetja 6

Nëse çmimi i të mirës që matet në boshtin vertikal ulet, vija e buxhetit do të:

- A) Bëhet më e pjerrët
- B) Më e sheshtë
- C) Zhvendoset pararelisht djathtas
- D) Zhvendoset paralelisht majtas

Pyetja 7

Nëse të ardhurat e konsumatorit rriten, vija e buxhetit do të:

- A) Bëhet më e pjerrët
- B) Më e sheshtë
- C) Zhvendoset pararelisht djathtas
- D) Zhvendoset paralelisht majtas

Pyetja 8

Supozojmë se mollët maten në boshtin X dhe dardhat në boshtin Y. Norma marxhinale e zëvendësimit do të përcaktohet si:

- A) Raporti i çmimi të X ndaj çmimit të Y
- B) Raporti i çmimi të Y ndaj çmimit të X
- C) Pjerrësia e vijës së buxhetit

D) Raport i ndryshimit të sasisë së mollëve me sasinë e dardhevë kur çmimi ka ndryshuar

Pyetja 9

Kur konsumatori lëviz gjatë një kurbe indiference duke rritur konsumin e të mirës X, (e cila matet në boshtin horizontal), atëherë:

- A) Më shumë njësi të Y duhet të heqim dorë për te perfituar nje njësi shtesë të X
- B) Më pak Y duhet të heqim dorë për çdo njësi shtesë të X
- C) Çmimi relativ i X
- D) Çmimi relativ i Y

Pyetja 10

Dobia Marxhinale:

- A) Është shtesa e dobisë totale nga konsumi i një njësie shtesë të produktit, duke mbajtur konsumin e produkteve të tjera të pandryshuar
- B) Është shuma e dobive totale nga konsumi i një të mire
- C) Është e barabartë me koston marxhinale
- D) Është e barabartë me të ardhurat marxhinale

Pyetja 11

Kur çmimi i një produkti bie për një mall normal:

- A) Efektet e të ardhurave dhe zëvendësimit do të nxisin konsumatorët të blejnë më shumë produkt
- B) Efektet e të ardhurave dhe zëvendësimit do të nxitin konsumatorët të blejnë më pak produkt
- C) Efekti i zëvendësimit do të nxiti konsumatorët të blejnë më pak nga produktit dhe efekti i të ardhurave do t'i inkurajojë ata të blejnë më shumë.
- D) Efekti i zëvendësimit do të inkurajojë konsumatorët të blejnë më shumë nga produkti dhe efekti i të ardhurave do t'i inkurajojë ata të blejnë më pak.

Pyetja 12

Arsyeja pse efekti i zëvendësimit funksionon për të nxitur një konsumator që të blejë më pak nga ai produkt kur çmimi i tij rritet është:

- A) Janë rritur të ardhurat reale të konsumatorit
- B) Të ardhurat reale të konsumatorit janë ulur
- C) Produkti tani është relativisht më i shtrenjtë se më parë
- D) Produktet e tjera tani janë relativisht më të shtrenjta se sa ishin më parë

Pyetja 13

Ana konsumon vetëm dy produkte, pica dhe kafe. Të dyja janë mallra normale për Anën. Supozoni se çmimi i picës ulet. Konsumi i Anës për kafe do të:

- A) Rritet për shkak të efektit të të ardhurave
- B) Rritet për shkak të efektit të zëvendësimit

- C) Rritet për shkak të një koeficienti elasticiteti negativ në lidhje me të ardhurat
- D) Mbeten të pandryshuara, pasi elasticiteti në lidhje me të ardhurat për pica është më i madh se 0

Pyetja 14

Cila nga sa vijon përcakton dobinë marginale?

- A) Ndryshimi në dobinë totale pjesëtuar me çmimin e një produkti
- B) Sasia maksimale e kënaqësisë e përfituar nga konsumimi i një produkti
- C) Kënaqësia totale e marrë nga konsumimi i të gjithë produkteve që ka konsumatori në dispozicion për konsum
- D) Kënaqësia shtesë e marrë nga konsumimi i një njësie shtesë të një produkti

Pyetja 15

Cila shpreh më mirë ligjin e dobisë marxhinale rënëse?

- A) Sa më shumë konsumojmë nga një produkt, aq më e vogël është dobia totale dhe marxhinale
- B) Sa më pak konsumojmë nga një produkti, aq më e madhe është dobia totale dhe marxhinale
- C) Sa më shumë konsumojmë nga një produkt, aq më e vogël është dobia marxhinale nga konsumimi i një njësie shtesë
- D) Sa më shumë konsumojmë nga një produkt, aq më e vogël është dobia totale nga konsumi i këtij produkti

Pyetja 16

Cila situatë është në përputhje me ligjin e dobisë marginale rënëse?

- A) Sa më shumë kafe të pijë Henri, aq më shumë shijon një kafe shtesë
- B) Sa më shumë kafe të pijë Henri, aq më pak shijon një kafë shtesë
- C) Dobia marginale e Henrit nga konsumi i kafes bëhet pozitive te kafja e tretë
- D) Dobia marginale e Henrit nga konsumi i kafes arrin maksimumin kur dobia totale është zero

Pyetja 17

Kur fëmijët refuzojnë të konsumojnë fast-food atëherë mund të themi se dobia marxhinale nga konsumi i këtij produkti është:

- A) Zero
- B) Pozitive, por në rënie
- C) Negative
- D) Më e vogël se dobia totale

Pyetja 18

Kur dobia marxhinale është në rënie, por pozitive, dobia totale është:

- A) Duke u rritur por me një normë rënëse
- B) Duke u rritur me një normë rritëse
- C) Duke rënë por me një normë rënëse
- D) Duke rënë por me një normë rritëse

Pyetja 19

Një konsumator me të ardhura fikse do të maksimizojë dobinë e tij totale në konsumin e dy mallrave A dhe B kur:

- A) Dobia totale është e njëjtë për çdo të mirë
- B) Dobia marxhinale e çdo të mire është maksimizuar
- C) Dobia marxhinale për çdo njësi monetare të shpenzuar është e njëjtë për të dy mallrat
- D) Dobia marxhinale për çdo njësi monetare të shpenzuar maksimizohet për çdo mall

Pyetja 20

Nëse një konsumator racional është në ekuilibër në konsumin e dy produkteve, atëherë:

- A) Dobia marxhinale e përftuar nga një produkt është e barabartë me dobinë marxhinale
- B) të marrë nga produkti tjetër
- C) Një rishpërndarje e të ardhurave do të rriste dobinë totale të konsumatorit
- D) Dobia totale bëhet zero
- E) Dobia marxhinale për çdo njësi monetare të shpenzuar është e njëjtë për të dy mallrat

Pyetja 21

Një konsumator është në ekuilibër dhe po i shpenzon të ardhurat në mënyrë të tillë që dobia marxhinale e produktit X është 40 njësi dhe Y është 16 njësi. Çmimi për njësi i X është 5 lekë. Çmimi i Y do të jetë:

- A) 1 lekë
- B) 2 lekë
- C) 3 lekë
- D) 4 lekë

Pyetja 22

Cili është një shpjegim përse kurba e kërkesës është me pjerrësi negative?

- A) Të mirat normale
- B) Ligji i ofertës
- C) Ligji i dobisë marginale rënëse
- D) Ligji i rritjes së kostos oportune

Pyetja 23

Një pikë konsumi brenda vijës së buxhetit:

- A) Tregon se konsumatori i shpenzon të ardhurat vetëm për njërin prej produkteve

- B) Tregon se konsumatori ka zgjedhur të shpenzojë të gjitha të ardhurat e tij për të dy produktet
- C) Është e përballeshme dhe për shkak se është brenda vijës buxhetore, do të thotë se i gjithë buxheti i personit është shpenzuar.
- D) Tregon kombinimet e mundshme të dy produkteve që mund të blejë konsumatori me një sasi të caktuar të ardhurash.

Pyetja 24

Një vijë buxheti:

- A) Ka një pjerrësi të barabartë me çmimin relativ
- B) Tregon kufijtë e asaj që mund të prodhohet
- C) Rrotullohet ose zhvendoset vetëm kur ndryshon buxheti i konsumatorit
- D) Zhvendoset paralelisht kur ndryshon çmimi i produkteve të konsumuara

Pyetja 25

Supozoni se një konsumator ka 100 dollarë për të shpenzuar për dy mallra, këpucë dhe këmisha. Nëse çmimi i një palë këpucë është 20 dollarë dhe çmimi i një këmishë është 15 dollarë, cili nga kombinimet e mëposhtme është i papërballeshëm për konsumatorin?

- A) 2 palë këpucë dhe 4 këmisha
- B) 5 palë këpucë dhe 0 këmisha
- C) 0 palë këpucë dhe 7 këmisha
- D) 2 palë këpucë dhe 3 këmisha

Pyetja 26

Cila nga sa vijon përshkruan se çfarë ndodh me vijën e buxhetit të një konsumatori nëse kemi një rritje të të ardhurave të tij?:

- A) Vija e buxhetit bëhet më e pjerrët
- B) Vija e buxhetit zhvendoset djathtas lart
- C) Vija e buxhetit nuk ndryshon
- D) Bëhet horizontale

Pyetja 27

Tedi blen ushqim për macen e tij. Nëse çmimi i ushqimit për mace bie (ushqimi i maceve është në boshtin x), atëherë vija e buxhetit të Tedit do të:

- A) Rrotullohet nga jashtë dhe pjerrësia e saj do të ndryshojë
- B) Zhvendoset nga brenda dhe pjerrësia e saj nuk do të ndryshojë
- C) Zhvendoset nga jashtë dhe pjerrësia e saj nuk do të ndryshojë
- D) Rrotullohet nga brenda dhe pjerrësia e saj do të ndryshojë

Pyetja 28

Kurba e kërkesës për arra braziliane është me pjerrësi negative. Kjo pjerrësi është për shkak se konsumatorët maksimizojnë dobinë e tyre dhe një rritje në çmimin e arrave çon në:

- A) Asnjë ndryshim në sasinë e kërkuar.
- B) Zhvendosje lart të vijës së buxhetit pa asnjë ndryshim në pjerrësinë e tyre
- C) Një ulje të dobisë marxhinale për lek të shpenzuar
- D) Një rritje të dobisë marxhinale për lek të shpenzuar

Pyetja 29

Ne mund të përdorim teorinë marxhinale të dobisë për të gjeneruar kurbën e kërkesës duke ndryshuar:

- A) Vetëm çmimet e të dy mallrave
- B) Vetëm çmimin e një malli
- C) Të ardhurat dhe çmimet e të dy mallrave
- D) Vetëm të ardhura

Pyetja 30

Një çmim relativ është:

- A) Çmimi i një malli pjesëtuar me çmimin e një tjetri
- B) Çmimi absolut i një malli.
- C) Çmimi i një malli zëvendësues
- D) Çmimi i një malli shumëzuar me çmimin e një tjetri

Pyetja 31

Përfitimi marginal nga konsumimi i një njësie shtesë të një malli:

- A) Duhet të jetë e barabartë me koston marxhinale ose njësia nuk do të konsumohet
- B) Duhet të jetë më pak se kostoja marxhinale ose njësia nuk do të konsumohet
- C) Është e barabartë me rritjen e përfitimeve totale nga konsumimi i njësisë shtesë
- D) Është e barabartë me përfitimin total të përftuar nga konsumi i të gjitha njësive të mëparshme

Pyetja 32

Cili nga pohimet për kostot afatshkurter është i vërtetë kur firma rrit prodhimin e saj:

- A) ATC rritet
- B) TC ulet
- C) MC në fillim rritet dhe pastaj ulet
- D) AFC ulet gjithmonë

Pyetja 33

Cili nga pohimet është i vërtetë kur firma ul prodhimin e saj:

- A) ATC rritet

- B) TC ulet
- C) MC në fillim rritet dhe pastaj ulet
- D) AFC rritet gjithmone

Pyetja 34

Sasia maksimale e produktit që do të prodhojë firma, nga përdorimi i faktorëve të prodhimit quhet:

- A) Funkzioni i ofertës
- B) Funkzioni i prodhimit
- C) Funkzioni i kërkesës
- D) Funkzioni i këmbimit.

Pyetja 35

Tabela e mëposhtme tregon funksionin e prodhimit të një firme që vepron në periudhë afatshkurtër. Nëse puna është faktor i ndryshueshëm dhe kapitali faktor i fiksuar, pas cilit punëtor fillon të veprojë ligji i të ardhurave marxhinale rënëse?

L	0	1	2	3	4	5	6	7
TP	0	10	22	35	43	50	50	48

- A) Pas punëtorit të parë;
- B) Pas punëtorit të dytë;
- C) Pas punëtorit të tretë;
- D) Pas punëtorit të katërt.

Pyetja 36

Tabela e mëposhtme tregon funksionin e prodhimit të një firme që vepron në periudhë afatshkurtër. Nëse puna është faktor i ndryshueshëm dhe kapitali faktor i fiksuar, produkti marxhinal i punëtorit të 4 është:

L	0	1	2	3	4	5	6
TP	0	30	70	120	200	260	300

- A) 80
- B) 60
- C) 40
- D) 200

Pyetja 37

Tabela e mëposhtme tregon funksionin e prodhimit të një firme që vepron në periudhë afatshkurtër. Nëse puna është faktor i ndryshueshëm dhe kapitali faktor i fiksuar, produkti mesatar i punëtorit të 3 është:

L	0	1	2	3	4	5	6
---	---	---	---	---	---	---	---

TP	0	30	70	120	200	260	300
----	---	----	----	-----	-----	-----	-----

- A) 30
- B) 40
- C) 60
- D) 120

Pyetja 38

Jepet tabela e mëposhtme e cila paraqet kostot totale të firmës në periudhën afatshkurtër:
Kosto marxhinale e njësisë së 4 të prodhuar është:

Q	0	1	2	3	4	5	6	7
TC	40	46	53	70	88	110	140	200

- A) 15
- B) 18
- C) 13
- D) 7

Pyetja 39

Jepet tabela e mëposhtme e cila paraqet kostot totale të firmës në periudhën afatshkurtër:
Kosto fikse e prodhimit të kësaj firme është:

Q	0	1	2	3	4	5	6	7
TC	40	46	53	70	88	110	140	200

- A) 40
- B) 30
- C) 70
- D) 18

Pyetja 40

Jepet tabela e mëposhtme e cila paraqet kostot totale të firmës në periudhën afatshkurtër:
Kosto variabël e prodhimit të njësisë së 6 është:

Q	0	1	2	3	4	5	6	7
TC	40	46	53	70	88	110	140	200

- A) 40
- B) 30
- C) 70
- D) 100

Pyetja 41

Jepet tabela e mëposhtme e cila paraqet kostot totale të firmës në periudhën afatshkurtër:

Kosto mesatare totale është në minimum në njësinë e prodhimit:

Q	0	1	2	3	4	5	6	7
TC	40	46	53	70	88	115	140	200

- A) 3
- B) 4
- C) 5
- D) 6

Pyetja 42

Në tabelën e mëposhtëme jepet informacioni i nevojshëm për një firmë prodhimi: MP arrin maksimumin tek

L(njesite e punes)	TP
1	1
2	6
3	9
4	9
5	8

- A) L=2
- B) L=3
- C) L=4
- D) L=5

Pyetja 43

Në tabelën e mëposhtëme jepet informacioni i nevojshëm për një firmë prodhimi: AP =MP dhe AP arrin maksimumin tek

L(njesite e punes)	TP
1	1
2	6
3	9
4	9
5	8

- A) L=2
- B) L=3
- C) L=4
- D) L=5

Pyetja 44

Në tabelën e mëposhtëme jepet informacioni i nevojshëm për një firmë prodhimi: Ligji i te ardhurave marxhinale zbritese fillon të veprojë pas punëtorit:

L(njesite e punes)	TP
1	1
2	6
3	9
4	9
5	8

- A) L=2
- B) L=3
- C) L=4
- D) L=5

Pyetja 45

Cili nga pohimet per treguesit e prodhimit në afatshkurtër është i vertete kur firma rrit prodhimin e saj:

- A) MP rritet
- B) TP ulet dhe pastaj rritet
- C) MP ne fillim rritet dhe pastaj ulet
- D) AP ulet gjithmone

Pyetja 46

Rritja e koston totale kur prodhohet një njësi më shumë produkt, njihet si

- A) Kosto marxhinale
- B) Kosto oportune
- C) Kosto variabël
- D) Kosto mesatare totale

Pyetja 47

Fitimet maksimizohen kur _____

- A) Kostot janë minimum
- B) Të ardhurat maksimizohen
- C) Kosto mesatare është më e vogël se të ardhurat mesatare
- D) Kosto marxhinale është e barabartë me të ardhurat marxhinale

Pyetja 48

Një zhvendosje lart e kurbës së koston marxhinale _____ prodhimin dhe një zhvendosje lart në të ardhurat marxhinale _____ prodhimin

- A) Zvogëlon, zvogëlon
- B) Zvogëlon , rrit
- C) Rrit, rrit
- D) Rrit, zvogëlon

Pyetja 49

Vendimi për outputin e prodhuar në periudhën afatgjatë të firmave do të jetë aty ku:

- A) Kosto mesatare e afatit të gjatë është më e ulëta
- B) Të ardhurat marxhinale janë të barabarta me sasinë e prodhuar
- C) Të ardhurat marxhinale janë të barabarta me koston marxhinale afatgjatë
- D) Kosto marxhinale është e barabartë me sasinë e prodhuar të produktit

Pyetja 50

Kosto totale mesatare afatshkurtër është e barabartë me shumën e _____ dhe _____

- A) Kostos oportune afatshkurtër, fitimit
- B) Kostos variabël afatshkurtër, fitimit
- C) Kostos variabël mesatare afatshkurtër, fitimit
- D) Kostos variabël mesatare afatshkurtër, koston fikse mesatare afatshkurtër

Pyetja 51

Kurba e koston marxhinale afatshkurtër pritet me kurbën e koston totale mesatare afatshkurtër dhe kurbën e koston variabël mesatare afatshkurtër _____

- A) Në pikat e tyre minimum
- B) Kur ato janë në rënie
- C) Kur ato janë në rritje
- D) Kur të ardhurat marxhinale janë zero

Pyetja 52

Në afat të shkurtër një firmë do të prodhojë zero produkt nëse _____

- A) Çmimi është më i madh se kostoja totale mesatare afatshkurtër
- B) Çmimi është ndërmjet koston totale mesatare afatshkurtër dhe koston variabile mesatare afatshkurtër
- C) Çmimi është më i vogël se kostoja variabël mesatare afatshkurtër
- D) Fitimi është zero

Pyetja 53

Ku do të ndikojë një rritje në koston fikse?

- A) Në koston marxhinale
- B) Në koston mesatare variabel
- C) Në koston mesatare totale
- D) Në të ardhurën marxhinale

Pyetja 54

Ku do të ndikojë një rënie në koston fikse?

- A) Në fitimet totale
- B) Në fitimet marxhinale

- C) Në nivelin fitim maksimizues të outputit $MR=MC$
- D) Në të ardhurat totale të siguruara në nivelin e outputit që maksimizon fitimin

Pyetja 55

Kostoja mesatare fikse është distanca vertikale midis kurbës së:

- A) Kostos mesatare totale dhe kostos mesatare variabel
- B) Kostos mesatare totale dhe kostos marxhinale
- C) Kostos mesatare variabel dhe kostos marxhinale
- D) Kostos mesatare totale dhe çmimit të produktit

Pyetja 56

Vlerat e kostos marxhinale përftohen nga zbritja e vlerave të njëpasnjëshme të:

- A) Kostos totale variabel
- B) Kostos mesatare variabel
- C) Kostot fikse totale
- D) Kostos mesatare totale

Pyetja 57

Nëse me rritjen e prodhimit kurba e kostos mesatare totale është rënëse, kurba e kostos marxhinale duhet të jetë:

- A) Rënëse më shpejt se kurba e kostos mesatare totale
- B) Rënëse pak a shumë aq sa kurba e kostos mesatare totale
- C) Nën kurbën e kostos mesatare totale
- D) Nën kurbën e kostos mesatare variabel

Pyetja 58

Cili nga pohimet e mëposhtme mund të jetë i vërtetë? Në periudhë të shkurtër kur bie prodhimi:

- A) Bie kostoja mesatare variabel
- B) Bie kostoja mesatare fikse
- C) Bie kostoja oportune
- D) Kosto mesatare variabel mbetet e pandryshuar

Pyetja 59

Nëse kostoja totale për të prodhuar 5 njësi është 100000 lekë dhe kostoja marxhinale e njësisë së pestë është 20000 lekë, atëherë:

- A) Kostoja fikse totale është rritëse,
- B) Kostoja mesatare e prodhimit të njësisë së katërt dhe të pestë nuk ndryshon.
- C) Kostoja mesatare variabel është rritëse
- D) Kostoja marxhinale e njësisë së gjashtë do të jetë më e madhe se 20000 lekë

Pyetja 60

Në qoftë se me rritjen e prodhimit kostoja variabël mesatare në periudhën e shkurtër është rënëse, ndodh patjetër që:

- A) Kosto totale mesatare është rënëse
- B) Kosto marxhinale është rënëse
- C) Kosto marxhinale ndodhet nën koston mesatare fikse
- D) Kosto marxhinale ndodhet sipër koston mesatare variabel

Kapitulli 3. Strukturat e tregut. Tregu i faktorëve të prodhimit

Pyetja 1

Nëse firmat që veprojnë në tregun e konkurrencës së plotë formojnë një monopol, atëherë në këtë rast:

- A) Konsumatorët fitojnë, ndërsa firmat humbasin
- B) Nuk ka lidhje fare me konsumatorët
- C) Konsumatorët humbasin ndërsa monopolisti fiton
- D) Edhe konsumatorët dhe firmat janë më të fituar

Pyetja 2

Në bazë të këtyre të dhënave për një firmë të konkurrencës së plotë: $Q=10$, $ATC=\min$; $p=ATC$; $TVC=15$ $TFC = 5$. Në bazë të llogaritjeve koston e tjera per periudhen afatshkurtër janë :

- A) $TC= 35$, $MC= 3.5$; $AFC=2$ $AVC=1,5$; $ATC=3.5$
- B) $TC= 20$, $MC= 1.5$; $AFC=0,5$ $AVC=1,5$; $ATC=2$
- C) $TC= 20$, $MC= 2$; $AFC=0,5$ $AVC=1,5$; $ATC=2$
- D) $TC= 15$, $MC= 2$; $AFC=0,5$ $AVC=1,5$; $ATC=2$

Pyetja 3

Në bazë të këtyre të dhënave për një firmë të konkurrencës së plotë: $Q=10$, $ATC=\min$; $p=ATC$; $TVC=15$ $TFC = 5$. Të ardhurat totale të shitësit TR janë :

- A) $TR= 20$
- B) $TR= 10$
- C) $TR= 30$
- D) $TR= 15$

Pyetja 4

Në bazë të këtyre të dhënave për një firmë të konkurrencës së plotë: $Q=10$, $ATC=\min$; $p=ATC$; $TVC=15$ $TFC = 5$, fitimi i firmës në periudhën afatshkurtër është:

- A) 20 njësi monetare
- B) 10 njësi monetare
- C) 0 njësi monetare

D) 25 njësi monetare

Pyetja 5

Cila nga të mëposhtmet është një karakteristikë e një tregu në konkurrencë të plotë?

- A) Pak shitës me produkte të diferencuara
- B) Firmat përcaktojnë çmimet e produkteve
- C) Barrierat për hyrje
- D) Produkte identike dhe shumë blerës e shitës

Pyetja 6

Maksimizimi i fitimit ndodh për një firmë kur:

- A) Të ardhurat totale janë të barabarta me kostot totale
- B) Kostoja marxhinale është e barabartë me të ardhurat marxhinale
- C) Kostoja mesatare totale është në minimumin e saj
- D) Të ardhurat mesatare janë të barabarta me koston marxhinale

Pyetja 7

Në afat të shkurtër, një firmë në konkurrencë të plotë do të mbyllet nëqse:

- A) Çmimi është nën koston mesatare variabile
- B) Çmimi është nën koston totale mesatare
- C) Çmimi është mbi koston totale mesatare
- D) Çmimi është mbi koston marxhinale

Pyetja 8

Në tabelën e mëposhteme paraqitet një firmë që operon në kushtet e konkurrencës së plotë dhe që synon maksimizimin e fitimit. Firma e konkurrencës së plotë e shet produktin me çmimin $p=3$ njësi monetare dhe ka një kosto fikse $TFC=2$ njësi monetare. TR arrin maksimumin tek:

Q	TC
1	6
2	7
3	10
4	14

- A) $Q=1$
- B) $Q=2$
- C) $Q=3$
- D) $Q=4$

Pyetja 9

Në tabelën e mëposhteme paraqitet një firmë që operon në kushtet e konkurrencës së plotë dhe që synon maksimizimin e fitimit. Firma e konkurrencës së plotë e shet produktin me çmimin $p=3$ njësi monetare dhe ka një kosto fikse $TFC=2$ njësi monetare. MC arrin minimumin në:

Q	TC
1	6
2	7
3	10
4	14

- A) $Q=1$
- B) $Q=2$
- C) $Q=3$
- D) $Q=4$

Pyetja 10

Në tabelën e mëposhteme paraqitet një firmë që operon në kushtet e konkurrencës së plotë dhe që synon maksimizimin e fitimit. Firma e konkurrencës së plotë e shet produktin me çmimin $p=3$ njësi monetare dhe ka një kosto fikse $TFC=2$ njësi monetare. Ligji i te ardhurave marxhinale zbritese fillon të veprojë :

Q	TC
1	6
2	7
3	10
4	14

- A) $Q=1$
- B) $Q=2$
- C) $Q=3$
- D) $Q=4$

Pyetja 11

Në tabelën e mëposhteme paraqitet një firmë që operon në kushtet e konkurrencës së plotë dhe që synon maksimizimin e fitimit. Firma e konkurrencës së plotë e shet produktin me çmimin $p=3$ njësi monetare dhe ka një kosto fikse $TFC=2$ njësi monetare. Firma maksimizon fitimin tek

Q	TC
1	6
2	7
3	10
4	14

- A) $Q=1$
- B) $Q=2$
- C) $Q=3$
- D) $Q=4$

Pyetja 12

Në tabelën e mëposhteme paraqitet një firmë që operon në kushtet e konkurrencës së plotë dhe që synon maksimizimin e fitimit. Firma e konkurrencës së plotë e shet produktin me çmimin $p=$

3 njësi monetare dhe ka një kosto fikse $TFC=2$ njësi monetare. Në pikën e maksimizimit të fitimit, firma gjeneron fitim të barabartë me:

Q	TC
1	6
2	7
3	10
4	14

- A) -1
- B) -2
- C) 3
- D) 4

Pyetja 13

Një firmë që bën fitim mbi normen e fitimit normal, do të thotë që po merr:

- A) Fitim ekonomik
- B) Fitim kontabël
- C) Fitim normal
- D) Fitimi negativ

Pyetja 14

Nëse të dyja, kosto marxhinale dhe të ardhurat marxhinale rriten, një firmë _____

- A) Duhet të rrisë outputin
- B) Duhet të reduktojë outputin
- C) Do të kërkoj më shumë informacion si të vijojë
- D) Nuk do të ndryshojë outputin

Pyetja 15

Një proces prodhimi është teknikisht eficient nëse:

- A) Prodhimi është maksimizuar
- B) Inputet janë minimizuar
- C) Kemi përdorim maksimal të faktoreve të prodhimit
- D) Kostot minimizohen

Pyetja 16

Nëse kosto totale mesatare e periudhës afatgjatë, është duke u zvogëluar kur lëvizim nga e majta në të djathtë, kjo do të thotë që:

- A) Firma ka të ardhura rritëse të shkallës
- B) Firma ka të ardhura zbritëse të shkallës
- C) Firma ka të ardhura kostante të shkallës
- D) Firma ka minimumin e efijencës

Pyetja 17

Në një strukturë tregu në konkurrencë të plotë, çdo blerës dhe shitës _____

- A) Është çmim pranues
- B) Prodhon produkte të ndryshme
- C) Beson se mund të ndikojë në çmim
- D) Parandalon hyrjen e konkurrentëve

Pyetja 18

Që konkurrenca e plotë të funksionojë duhet të ketë

- A) Shumë blerës dhe shitës
- B) Produkt heterogjen
- C) Barriera në hyrje dhe dalje
- D) Informacion të rezervuar

Pyetja 19

Kurba e kërkesës së firmës në tregun në konkurrencë të plotë është:

- A) Horizontale
- B) Vertikale
- C) Pjerrësi negative
- D) Relativisht elastike

Pyetja 20

Një firmë në konkurrencë të plotë prodhon një nivel outputi në të cilin _____

- A) Çmimi është më i madh se kostoja marxhinale
- B) Çmimi është i barabartë me koston marxhinale
- C) Çmimi është më i vogël se kostoja marxhinale
- D) Çmimi është i barabartë me koston totale mesatare

Pyetja 21

Duke krahasuar monopolin me një firmë në konkurrencë të plotë, monopolisti do të:

- A) Prodhon më pak me një çmim më të ulët
- B) Prodhon më shumë me një çmim më të ulët
- C) Prodhon më pak me një çmim më të lartë
- D) Prodhon më pak me një çmim më të ulët

Pyetja 22

Për firmat konkurruese pa kosto fikse, pjesa rritëse e kurbës së koston marxhinale është e njëjtë me:

- A) Kurbën e kërkesës
- B) Kurbën e mundësive të prodhimit (KMP)
- C) Kurbën e ofertës

D) Kurbën e kostos totale

Pyetja 23

Cili nga pohimet e mëposhtme është një karakteristikë për ekuilibrin afatgjatë në konkurrencën e plotë:

- A) $P=MC=AVC$
- B) Fitimet kontabël me të mëdha se zero
- C) Fitimet ekonomike negative
- D) $P =$ minimumi e LAC-së

Pyetja 24

Në konkurrencën e plotë firma mund të sigurojë gjithmonë fitim normal:

- A) Në afatin e shkurtër
- B) Në afatin e gjatë
- C) Asnjëherë
- D) Sa herë që $MR=MC$

Pyetja 25

Në konkurrencën e plotë firmat do të prodhojnë ku $P = MC$:

- A) Në afatin e shkurtër
- B) Në afatin e gjatë
- C) Gjithmonë
- D) Asnjëherë

Pyetja 26

Në konkurrencën e plotë çmimi i një firme përcaktohet në ndërprerjen e kurbës së ofertës dhe të kurbës së kërkesës së industrisë:

- A) Në afatin e shkurtër
- B) Gjithmonë
- C) Në afatin e gjatë
- D) Asnjëherë

Pyetja 27

Kurba e kërkesës për mallrat e një firme që operon në strukturën e konkurrencës së plotë është plotësisht elastike. Kjo do të thonë që e ardhura marxhinale e firmës:

- A) Është mbi çmimin e mallit
- B) Është nën çmimin e mallit
- C) Është e barabartë me çmimin e mallit
- D) Është e barabartë me të ardhurat mesatare minus koston fikse

Pyetja 28

Në qoftë se një firmë në kushtet e konkurrencës së plotë kupton që në pozicionin më të mirë të mundshëm afatgjatë çmimi nuk është mjaftueshëm për të mbuluar koston mesatare variabel, atëherë firma:

- A) Do të rrisë çmimin aktual
- B) Do të vazhdojë të veprojë me të njëjtin çmim
- C) Do të vazhdojë të veprojë nëse çmimi mbulon koston mesatare fikse
- D) Do të mbyllet

Pyetja 29

Një firmë që synon të maksimizojë fitimet e saj në afatin e shkurtër do të mbyllet, nëse nuk është në nivelin e prodhimit në të cilin:

- A) E ardhura mesatare të kalojë koston mesatare variabel
- B) E ardhura mesatare të kalojë koston mesatare totale
- C) E ardhura mesatare të kalojë koston mesatare fikse
- D) E ardhura mesatare të kalojë të ardhurën marxhinale

Pyetja 30

Nga pohimet e mëposhtme cili i referohet ekuilibrit afatgjatë të një firme të konkurrencës së plotë:

- A) E ardhura marxhinale është e barabartë me të ardhurën mesatare
- B) E ardhura mesatare është e barabartë me koston mesatare totale
- C) Kosto mesatare totale është e barabartë me koston marxhinale
- D) E ardhura marxhinale është e barabartë me koston marxhinale


Pyetja 31

Cili nga pohimet e mëposhtme është karakteristikë e monopolit:

- A) Disa shitës në treg
- B) Zotëron fuqi tregtare
- C) Nuk ekzistojnë pengesa për hyrjen lirisht në treg
- D) Nuk zotëron fuqi tregtare

Pyetja 32


Grafiku përshkruan një firmë në monopol që maksimizon fitimin. Për të maksimizuar fitimet, monopolisti duhet të vendosë një çmim prej:



- A) 9 dollarë.
- B) 12 dollarë.
- C) 20 dollarë.
- D) 22 dollarë.

Pyetja 33

Grafiku përshkruan një firmë në monopol që maksimizon fitimin. Të ardhurat totale të monopolistit, në pikën e maksimizimit të fitimit janë:



- A) 81 dollarë.
- B) 144 dollarë.
- C) 225 dollarë.
- D) 240 dollarë.

Pyetja 34

Produkti që prodhon monopolisti ka një nga këto karakteristika:

- A) Ka zëvendësues të afërt në konsum
- B) Ka një çmim që përcaktohet nga forcat e tregut
- C) Është homogjen
- D) Është i diferencuar

Pyetja 35

Në një strukturë tregu monopol:

- A) Ka shumë firma që shesin produkte identike

- B) Nuk ka pengesa për hyrjen në treg
- C) Ekziston vetëm një shitës i një produkti unik
- D) Firmat janë çmim vendosëse

Pyetja 36

Cila nga të mëposhtmet është e vërtetë për një monopol natyror?

- A) Shumë firma që prodhojnë produkte të njëjta
- B) Barriera të larta për hyrje
- C) Firmat janë çmim pranuese
- D) Firmat sigurojnë fitim normal në afat të gjatë

Pyetja 37

Diskriminimi i plotë i çmimit do të thotë që çdo klient _____

- A) Blen të njëjtën sasi
- B) Pagan të njëjtin çmim
- C) Kontribuon me të njëjtat të ardhura
- D) Pagan atë që ai mendon se produkti vlen

Pyetja 38

Cili nga pohimet e mëposhtme është karakteristikë e monopoleve natyrore:

- A) Marrja e licensës për profesionin
- B) Ekonomitë e shkallës
- C) Nxjerrja e patentës
- D) E drejta publike

Pyetja 39

Me qëllim që të rrisë shitjet nga 7 në 8 njësi, monopolisti duhet të ulë çmimin nga 7 lekë/njësi në 6 lekë/njësi. Sa do të ishte e ardhura marxhinale në këtë rast ?

- A) 48 lekë
- B) -1 lekë
- C) 6 lekë
- D) 1 lekë

Pyetja 40

Monopolisti maksimizon fitimin nëse prodhon atë sasi produkti ku:

- A) Çmimi është i barabartë me koston marxhinale
- B) Çmimi është i barabartë me të ardhurat marxhinale
- C) Të ardhurat marxhinale janë të barabarta me kostot marxhinale
- D) E ardhura mesatare është e barabartë me koston marxhinale

Pyetja 41

Nëse monopoli që maksimizon fitimin prodhon atë sasi, për të cilën kostoja marxhinale e kalon të ardhurën marxhinale, atëherë ai:

- A) Do të rritë çmimin dhe do të ulë sasinë e prodhuar
- B) Do të ulë çmimin dhe do të rritë sasinë e prodhuar
- C) Do të ulë çmimin dhe sasinë e prodhuar
- D) Maksimizon fitimin

Pyetja 42

Monopoli nuk vepron asnjëherë:

- A) Në pjesën elastike të kurbës së kërkesës
- B) Në atë pjesë të kurbës së kërkesës që ka elasticitet unitar
- C) Në pjesën joelastike të kurbës së kërkesës
- D) Për atë sasi ku e ardhura marxhinale është pozitive, megjithëse e ardhura totale nuk është në maksimum.

Pyetja 43

Me qëllim që të shesë një njësi më shumë monopoli duhet të ulë çmimin për secilën prej njërive shtesë të shitura. Që këtë arrijmë në përfundimin që tek monopoli e ardhura marxhinale do të:

- A) Të jetë më e madhe se kosto marxhinale
- B) Të barazojë të ardhurat mesatare
- C) Të jetë më e vogël se të ardhurat mesatare
- D) Të jetë më e madhe se çmimi

Pyetja 44

Nëse e ardhura marxhinale është më e madhe se zero, atëherë dimë që monopolisti do të prodhojë atë sasi outputi që i korrespondon amplitudës së kurbës së kërkesës për të cilën elasticiteti është:

- A) Më i madh se 1
- B) I barabartë me 1
- C) Më i vogël se 1
- D) Infinit

Pyetja 45

Cili nga pohimet e mëposhtme është i vërtetë për monopolin?

- A) Kurba MC ka pjerrësi rënëse
- B) Kurba ATC ka trajtën e U
- C) $P=AVC$
- D) $P=TR$

Pyetja 46

Për firmën monopol rritja e kostove fikse do të:

- A) Reduktojë nivelin fitimmaksimizues të prodhimit
- B) Nuk do të ndikojë në nivelin fitimmaksimizues të prodhimit
- C) Ngre nivelin fitimmaksimizues të prodhimit
- D) Rrit fitimet e firmës

Pyetja 47

Monopolisti nuk ka kurbë oferte sepse:

- A) Nuk mund të vendoset një marrëdhënie funksionale si në rastin e konkurrencës së plotë midis çmimit dhe sasisë që ofrohet
- B) Monopolistët mund të vendosin një çmim, që tregu do ta japë për produktin që ata prodhojnë
- C) Monopolistët nuk janë të kufizuar nga kostoja e prodhimit
- D) Monopolistët do të reduktojnë prodhimin nëse çmimi rritet më tepër se rritja e prodhimit

Pyetja 48

E ardhura marxhinale për monopolistin varet nga:

- A) Çmimi i kërkuar për produktin
- B) Pjerrësia e kurbës së kërkesës
- C) Sasia e kërkuar e produktit
- D) Kostoja marxhinale e prodhimit

Pyetja 49

Nëse firmat që veprojnë në tregun e konkurrencës së plotë formojnë një monopol, atëherë në këtë rast:

- A) Konsumatorët fitojnë, ndërsa firmat humbasin
- B) Nuk ka lidhje fare me konsumatorët
- C) Konsumatorët humbasin ndërsa monopolisti fiton
- D) Dhe konsumatorët dhe firmat janë në të njëjtin pozicion si më parë

Pyetja 50

Monopoli natyror lind kur:

- A) Burimet natyrore janë faktorë prodhimi i rëndësishëm
- B) Ekzistojnë avantazhe kostoje të rëndësishme me zgjerimin e prodhimit
- C) Shteti ndalon hyrjet në degë
- D) Patentat mbrojnë teknologjinë e firmës

Pyetja 51

Të gjitha alternativat e mëposhtme janë karakteristika të konkurrencës monopolistike me përjashtim të:

- A) Egzistenca e shumë firmave
- B) Përcaktimi i çmimit në nivelin ku $MC=MR$
- C) Produkte të ngjajshme, por jo identike
- D) Marrëveshje midis firmave lidhur me çmimin e shitjes së produktit

Pyetja 52

Dallimi kryesor midis konkurrencës së plotë dhe asaj monopolistike është që në konkurrencën monopolistike:

- A) Ekzistojnë pak firma
- B) Çmimet janë më të ulëta
- C) Ekzistojnë barriera të hyrjes dhe daljes
- D) Produktet janë të diferencuara

Pyetja 53

Cila nga të mëposhtmet është një karakteristikë e konkurrencës monopolistike?

- A) Shumë firma që shesin produkte të njëjta
- B) Pak firma që shesin produkte të diferencuara
- C) Një firmë që shet një produkt unik
- D) Produkte identike dhe shumë blerës e shitës

Pyetja 54

Të gjitha sa vijon janë lloje të konkurrencës jo perfekte përveç:

- A) Konkurrencës monopolistike
- B) Oligopolit
- C) Monopolit
- D) Konkurrencës së plotë

Pyetja 55

Arsyeja për kurbën e kërkesës me kënd është se:

- A) Oligopolisti beson se konkurrentët do ta ndjekin në vendimin e tij për rritjen e prodhimit, por jo në uljen e prodhimit
- B) Oligopolisti beson se konkurrentët do ta ndjekin në vendimin e tij për rritjen e çmimeve, por jo në uljen e prodhimit
- C) Oligopolisti beson se konkurrentët do ta ndjekin në vendimin e tij për uljet e çmimeve, por jo në rritjen e çmimeve
- D) Oligopolisti beson se konkurrentët do ta ndjekin në vendimin e tij për rritjen e çmimeve, por jo në rritjen e prodhimit

Pyetja 56

Një strategji dominuese është _____

- A) Një strategji fituese

- B) Një strategji humbëse
- C) Strategjia më e mirë e një lojtari që merr vendimet i pari
- D) Strategjia më e mirë e një lojtari, pavarësisht nga strategjitë e adoptuara nga rivalët

Pyetja 57

Karakteristikë e përbashkët për të gjitha tregjet në konkurrencë jo të plotë është:

- A) Përqindja e lartë e perqendrimit
- B) Ndryshimet e rëndësishme të kostos midis firmave
- C) Fuqia konkurruese midis firmave
- D) Vendosja e të njëjtit çmim

Pyetja 58

Dallimi kryesor midis konkurrencës së plotë dhe asaj monopolitike është që në konkurrencën monopolitike:

- A) Ekzistojnë pak firma
- B) Ekzistojnë barrierat e hyrjes dhe të daljes
- C) Produktet janë të diferencuara
- D) Çmimet janë më të ulëta

Pyetja 59

Në konkurrencën monopolitike, liria e hyrjes dhe e daljes sjell si pasojë:

- A) Fitimin zero në ekuilibër
- B) Kurbat e kërkesës me pjerrësi negative
- C) Varësinë e ndërsjelltë midis vendimeve të firmave në degë
- D) Ekzistencën e shumë markave të produktit në degë

Pyetja 60

Cila nga alternativat e mëposhtme karakterizon pozicionin ekuilibër aftatshkurtër në kushtet e konkurrencës monopolitike:

- A) Kosto marxhinale e barabartë me çmimin
- B) Sasia e outputit të prodhuar me koston mesatare totale minimale
- C) Kurba e kërkesës horizontale
- D) Fitimi ekonomik zero

Pyetja 61

Në kushtet e konkurrencës monopolitike, fitimi ekonomik afatgjatë tenton në zero për shkak të:

- A) Diferencimit të produktit
- B) Mungesës së barrierave të hyrjes
- C) Kapacitetit të tepërt
- D) Përballimit nga çdo firmë të kurbës së kërkesës me pjerrësi rënëse

Pyetja 62

Në afatin e gjatë, firma në kushtet e konkurrencës monopolistike do të:

- A) Ndeshë një kurbë kërkesë plotësisht elastike
- B) Prodhon më tepër se sasia që minimizon ATC
- C) Prodhon më pak se sasia që minimizon ATC
- D) Prodhon sasinë që minimizon ATC

Pyetja 63

Oligopoli mund t'i maksimizojë gjithmonë fitimet e tij duke:

- A) Prodhuar sasinë e prodhimit të monopolit
- B) Prodhuar sasinë e prodhimit të konkurrencës së plotë
- C) Kooperuar me firmat rivale
- D) Prodhuar atë sasi produkti ku kostoja mesatare është minimale

Pyetja 64

Në kushtet e oligopolit firmat mund të rritin gjithmonë fitimet duke:

- A) Diferencuar produktet e tyre
- B) Prodhuar nivel konkurrues të prodhimit
- C) Bashkepunuar me njëra-tjetrën
- D) Marrë çmimin të gatshëm nga tregu

Pyetja 65

Firma që interesohet për maksimizimin e të ardhurave nga shitja do të prodhojë në pikën ku:

- A) E ardhura marxhinale barazon koston marxhinale
- B) Minimizohet kostoja mesatare
- C) E ardhura marxhinale barazohet me zero
- D) E ardhura mesatare barazon koston mesatare

Pyetja 66

Në qoftë se oligopoli i llogarit fitimet e tij pa marrë parasysh reagimin e firmave rivale, rezultati do të jetë:

- A) Maksimizimi i fitimit për të gjitha firmat
- B) Ekuilibri monopol për degën
- C) Reduktim i prodhimit të përgjithshëm të degës
- D) Rritje në tepicën konsumatore

Pyetja 67

Kurba e kërkesës me kënd:

- A) Ndihej për të shpjeguar pse çmimet e oligopolit janë më të qëndrueshme
- B) Nuk i përgjigjet pyetjes se si është vendosur çmimi në fillim të analizës teorike
- C) Bazohet në supozimin që nëse firma e ul çmimin e saj, konkurrentët e saj do ta ndjekin

D) Bazohet në supozimin që nëse firma e rrit çmimin e saj, konkurrentët e saj do ta ndjekin

Pyetja 68

Nëse firmat në oligopol merren vesh për të rritur çmimin atëherë:

- A) Të gjitha firmat përfitojnë, ndërkohë që humb ekonomia në tërësi
- B) Firma sunduese përfiton, ndërkohë që humbasin firmat e tjera dhe ekonomia në tërësi
- C) Përfiton çdo firmë dhe ekonomia në tërësi
- D) Përfiton çdo firmë, ndërkohë që nuk ndikohet ekonomia në tërësi

Pyetja 69

Nëse oligopolisti del me humbje në periudhën afatshkurtër, atëherë në periudhën afatgjatë:

- A) Ai do të dalë nga biznesi
- B) Ai do të qëndrojë në biznes
- C) Do të barazojë koston totale mesatare me çmimin
- D) Ndjek modelin e firmës sunduese

Pyetja 70

Cili nga bizneset e mëposhtme ka strukturë oligopoli në tregun shqiptar?

- A) Industria e përpunimit të qumështit
- B) Sallonet e bukuri
- C) Stacionet e karburantit brenda Tiranës
- D) Fermerët e drithit në fushën e Myzeqesë

Pyetja 71

Cili nga bizneset e mëposhtme ka strukturë konkurrencë monopolistike në tregun shqiptar?

- A) Tregu i fruta perimeve
- B) Dyqanet e veshjeve
- C) Stacionet e karburantit brenda Tiranës
- D) Fermerët e drithit në fushën e Myzeqesë

Pyetja 72

Cili nga bizneset e mëposhtme ka strukturë konkurrencë e plotë në tregun shqiptar?

- A) Tregu i fruta perimeve
- B) Dyqanet e veshjeve
- C) Stacionet e karburantit brenda Tiranës
- D) Konçensionarët e makinave të reja

Pyetja 73

Nëse firmat në oligopol nuk merren vesh për të rritur çmimin atëherë:

- A) Të gjitha firmat humbasin, ndërkohë që konsumatori përfiton

- B) Firma sunduese përfiton, ndërkohë që humbasin firmat e tjera dhe ekonomia në tërësi
- C) Përfiton çdo firmë dhe ekonomia në tërësi
- D) Përfiton çdo firmë, ndërkohë që nuk ndikohet ekonomia në tërësi

Pyetja 74

Cila nga alternativat e mëposhtme karakterizon pozicionin ekuilibër aftatshkurtër në kushtet e oligopolit:

- A) Fitimi ekonomik pozitiv
- B) Sasia e outputit të prodhuar me koston mesatare totale minimale
- C) Kurba e kërkesës horizontale
- D) Fitimi ekonomik zero

Pyetja 75

Në afatin e gjatë, firma në kushtet e oligopolit:

- A) Ndesh një kurbë kërkesë plotësisht elastike
- B) Prodhon më tepër se sasia që minimizon ATC
- C) Prodhon më pak se sasia që minimizon ATC
- D) Nuk ka asnjëherë fitim negativ

Pyetja 76

Ndryshimi në të ardhurat totale që rezulton nga përdorimi i një njësie shtesë të punës paraqet:

- A) Produktin marxhinal të punës
- B) Të ardhurat marxhinale nga puna
- C) Koston marxhinale të punës
- D) Të ardhurat e produktit marxhinal të punës

Pyetja 77

Kur nuk ka ndryshime në teknologji dhe sasia e inputeve të tjera mbetet konstante, në qoftë se produkti marxhinal i njësisë së parë të faktorit punë është i barabartë me 2 njësi të outputit dhe produkti marxhinal i njësisë së dytë të punës është i barabartë me 3 njësi të outputit, outputi total i prodhuar me dy njësi të punës është i barabartë me:

- A) 1 njësi
- B) 5 njësi
- C) 2 njësi
- D) 3 njësi

Pyetja 78

Nëse një firmë rrit pagat, kjo do të shkaktojë _____ dhe _____

- A) Kosto marxhinale do të rritet, prodhimi do të bjerë
- B) Të ardhurat marxhinale të rriten, prodhimi të bjerë
- C) Kosto oportune do të rritet, firma do të mbyllet

D) Kosto mesatare do të rritet, prodhimi do të rritet

Pyetja 79

Nëse mbajmë konstant të gjithë faktorët e prodhimit përveç njërës dhe rritja e këtij faktori të ndryshueshëm pritet të çojë në një ulje të qëndrueshme të produktit marxhinal të atij faktori themi se ky është një shembull i:

- A) Të ardhurave rënëse të shkallës
- B) Ligji i të ardhurave marxhinale rënëse
- C) Të ardhura kostante të shkallës
- D) Një teknikë joefikase prodhimi

Pyetja 80

Efekti zëvendësues i rritjes së çmimit të punës do të _____ sasinë e punës dhe do të _____ efektin e tij në prodhim

- A) Rrisë, rrisë
- B) Rrisë, zvogëlojë
- C) Zvogëlojë, pakësojë
- D) Zvogëlojë, rrisë

Pyetja 81

Një firmë që maksimizon fitimin do të punësojë punë derisa _____ të barazojnë _____

- A) Të ardhurat marxhinale, kostot marxhinale
- B) Të ardhurat marxhinale në afatgjatë, kostot marxhinale afatgjatë
- C) Raporti i prodhimit të punës, raportin e prodhimit të kapitalit
- D) Kosto marxhinale e punës, të ardhurat marxhinale të produktit

Pyetja 82

Produkti marginal i punës me pjerrësi rënëse është _____ e firmës

- A) Oferta e punës
- B) Kurba e kërkesës afatshkurtër për fuqinë punëtore
- C) Kosto marxhinale e punës
- D) Produkti i të ardhurave marxhinale të punës

Pyetja 83

Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore ndikohet nga:

- A) Paga reale më të larta
- B) Kosto më të ulëta fikse të punës
- C) Të ardhura më të ulëta jo nga puna
- D) Ndryshimet e preferencave midis kohës së lirë dhe punës

Pyetja 84

Futbollistët prirën të fitojnë më shumë se pedagogët sepse:

- A) Futbollistët ofrojnë më shumë argëtim
- B) Pedagogët shpenzojnë me shume në kohe të lire
- C) Tregjet e punës janë jo perfekte
- D) Futbollistët janë relativisht të paktë në raport me pedagogët

Pyetja 85

Kapitali njerëzor mund të përshkruhet si:

- A) Mjetet e përdorura nga punëtorët për të rritur produktivitetin
- B) Aftësitë e trashëguara të një personi
- C) Stoku i ekspertizës së grumbulluar nga një punëtor
- D) Arsimimi

Pyetja 86

Burimi më i rëndësishëm i diferencave të pagave janë:

- A) Variacioni rajonal
- B) Sindikatat
- C) Rreziku nga të afërmit
- D) Aftësitë

Pyetja 87

Puna e kualifikuar është relativisht e pakët sepse:

- A) Ka shumë pak mësues
- B) Ka pak student në arsimin e lartë
- C) Është e kushtueshme të përvetësosh kapitalin njerëzor
- D) Pagat e mësuesve janë shumë të ulëta

Pyetja 88

Kostoja oportune e ndjekjes së arsimit të lartë është e barabartë me: _____

- A) Tarifat e kursit
- B) Tarifat e kursit dhe shpenzimet e jetesës
- C) Fitimet e munguara nga ndjekja e arsimit
- D) Tarifat e kursit, shpenzimet e jetesës dhe tekstet shkollore

Pyetja 89

Duke kufizuar ofertën e punës, një sindikatë mund të _____ dhe _____

- A) Rrisë pagën, të rrisë punësimin
- B) Ruaj pagën, të rrisë punësimin
- C) Rrisë pagën, të ulë punësimin
- D) Ruaj pagën, punësimi më i ulët

Pyetja 90

Papunësia e pavullnetshme ekziston nëse punëtorët:

- A) Nuk do të punojnë me pagën e ofruar
- B) Do të punonin me pagën e tregut, por nuk mund të gjejnë punë
- C) Nuk do të punojnë sepse orët e punës janë jo-sociale
- D) Nuk janë të përgatitur për të lëvizur për të marrë vendin e punës

Pyetja 91

Pagat efikase janë _____ që rrisin _____

- A) Paga të ulta, punësimin
- B) Paga të larta, ofertën e punës
- C) Paga të larta, produktivitetin
- D) Paga të larta, punësimin

Pyetja 92

Kostoja e përdorimit të kapitalit është sa: _____

- A) Norma e pagës së kapitalit
- B) Tarifat e interesit
- C) Kosto marxhinale e kapitalit
- D) Norma e qirasë për përdorimin e kapitalit

Pyetja 93

Në afat të shkurtër, oferta e kapitalit është _____ dhe në afat të gjatë do të varet nga _____

- A) Variabël, teknologjia
- B) Fikse, pritjet për të ardhmen
- C) Fikse, teknologjia
- D) Variabël, normat e interesit

Pyetja 94

Shpërndarja funksionale e të ardhurave tregon se si ndahen të ardhurat kombëtare midis:

- A) Punonjësve
- B) Popullsisë
- C) Faktorëve të prodhimit
- D) Forcës së punës

Pyetja 95

Një alokim është Pareto-efiçient nëse rishpërndarja e burimeve do t'i bënte disa njerëz _____ pa i bërë të tjerët _____

- A) Më keq, më keq
- B) Më mirë, më mirë
- C) Më mirë, më keq

D) Të barabartë, të pabarabartë

Pyetja 96

Një ekuilibër konkurrues është Pareto-efiçient sepse:

- A) Prodhuesit janë çmim pranues
- B) Konsumatorët dhe prodhuesit përballen me të njëjtat çmime
- C) Kostot dhe përfitimet marxhinale janë të barabarta
- D) Çmimet janë të barabarta me koston marxhinale dhe përfitimin

Pyetja 97

Të ardhurat e marra nga pronarët e faktorëve të prodhimit konsistojnë në pagën e paguar për punën:

- A) Fitimin e paguar për kapitalin dhe interesin e paguar për paratë
- B) Dividentët e paguara për kapitalin dhe interesin e paguar paratë
- C) Dividentët e paguara për kapitalin dhe rentën e paguar për tokën
- D) Interesin e paguar për kapitalin dhe rentën e paguar për tokën

Pyetja 98

Një rritje në ofertën e faktorit të prodhimit do të:

- A) Ngrejë të ardhurat e faktorit, nëse elasticiteti i kërkesës faktorit është më i vogël se 1
- B) Ulë të ardhurat e faktorit, në qoftë se elasticiteti i kërkesës faktorit është më i vogël se 1
- C) Ngrejë të ardhurat e faktorit, nëse elasticiteti i ofertës së faktorit është më i vogël se 1
- D) Ulë të ardhurat e faktorit, në qoftë se elasticiteti i ofertës së faktorit është më i vogël se 1

Pyetja 99

Ndryshimi në të ardhurat e përgjithshme, që rezulton nga shfrytëzimi i një njësie shtesë të kapitalit është:

- A) Produkti marxhinal i kapitalit
- B) E ardhura marxhinale e kapitalit
- C) Kostoja e të ardhurës marxhinale të kapitalit
- D) E ardhura e produktit marxhinal të kapitalit

Pyetja 100

Një firmë që maksimizon fitimin do të vazhdojë të pajtojë në punë njësi të një faktori variabël të prodhimit derisa:

- A) Kostoja marxhinale e faktorit të jetë e barabartë me produktin marxhinal të tij
- B) Kostoja marxhinale e faktorit të jetë e barabartë me produktin e të ardhurave mesatare të tij
- C) Kostoja mesatare e faktorit të jetë e barabartë me të ardhurat e produktit marxhinal të tij
- D) E ardhura e produktit marxhinal të faktorit të jetë e barabartë me zero

Pyetja 101

Fitimi është i barabartë me të ardhurat e përgjithshme minus:

- A) Koston eksplicite
- B) Koston implicite
- C) Kostot eksplicite dhe implicite
- D) Pagën dhe rentën

Kapitulli 4. Matja e Produktit të Brendshëm Bruto dhe Rritja Ekonomike. Ekuilibri makroekonomik

Pyetja 1

Sipas të dhënave të mëposhtme:

	Firma A	Firma B
Totali i shitjeve	700 \$	1500 \$
Pagat	300 \$	700 \$
Fitimi	200 \$	300\$

Firma A shet të gjithë produktin e tij Firmës B, ndërsa Firma B shet produktin e tij në treg, pra konkumatorëve. Llogarisni vlerën e produktit të përgjithshëm me metodën e vlerës së shtuar:

- A) 700 dollarë
- B) 1.500 dollarë
- C) 2.200 dollarë
- D) shuma e pagave dhe fitimit

Pyetja 2

Në kushtet e një oferte klasike dhe një rritje të eksporteve, ekuilibri i ri makroekonomik do të ketë këto tipare:

- A) PBB të pandryshuar dhe ulje të çmimit
- B) Rritje çmimi dhe ulje të PBB-së
- C) Rritje çmimi dhe rritje të PBB-së
- D) Çmim të pa ndryshuar dhe ulje të PBB-së

Pyetja 3

Në një ekonomi hipotetike prodhohen vetëm dy mallra, ushqime dhe veshje. Alternativa e mëposhtme bazohet në të dhënat për këtë ekonomi paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Viti	Prodhimi i Veshjeve	Çmimi i veshjeve	Prodhimi i Ushqimeve	Çmimi i Ushqimeve
2022	300	1500 €	1500	700 €
2023	450	2500 €	2600	1700 €

Në këtë ekonomi të tjeshtë PBB korrente në vitin 2022 është:

- A) 2.495.000 €
- B) 2.000.000 €
- C) 1.500.000 €
- D) 1.000.000 €

Pyetja 4

Nëse shteti dëshiron të rrisë nivelin e PBB, ai mund:

- A) Të reduktojë taksat
- B) Të reduktojë shpenzimet e tij për mallra dhe shpenzime
- C) Të reduktojë pagesat e transferueshme
- D) Të reduktojë madhësinë e deficitit buxhetor

Pyetja 5

Gjatë një recensionit të ardhurat nga taksat:

- A) Rriten dhe shpenzimet shtetërore rriten
- B) Rriten dhe shpenzimet shtetërore ulen
- C) Ulen dhe shpenzimet shtetërore rriten
- D) Ulen dhe shpenzimet shtetërore ulen

Pyetja 6

Cfarë vlere merr papunësia ciklike gjatë një periudhe recensionit:

- A) Papunësia ciklike është më e madhe se 0
- B) Papunësia ciklike është më e vogël se 0
- C) Papunësia ciklike është 0
- D) Papunësia ciklike nuk ndryshon

Pyetja 7

Një rritje e Importeve sjell

- A) rritje të çmimeve
- B) ulje të çmimeve dhe zhvendosje majtas poshtë të kurbës AD
- C) importet ulin eksportet neto por nuk zhvendos kurbën AD
- D) asnjë ndryshim në AD

Pyetja 8

Cilat nga vlerat apo veprimet e mëposhtme do të përfshihet në llogaritjen e PBB-së të vitit korrent?

- A) Televizorë të blerë në tregun me pakicë
- B) Sara shet një kompjuter që kishte blerë një vit më parë
- C) Ana blen një makinë nga shoqja e saj për të shkuar në punë
- D) Drini blen 8 milion lekë aksione në bursë

Pyetja 9

Cili nga faktorët e mëposhtme do të shkaktojë zhvendosjen majtas të kurbës së kërkesës agregate:

- A) Një rritje në normat e interesit (për një nivel të dhënë të çmimit)
- B) Nje rritje ne konsum
- C) Një rritje në taksa
- D) Një rënie në nivelin e çmimeve

Pyetja 10

Supozojmë se një firmë shet outputin e saj për 30 milion lekë. Ajo paguan: 15 milion lekë paga dhe rogat, 8 milion lekë për lëndët e para të blera nga firmat e tjera, 2 milion lekë interesa bankare, fitimi qe siguron është 3 milion lekë. Sa është vlera e shtuar (VSH ose VA) e realizuar nga firma?

- A) 15 milion lekë
- B) 30 milion lekë
- C) 9 milion
- D) 22 milion lekë

Pyetja 11

Cila nga alternativat e mëposhtme paraqet një mundësi për uljen e defiçitit buxhetor?

- A) Qeveria rrit shpenzimet qeveritare;
- B) Qeveria blen pajisje për ushtrinë;
- C) Qeveria merr hua nga publiku;
- D) Qeveria ul shpenzimet

Pyetja 12

Shpenzimet kapitale janë:

- A) Shpenzimet e qeverisë për mbrojtje sociale
- B) Shpenzimet operative për mirëmbajtje
- C) Shpenzimet për ndërtimin e rrugëve
- D) Shpenzimet për kompensimin e pronarëve.

Pyetja 13

Fazat e një cikli biznesi janë të renditura si më poshtë:

- A) Recensioni, pika më e ulët, piku, ekspansioni
- B) Pika më e lartë, recensioni, pika më e ulët, ekspansioni;
- C) Recensioni, piku, ekspansioni, pika më e ulët
- D) Ekspansioni, recensioni, piku, pika më e ulët

Pyetja 14

Në qoftë se vlera e GDP nominal është 4000 milionë lekë dhe deflatori i GDP- së 125%, vlera e GDP real do të jetë:

- A) 3200
- B) 5000
- C) 4000
- D) 4200

Pyetja 15

Dallimi midis investimit bruto dhe investimit neto është

- A) Amortizimi i stokut ekzistues të kapitalit
- B) Investimi autonom
- C) Investimet e huaja direkte
- D) Gjendja në inventar

Pyetja 16

Në ekonomi kur një prodhues çeliku i shtet çelikun prodhuesit të makinave, ai konsiderohet si:

- A) Një e mirë përfundimtare
- B) Një e mirë e ndërmjetme
- C) Konsum
- D) Investim

Pyetja 17

PBB nominale mat të ardhurat _____

- A) Në kohën e tanishme
- B) Korrigjuar për ndryshimet tatimore
- C) Korrigjuar për ndryshimet në normat e interesit
- D) Me çmimet aktuale

Pyetja 18

PBB real mat të ardhurat _____

- A) Duke përfshirë aktivitetet jotregtare
- B) Përshtatur për inflacionin
- C) Duke përfshirë eksternalitetet
- D) Përfshirë evazionin fiskal

Pyetja 19

PBB reale mat deri diku mirëqenien kombëtare sepse përjashton

- A) Konsumin
- B) Investimin
- C) Eksportet
- D) Punën në shtëpi

Pyetja 20

Në një model makroekonomik pa tregti të jashtme dhe pa sektor shtetëror, kërkesa agregate është shuma e

- A) Kursimeve personale dhe investimeve private
- B) Kursimeve personale dhe konsumit personal
- C) Konsumit personal dhe investimit privat
- D) Kursimit personal dhe taksave

Pyetja 21

Duke u nisur nga një buxhet i balancuar, për një normë të caktuar takse, një rritje e të ardhurave do të shkaktojë që buxheti i qeverisë:

- A) Të kalojë në tepriçë
- B) Të kalojë në deficit
- C) Të mbetet i pandryshuar
- D) Të rritet

Pyetja 22

Për një nivel të dhënë të shpenzimeve dhe taksave qeveritare, deficitet buxhetor të qeverisë do të rritet në _____ dhe do të bjerë në _____

- A) Pikën më të lartë, në pikën më të lartë të ciklit t biznesit
- B) Recesion, recesion
- C) Në pikën më të lartë, recesion
- D) Recesion, në pikën më të lartë

Pyetja 23

PBB për frymë mund të jetë një matës jo I plote i mirëqenies ekonomike sepse përjashton

- A) Vlerën e kohës së lirë
- B) Konsumin
- C) Mallrat e tregtueshme
- D) Shpërndarjen e të ardhurave

Pyetja 24

Prodhimi i mundshëm mund të rritet me _____ ose me _____

- A) Rritjen e përdorimit të punës, rritjen e përdorimit të tokës
- B) Rritjen e përdorimit të kapitalit, rritjen e përdorimit të punës
- C) Rritjen e përdorimit të tokës, rritjen e përdorimit të kapitalit
- D) Rritja e përdorimit të të gjitha inputeve, përparimet teknologjike

Pyetja 25

Një aktivitet ekonomik që do të ishte e vështirë të financohej ose subvencionohej nga shteti është:

- A) Investimi i teknologjisë së një firme
- B) Zhvillimi i një sistemi të ri armatimi
- C) Zhvillimi i një shpikjeje të re për kontrollin e smogut
- D) Zhvillimi i varieteteve të përmirësuara të drithit

Pyetja 26

Ndërhyrjet e shtetit për të korrigjuar dështimet e tregut mund të përballojnë probleme te vecanta në demokraci sepse:

- A) Institucionet demokratike mund të dështojnë në marrjen parasysh të intensitetit të preferencave
- B) Institucionet demokratike nuk mund të mbështeten në përpilimin e zgjedhjeve të qëndrueshme
- C) Institucionet demokratike do të tentojnë të dominohen nga interesat speciale
- D) Institucionet demokratike mund të mbështeten në përpilimin e zgjedhjeve të qëndrueshme

Pyetja 27

Efiçenca në shpërndarje arrihet kur:

- A) Çmimi barazon koston sociale marxhinale
- B) Firmat maksimizojnë fitimet
- C) Përfitimet sociale marxhinale barazojnë kostot eksternale
- D) Kostot sociale marxhinale janë zero

Pyetja 28

Një taksë e cila kap një pjesë të vogël të të ardhurave të ulëta sesa të të ardhurave të larta është

- A) Përpjesëtimore
- B) Rënëse
- C) Progresive
- D) Regressive

Pyetja 29

Cila nga vlerat e mëposhtme do të përfshihet në llogaritjen e PBB të vitit korrent:

- A) Beni blen një kopje të re të librit të ekonomiksit për kursin që po ndjek
- B) Mira blen një kompiuter të përdorur
- C) Ana blen 100 aksione në bursë
- D) Bora shet librin e ekonomiksit që e kishte blerë një vit më parë

Pyetja 30

Produktë kombëtar bruto llogaritet:

- A) Duke shumëzuar sasinë e çdo produkti apo shërbimi final me çmimin përkatës por zbritet më parë nga vlera e tyre amortizimi.
- B) Duke mbledhur së bashku të gjitha shpenzimet e bëra për të gjitha mallrat dhe shërbimet finale të prodhuara
- C) Duke mbledhur së bashku të gjitha të ardhurat që përftojnë ekonomitë familjare nga shitja e shërbimeve
- D) Duke mbledhur sasine e faktorëve të prodhimit me çmimet e tyre përkatëse

Pyetja 31

Supozojmë se investimet bruto përbënin 10% të PBB-së, por ato kanë rënë në zero gjatë vitit në vazhdim. Atëherë themi që gjatë vitit në vazhdim:

- A) Amortizimi ka të njëjtën vlerë si investimet neto
- B) Amotizimi ka të njëjtën vlerë si investimet bruto
- C) Amortizimi është zero
- D) Investimet neto janë zero

Pyetja 32

Në qoftë se PBB nominal rritet nga 4000 milionë lekë në 4600 milion lekë dhe deflatori i PBB-së rritet nga 125 në 150 atëherë;

- A) Informacioni i dhënë nuk mjafton
- B) PBB real është rritur
- C) PBB real është ulur
- D) PBB real ka mbetur i pandryshuar

Pyetja 33

Çmimi i shitjes së një makine u rrit nga 9000 lekë në 10500 lekë ndërsa pagesat për inpute të ndërmjetme rriten nga 6000 lekë në 7000 lekë. Si rrjedhojë vlera e shtuar për çdo makinë llogaritet:

- A) 1500 lekë
- B) 500 lekë
- C) 1000 lekë
- D) 0 lekë

Pyetja 34

Në qoftë se PBB nominal është 150 dhe PBB real është 125, atëherë vlera e deflatorit % do të jetë:

- A) 1.20
- B) 0.80
- C) 120
- D) 80

Pyetja 35

Duke u nisur nga ekuilibri makroekonomik në periudhën afatgjatë, cilat nga situatat e mëposhtme do ta zhvendosë lartë kurbën e kërkesës agregate (AD) në periudhën afatshkurtër?

- A) Një rritje në shpenzimet e Investimeve
- B) Një rritje e popullsisë aktive
- C) Një rritje në rendimentin e punës
- D) Një rënie në cmimin e energjisë elektrike

Pyetja 36

Një përmirësim në teknologji do të zhvendosë:

- A) Kurbat afatshkurtra të AD dhe AS në të djathtë
- B) Kurbat afatshkurtra të AD dhe AS në të majtë
- C) Kurbën afatshkurtër të AS në të djathtë dhe mban të pa ndryshuar kurbën afatgjatë AS
- D) Kurbat afatshkurtra dhe afatgjata të AS në të djathtë.

Pyetja 37

Një përqendrim në teknologji do të zhvendosë:

- A) Kurbat afatshkurtra të AD dhe AS në të djathtë
- B) Kurbat afatshkurtra të AD dhe AS në të majtë
- C) Kurbën afatshkurtër të AS në të majtë dhe mban të pa ndryshuar kurbën afatgjatë AS
- D) Kurbën e AD në të djathtë
- E)

Pyetja 38

Cikël biznesi është:

- A) Një model tregu
- B) Një model i zgjerimit ose ngushtimit të aktivitetit ekonomik
- C) Një rritje e PBB reale
- D) Një ulje e PBB reale

Pyetja 39

Bilanci i buxhetit të shtetit është diferenca midis:

- A) Të ardhurave të disponueshme dhe shpenzimeve të konsumatorëve
- B) Të ardhurave të disponueshme dhe shpenzimeve qeveritare
- C) Të ardhurave kombëtare dhe shpenzimeve qeveritare
- D) Të ardhurave kombëtare dhe shpenzimeve agregate për investime

Pyetja 40

Nëse të ardhurat nga taksat janë 2.5 miliard lekë dhe shpenzimet qeveritare janë 2 miliard lekë, atëherë themi që buxheti i shtetit është:

- A) Me defiçit buxhetor

- B) Me tepricë buxhetore
- C) I balancuar
- D) Me deficit 500 mijë lekë

Pyetja 41

Cili nga faktorët e mëposhtëm do të shkaktonte një zvogëlim të Ofertës Agregate AS:

- A) Ulja e shpenzimeve qeveritare
- B) Ulja e eksporteve neto
- C) Ulja e numrit të popullsisë aktive
- D) Realizimi i një përmirësimi teknologjik

Pyetja 42

Cili nga faktorët e mëposhtëm do të shkaktojë zhvendosje djathtas të kërkesës agregate AD:

- A) Një rritje në nivelin e çmimeve
- B) Një rritje në normën e interesit
- C) Një ulje në normat e interesit
- D) Një ulje në nivelin e çmimeve

Pyetja 43

Kërkesa agregate pa sektorin e tregtisë ndërkombëtare është shuma:

- A) $C + I$
- B) $C + G$
- C) $I + G$
- D) $C + I + G$

Pyetja 44

Kërkesa agregate për një ekonomi që ka tregëti ndërkombëtare dhe sektor shtetëror mund të shkruhet si:

- A) $AD = C + I$
- B) $AD = C + I + G$
- C) $AD = C + I + G + X - M$
- D) $AD = C + I + G + X + M$

Pyetja 45

Kur niveli i të ardhurave _____ do të ketë një tendencë përmirësimi të bilancit tregëtar nëse importet _____

- A) Rritet, rriten
- B) Bie, rriten
- C) Bie, bien
- D) Rritet, pësojnë rënie

Pyetja 46

Kurba e kërkesës agregate (AD) tregon se inflacioni _____ është i lidhur me prodhimin _____

- A) Më i lartë, më të ulët
- B) Më i lartë, më të lartë
- C) Më i ulët, më të ulët
- D) Zero, zero

Pyetja 47

Modeli klasik i makroekonomisë supozon

- A) Pagat dhe çmimet janë fiks
- B) Pagat dhe çmimet janë fleksibël
- C) Ekonomia mund të funksionojë nën kapacitetin e plotë
- D) Ekonomia është gjithmonë me kapacitet të plotë

Pyetja 48

Në modelin klasik, prodhimi potencial nuk mund të rritet nga:

- A) Rritja monetare
- B) Teknologjia më e mirë
- C) Më shumë kapital
- D) Ofertë më e lartë e fuqisë punëtore

Pyetja 49

Në teorinë neoklasike të rritjes, një normë më e lartë kursimi çon në _____

- A) Një normë më të lartë rritjeje
- B) Një normë rritjeje luhatëse
- C) Një normë më të ulët rritjeje
- D) Asnjë ndryshim në normën e rritjes

Pyetja 50

Rritja ekonomike mund të varet nga _____ dhe _____

- A) Madhësia e popullsisë, eficientia
- B) Shpërndarja e popullsisë në moshë, arsimit
- C) Rritja e popullsisë, progresi teknik
- D) Rritja e popullsisë, arsimit

Pyetja 51

Normat e rritjes së ekonomive priren të konvergojnë sepse _____ është më e lehtë kur kapitali për punëtor është i ulët dhe për shkak të _____

- A) Zgjerimi i kapitalit, inovacionit teknik
- B) Zgjerimi i kapitalit, adaptimit të teknologjisë
- C) Thellimi i kapitalit, inovacionit teknik

D) Thellimi i kapitalit, adaptimit të teknologjisë

Pyetja 52

Cikli i biznesit përshkruan luhatjet e prodhimit duke shfaqur:

- A) Trendin e prodhimit
- B) Bumin (pikën më të lartë)
- C) Recesionin
- D) Luhatjet afatshkurtra të prodhimit

Pyetja 53

Të gjitha sa vijojnë janë pjesë e ciklit të biznesit përveç:

- A) Bumi (pika më e lartë)
- B) Rënia
- C) Rritja
- D) Stabiliteti

Pyetja 54

Modeli multiplikator-akslerator supozon se _____ varet nga _____

- A) Konsumi, fitimet e pritshme në të ardhmen
- B) Investimet, normat e interesit
- C) Investimi, fitimet e pritshme në të ardhmen
- D) Kursimi, normat e interesit

Pyetja 55

Teoria e ciklit të biznesit sugjeron që _____ jo i/e rëndësishme në shpjegimin e luhatjeve afatshkurtra të prodhimit aktual

- A) Oferta agregate është
- B) Kërkesa agregate është
- C) Outputi potencial është
- D) Variablat reale janë

Pyetja 56

Teoria e cikleve reale të biznesit fokusohet në shpjegimin e luhatjeve të:

- A) Prodhimit potencial
- B) Prodhimit aktual
- C) Prodhimit real
- D) Tregtisë ndërkombëtare

Pyetja 57

Cili nga faktorët e mëposhtme do të shkaktojë zhvendosjen djathtas të kurbës së kërkesës agregate:

- A) Një rritje në normat e interesit (për një nivel të dhënë të çmimit)
- B) Një rritje në inflacionin e pritshëm
- C) Një rritje në taksa
- D) Një rënie në nivelin e çmimeve

Pyetja 58

Oferta agregate në afat të gjatë paraqet nivelin e PBB-së reale në të cilën:

- A) Çdo firmë prodhon me kapacitetin e saj prodhues
- B) Ekziston punëzënie e plotë
- C) Ekonomia prodhon në kufijtë e saj fizike
- D) Çdo firmë prodhon në kapacitetin prodhues dhe ekziston punëzënia e plotë
- E) Çmimet me siguri do të rriten

Pyetja 59

Oferta agregate në afate të shkurtra (SAS) paraqet lidhjen midis nivelit të çmimeve dhe sasisë së PBB reale të ofruar duke mbajtur konstant:

- A) Normën e pagës
- B) Nivelin e konsumit
- C) Nivelin e shpenzimeve qeveritare
- D) Nivelin e çmimeve

Pyetja 60

SAS ka pjerrësi pozitive, por tenton të bëhet vertikale në atë nivel të PBB-së reale në të cilin:

- A) PBB reale bëhet e barabartë me produktin potencial
- B) PBB reale është me vogël se produkti potencial
- C) Ekonomia është në punëzënie e plotë
- D) Ekonomia është në pikën kur SAS pret kurbën AD

Pyetja 61

Një përmirësim teknologjik do të zhvendosë:

- A) Kurbat afatshkurtra AD dhe AS në të djathtë
- B) Kurbat afatshkurtra dhe afatgjata AS zhvendosen djathtas
- C) Kurbën afatshkurtër AS në të djathtë dhe mban të pa ndryshuar kurbën afatgjatë AS
- D) Kurbat afatshkurtra AD dhe AS në të majtë

Pyetja 62

Në radhën e faktorëve të mëposhtëm cili do të shkaktonte një zvogëlim të ofertës agregate, AS:

- A) Rritja e shpenzimeve qeveritare

- B) Ulja e eksporteve neto
- C) Ulja e numrit të popullsisë aktive
- D) Realizimi i një përmirësimi teknologjik

Pyetja 63

Në qoftë se çmimet e inputeve mbeten konstante dhe firmat prodhojnë në kufijtë e tyre fizike, atëherë një rritje e AD-së do të sjellë:

- A) Një rritje të nivelit të çmimeve dhe një rritje të PBB reale
- B) Një rritje të nivelit të çmimeve dhe një rënie të PBB-së reale
- C) Një rënie të nivelit të çmimit dhe një rritje të PBB reale
- D) Një rënie të çmimeve dhe të PBB-së reale

Pyetja 64

Në një ekonomi vërehet një rritje e nivelit të çmimeve dhe një rritje e GDP-së reale. Cila nga alternativat e mëposhtme jep shpjegim për këtë situatë.

- A) Oferta për para ka rënë
- B) Pasuria e përgjithshme ka rënë
- C) Çmimet e lëndëve të para janë rritur
- D) Stoku i kapitalit (pra niveli i investimeve) është rritur

Pyetja 65

Një ekonomi nuk mund të qëndrojë gjithmonë në nivelin ku PBB reale është më e madhe se produkti potencial, pra mbi nivelin e ofertës agregate afatgjatë sepse çmimet e inputeve do të kenë:

- A) Rënie, domethënë zhvendosje djathtas e kurbës LAS
- B) Rënie, domethënë zhvendosje djathtas e kurbës SAS
- C) Rritje, domethënë zhvendosje majtas e kurbës SAS
- D) Rritje, domethënë zhvendosje djathtas e kurbës SAS

Pyetja 66

Në qoftë se niveli i çmimeve rritet, kërkesa për para:

- A) Rritet si rrjedhim kërkesa agregate rritet
- B) Rritet si rrjedhim kërkesa agregate ulet
- C) Ulet dhe si rrjedhim kërkesa agregate rritet
- D) Ulet si rrjedhim kërkesa agregate ulet

Pyetja 67

Në qoftë se çmimet e inputeve mbeten konstante dhe firmat prodhojnë në kufijtë e tyre fizike, atëherë një ulje e AD-së do të sjellë:

- A) Një rritje të nivelit të çmimeve dhe një rritje të PBB reale
- B) Një rritje të nivelit të çmimeve dhe një rënie të PBB-së reale

- C) Një rënie të nivelit të çmimit dhe një rritje të PBB reale
- D) Një rënie të çmimeve dhe të PBB-së reale

Kapitulli 5. Ekuilibri makroekonomik në modelin e thjeshtë të ekonomisë. Modeli shpenzime- të ardhura. Inflacioni dhe papunësia

Pyetja 1

Në bazë të dhënave të mëposhtëme për një ekonomi: $C_0=100$, $I = 50$, $G =40$, $T=10$ $MPC= 0.8$.

Funksioni i konsumit është:

- A) $C= -100+0.2Y_d$
- B) $C= 100 - 0.8Y_d$
- C) $C= -100-0.2Y_d$
- D) $C= 100+0.8Y_d$

Pyetja 2

Në bazë të dhënave të mëposhtëme për një ekonomi: $C_0=100$, $I = 50$, $G =40$, $T=10$ $MPC= 0.8$.

Funksioni i kursimit është:

- A) $S= -100+0.2Y_d$
- B) $S= -100 - 0.8Y_d$
- C) $S= -100-0.2Y_d$
- D) $S= 100+0.2Y_d$

Pyetja 3

Në bazë të dhënave të mëposhtëme për një ekonomi: $C_0=100$, $I = 50$, $G =40$, $T=10$ $MPC= 0.8$.

Niveli ekuilibër i të ardhurave të disponueshme është:

- A) 100
- B) 300
- C) 500
- D) 700

Pyetja 4

Në bazë të dhënave të mëposhtëme për një ekonomi: $C_0=100$, $I = 50$, $G =40$, $T=10$ $MPC= 0.8$.

Niveli ekuilibër i të ardhurave për këtë ekonomi është

- A) 200
- B) 910
- C) 820
- D) 828

Pyetja 5

Një funksion linear konsumi me një pjerrësi pozitive më të vogël se një do të thotë se nëse të ardhurat rriten, konsumi do të _____

- A) Bjerë
- B) Mbetet i pandryshuar
- C) Luhatet
- D) Rritet

Pyetja 6

Prodhimi në ekuilibër in afatshkurtër do të thotë që kërkesa agregate _____ prodhimi aktual

- A) Eshtë më e vogël se
- B) Eshtë e barabartë me
- C) Eshtë më i madh se
- D) Luhatet rreth

Pyetja 7

Nëse shpenzimet në ekonomi i tejkalojnë të ardhurat, ne do të prisnim që:

- A) Familjet të kursejnë më shumë
- B) Firmat të prodhojnë më pak
- C) Firmat të prodhojnë më shumë
- D) Prirja marzhinale për konsum (MPC) të ndryshojë

Pyetja 8

Kur investimi supozohet të jetë autonome në një ekonomi, pjerrësia e kurbës së AD (kërkesës agregate) përcaktohet nga _____

- A) Prirja margjinale për të investuar
- B) Të ardhurat e disponueshme
- C) Prirja margjinale për të konsumuar
- D) Prirja mesatare për konsum

Pyetja 9

Multiplikatori na tregon se sa ndryshon _____ pas një ndryshimi në _____

- A) Konsumi, të ardhura
- B) Investimi, prodhim
- C) Kursimi, investime
- D) Prodhimi, kërkesë agregate

Pyetja 10

Multiplikatori llogaritet si:

- A) $1/(1 - MPC)$
- B) $1/(1 - MPS)$

- C) $1/MPC$
- D) $1/MPS$

Pyetja 11

Nëse MPC është 0,5, multiplikatori është _____

- A) 2
- B) $1/2$
- C) 0.2
- D) 20

Pyetja 12

Nëse si rezultat i dëshirës së familjeve për të kursyer më shumë, ka një ndryshim në të ardhurat ekuilibër dhe asnjë ndryshim në kursimet ekuilibër, ky është një shembull i _____

- A) Papërsosmërisë së tregut
- B) Ligji i të ardhurave marxhinale rënëse
- C) Paradoksi i kursimit
- D) Dështimi i tregut

Pyetja 13

Masa e kursimi varet nga të gjitha të mëposhtmet përveç:

- A) Të ardhurave të konsumatorëve
- B) Shpenzimeve për investime nga firmat dhe bizneset
- C) Normave të interesit bankar
- D) Parashikimit të individëve për të ardhmen,

Pyetja 14

Kursimet tona mund t'i përdorim për të gjitha, përveç:

- A) Për të blerë bono thesari,
- B) Për të blerë aksione/investim në biznes:
- C) Për të blerë pasuri të patundshme;
- D) Për të ndërtuar shkolla dhe çerdhe publike

Pyetja 15

Nëse jeni të interesuar të kurseni paratë e fituara nga puna, duhet ti mbani ato:

- A) Në depozitë me afat
- B) Depozitë pa afat
- C) Në llogari rrjedhëse
- D) Me fajde

Pyetja 16

Cila nga të mëposhtmet është e vërtetë për likuiditetin:

- A) Një mjet likuid shitet shpejt dhe pa kosto me një çmim të barabartë me vlerën e tij të vërtetë
- B) Një mjet likuid shitet shpejt, por me kosto më të lartë.
- C) Sa më likuid të jetë mjeti, aq më e vështirë është për ta kthyer atë në para
- D) Likuiditeti nuk është i rëndësishëm në përcaktimin se ku do të investojmë paratë e kursyera

Pyetja 17

Cila nga llogaritë e mëposhtme bankare është më likuide?

- A) Llogaria rrjedhëse
- B) Depozita me afat 6 mujor
- C) Depozitë me afat 2 vjeçar
- D) Depozitë me afat 1 vjeçar

Pyetja 18

Cila nga llogaritë e mëposhtme bankare është më pak likuide?

- A) Llogaria rrjedhëse
- B) Depozita me afat 6 mujor
- C) Depozitë me afat 2 vjeçar
- D) Depozitë me afat 1 vjeçar

Pyetja 19

Investimi i kursimeve në pasuri të patundshme, krahasuar me mbajtjen e parasë në format të tjera:

- A) Është më i sigurtë por më pak likuid
- B) Nuk është aspak i sigurtë
- C) Është më pak i sigurtë, por më likuid
- D) Nuk është as i sigurtë dhe as likuid

Pyetja 20

Investimi i kursimeve në bono thesari konsiderohet se është:

- A) Më i mirë se investimi në depozita kursimi në bankë nisur nga norma e interesit
- B) Më pak i sigurtë se investimi në depozita kursimi në bankë
- C) Më pak i sigurtë se investimi në biznes
- D) Më i sigurtë se investimi në pasuri të patundshme

Pyetja 21

Funksioni i konsumit tregon lidhjen midis shpenzimeve të konsumit dhe:

- A) PBB-së reale

- B) Të ardhurave të disponueshme
- C) Normës së interesit
- D) Nivelit të çmimeve

Pyetja 22

Kursimet bëhen 0 në qoftë se:

- A) Të ardhurat personale = Të ardhurat e disponueshme
- B) Konsumi = Të ardhurat e disponueshme.
- C) $C+I$ = Produktin kombëtar
- D) $C+I$ = Shpenzimet agregate

Pyetja 23

Pjerrësia e funksionit të konsumit është e barabartë me

- A) MPC
- B) MPS
- C) $MPS + 1$
- D) $1-MPC$

Pyetja 24

Supozojmë se të ardhurat e disponueshme vjetore janë 20000 lekë. Në qoftë se blerësi realizon shpenzime konsumi në masën 17000 lekë atëherë:

- A) Prirja marxhinale për konsumin është 0,7
- B) Prirja marxhinale për konsum është 0,85
- C) Prirja mesatare për konsum është 0,85
- D) Prirja marxhinale për konsum është 0,15.

Pyetja 25

Në qoftë se prirja marxhinale për konsum (MPC) është më e vogël se prirja marxhinale për kursim (MPS), atëherë një rritje në të ardhurat e disponueshme sjell:

- A) Rritjen e APC
- B) Rënien e APC
- C) Rënien e MPC
- D) Rritjen e MPC

Pyetja 26

Cili nga ndryshimet e mëposhtme do të zhvendosë lart kurbën e funksionit të konsumit

- A) Një rritje në të ardhurat e disponueshme aktuale
- B) Një rritje në të ardhurat e pritshme
- C) Një rritje në normën e interesit
- D) Një zvogëlim në të ardhurat e pritshme

Pyetja 27

Në qoftë se MPC është $\frac{3}{4}$, atëherë një rritje në të ardhura disponueshme do të sjellë:

- A) Rritjen e konsumit në masën 3 herë më shumë se të ardhurat disponueshme
- B) Rritjen e konsumit në masën 4 herë më shumë se të ardhurat disponueshme
- C) Rritjen e konsumit dhe pakësimin e kursimit
- D) Rënien e konsumit dhe rritjen e kursimit

Pyetja 28

Supozojmë se funksioni i konsumit është një vijë e drejtë. Atëherë:

- A) Konsumi përfaqëson një pjesë fikse të të ardhurave
- B) MPC është konstante në çdo pikë të vijës së konsumit
- C) MPC bëhet gjithnjë e më e vogël sa më tepër zvogëlohen të ardhurat
- D) MPS bëhet gjithnjë e më e vogël sa më tepër zvogëlohen të ardhurat

Pyetja 29

Në qoftë se shpenzimet e konsumit bien me 45 miliardë lekë kur të ardhurat e disponueshme kanë rënë me 50 miliardë lekë atëherë MPC është:

- A) 0.9
- B) 0.1
- C) -0.9
- D) -0.1

Pyetja 30

Cila nga alternativat e mëposhtme çon në një rritje të sasisë së investimeve:

- A) Një rritje në normat e interesit
- B) Një rritje në normat e pritshme të inflacionit
- C) Një rënie në fitimet e pritshme
- D) Një zvogëlim në normën e inflacionit

Pyetja 31

Në qoftë se norma e interesit është 12 për qind dhe norma e pritshme e inflacionit do të jetë 8 për qind, atëherë norma reale e interesit do të jetë:

- A) 4%
- B) 12%
- C) 20%
- D) 4.8%

Pyetja 32

Nëse të ardhurat e disponueshme rriten atëherë:

- A) Niveli i kursimit do të bjerë
- B) Niveli i investimeve parashikohet të bjerë

- C) Niveli i konsumit do të rritet
- D) APS bie

Pyetja 33

Në qoftë se vija e konsumit zhvendoset lart kur të ardhurat e disponueshme nuk kanë ndryshuar, atëhere:

- A) Grafiku i kursimit do të zhvendoset lart gjithashtu
- B) Grafiku i kursimit do të zhvendoset poshtë
- C) Grafiku i kursimit mund të zhvendoset ose lart ose poshtë
- D) Grafiku i kursimit nuk do të ndryshojë

Pyetja 34

Nëse të ardhurat e disponueshme janë të barabarta me 375 milionë lek dhe $APC = 0.8$ atëhere mund të konkludojmë se:

- A) MPC është gjithashtu 0.8
- B) Konsumi është 325 milion lekë
- C) Kursimi është 75 milion lekë
- D) MPS është 0.2

Pyetja 35

Në qoftë se prirja marxhinale për konsum është 0.75 atëhere vlera e multiplikatorit për këtë ekonomi është:

- A) 0.25
- B) 4
- C) 7.5
- D) 10

Pyetja 36

Jepen të dhënat për një ekonomi: $C=60+0.6Y$ $I=I_0=30$. Niveli i ekuilibrit të të ardhuarve është:

- A) 90
- B) 135
- C) 225
- D) 360

Pyetja 37

Jepen të dhënat për një ekonomi: $C=60+0.6Y$ $I=I_0=30$. Në ekuilibër niveli i konsumit do të jetë:

- A) 195
- B) 215
- C) 160
- D) 270

Pyetja 38

Jepen të dhënat për një ekonomi: $C=60+0.6Y$ $I=I_0=30$. Në ekuilibër niveli i kursimit do të jetë:

- A) 22
- B) 60
- C) 26
- D) 30

Pyetja 39

Jepen të dhënat për një ekonomi: $C=60+0.6Y$ $I=I_0=30$. Multiplikatori për këtë ekonomi është:

- A) 1.66
- B) 2.5
- C) 3.15
- D) 2.38

Pyetja 40

Inflacioni ndodh atëherë kur:

- A) Pagat rriten
- B) Çmimet e disa mallrave rriten
- C) Niveli i përgjithshëm i cmimeve rritet
- D) Kostoja e shportës së mallrave rritet shumë

Pyetja 41

Në qoftë se norma e inflacionit gjatë vitit 2019 ishte 4%, atëherë ekonomia përballet me:

- A) Inflacion të moderuar
- B) Inflacion galopant
- C) Deflacion
- D) Hiperinflacion

Pyetja 42

Lindita vendos të lër punën e saj si specialiste në administratën vendore në një qytet të vogël dhe të zhvendoset në kryeqytet për të ndjekur studimet Master në Financë dhe të aplikoj për punë në sistemin bankar. Me çfarë forme të papunësisë përballet ajo:

- A) Papunësi sezonale
- B) Papunësi friksionale
- C) Papunësi ciklike
- D) Papunësi strukturore

Pyetja 43

Papunësia ciklike shkaktohet nga:

- A) Ndryshime teknologjike
- B) Rritja e ofertës agregate

- C) Papunësia vullnetare në një pjesë të fuqisë punëtore
- D) Pakësimi i kërkesës agregate për mallra dhe shërbime në gjithë ekonominë, gjë e cila shkakton një rritje të njerëzve të papunë.

Pyetja 44

Në qoftë se norma e inflacionit gjatë vitit 2021 ishte 120%, atëherë ekonomia përballet me:

- A) Inflacion të moderuar
- B) Inflacion galopant
- C) Hiperinflacion
- D) Deflacion

Pyetja 45

Cila nga situatat e mëposhtme do të rritë papunësinë:

- A) Një rritje e numrit të njerëzve që dalin në pension
- B) Një rritje e numrit të grave që marrin lejen e lindjes
- C) Një rritje e numrit të njerëzve të dekurajuar nga puna
- D) Një rritje në numrin e njerëzve që lënë shkollën për të hyrë në punë

Pyetja 46

Një rritje e shpenzimeve qeveritare mund të shkaktojë:

- A) Një inflacion nga oferta
- B) Një inflacion nga kërkesa
- C) Stagflacion
- D) Deflacion

Pyetja 47

Një ulje e shpenzimeve qeveritare mund të shkaktojë:

- A) Një inflacion nga oferta
- B) Një inflacion nga kërkesa
- C) Stagflacion
- D) Deflacion

Pyetja 48

Në situatë inflacioniste përfitojnë:

- A) Njerëzit me të ardhura fikse;
- B) Kursimtarët
- C) Huadhënësit
- D) Huamarrësit.

Pyetja 49

Supozojmë se popullsia civile e aftë për punë jo e institucionalizuar në një ekonomi është e barabartë me 150 000, forca e punës e barabartë me 130 000, nga të cilët 110 000 janë të punësuar dhe 20 000 të papunë. Sa është numri i njerëzve në përqindje që janë të papunë?

- A) 15.68%
- B) 15.2%
- C) 15.38%
- D) 16.2%.

Pyetja 50

Supozojmë se popullsia civile e aftë për punë jo e institucionalizuar në një ekonomi është e barabartë me 150 000, forca e punës e barabartë me 130 000, nga të cilët 110 000 janë të punësuar dhe 20 000 të papunë. Norma e punësimit (E) për këtë ekonomi do të jetë:

- A) 73%
- B) 73.3 %
- C) 73.8%
- D) 75.6%.

Pyetja 51

Nëse një person mendon se është më mirë pas një rritje pagash prej 10%, dhe të gjitha çmimet janë rritur 10%, atëherë ai po përjeton _____

- A) Inflacion
- B) Një goditje në anën e ofertës
- C) Rritje të të ardhurave personale
- D) Iluzion nga inflacioni

Pyetja 52

Norma e ekuilibrit të inflacionit përcaktohet nga prerja e _____ dhe _____

- A) Kërkesës, ofertës
- B) IS, LM
- C) AD, AS
- D) Kërkesës për punë, ofertës për punë

Pyetja 53

Modeli Keynesian është një udhëzues i mirë për sjelljen _____ dhe modeli klasik përshkruan sjelljen në _____

- A) Afatgjatë, afatshkurtër
- B) Fleksibël, tregje jo perfekte
- C) Afatshkurtër, afatgjatë
- D) Në tregjet afatgjata, tregje jo perfekte

Pyetja 54

Në rast të rritjes së çmimit ndërkombëtar të naftës që inkurajoi bankën qendrore të pranonte norma më të ulëta interesi reale, ka shumë të ngjarë që inflacioni do të _____

- A) Bjerë
- B) Rritet
- C) Mbeten të njëjta
- D) Luhartet

Pyetja 55

Gjatë periudhave të rritjes së inflacionit dhe rritjes së normave të interesit ne presim që kërkesa për para reale

- A) Rritet
- B) Bjerë
- C) Nuk ndryshon
- D) Të luhartet

Pyetja 56

Qeveritë mund të kontribuojnë në presionin inflacionist duke:

- A) Rritur numrin e punonjësve
- B) Hartuar planet e mirëqenies
- C) Financuar defiçitin buxhetor
- D) Rritur shpenzimet

Pyetja 57

Kurba e Phillips tregon lidhjen midis _____ dhe _____

- A) Normës së inflacionit, normës së interesit
- B) Normës së inflacionit, normës së papunësisë
- C) Normës së interesit, prodhimit
- D) Outputit, punësimi

Pyetja 58

Kurba afatgjatë e Phillips është _____ në _____

- A) Horizontale, normën natyrore të inflacionit
- B) Horizontale, në normën natyrore të papunësisë
- C) Vertikale, normën natyrore të inflacionit
- D) Vertikale, normën natyrore të papunësisë

Pyetja 59

Kurba e Phillips afatshkurtër mund të zhvendoset në përgjigje të ndryshimeve në _____

- A) Pritjet inflacioniste
- B) Normën e papunësisë

- C) Normën e inflacionit
- D) Normat e pagave

Pyetja 60

Kostot e inflacionit janë

- A) Kostot e mbetjes i papunë
- B) Kostot e ngrënies në restorant
- C) Rishpërndarja e të ardhurave
- D) Çmimet për të ardhmen

Pyetja 61

Një person që lirohet nga puna për shkak të tkurrjes së një industrie konsiderohet si lloj i papunësisë:

- A) Së fërkimit
- B) Nga mungesa e kërkesës
- C) Ciklike
- D) Strukture

Pyetja 62

Një mbrojtës i modelit klasik të ekonomisë do të pretendonte se papunësia krijohet kur _____ është mbi nivelin e tij ekuilibër në _____

- A) Niveli i çmimeve, ekonomi
- B) Norma tatimore, buxhetin e qeverisë
- C) shkalla e pagës, tregun e punës
- D) Norma e interesit, tregun për fondet e huazueshme

Pyetja 63

Nëse dikush është i përgatitur të punojë me pagën e vazhdueshme, por nuk mund të gjejë punë, atëherë ata janë të

- A) Papunë vullnetare
- B) Papunë klasike
- C) Papunë strukturorë
- D) Papunë nga papunësia e ferkimit

Pyetja 64

Politikat për të reduktuar papunësinë duke ulur fuqinë e sindikatave, shkurtime të taksave, reduktimet e përfitimit të papunësisë dhe subvencionet e investimeve janë shembuj të _____

- A) Politikave kejsiane
- B) Politikave nga ana e ofertës
- C) Politikave monetariste
- D) Politikave klasike

Pyetja 65

Shkaku i mundshëm i papunësisë së pavullnetshme është:

- A) Mosmarrëveshjet për pagën minimale
- B) Fuqia e sindikatave
- C) Disekonomitë e shkallës
- D) Paga efciente

Kapitulli 6. Marrëdhëniet ekonomike ndërkombëtare. Banka Qendrore dhe politika monetare. Politika fiskale

Pyetja 1

Tregtia midis vendeve bazohet në avantazhet:

- A) Absolute
- B) Krahasuese
- C) Analitike
- D) Teknologjike.

Pyetja 2

Nëse shqiptarët duan më shumë euro për të blerë më shumë verë franceze, kur kushtet e tjera nuk ndryshojnë, atëherë vlera e ekuilibrit të lekut kundrejt euros do të _____

- A) Rritet
- B) Bjerë
- C) Nuk ndryshon
- D) Luhatet

Pyetja 3 2

Kur kursi i këmbimit ALL (Lek)/euro rritet, Euro _____, dhe kur kursi i ALL (Lek)/euro bie, Euro _____

- A) Vlerësohet, vlerësohet
- B) Rivlerësohet, zhvlerësohet
- C) Vlerësohet, zhvlerësohet
- D) Bëhet më e shtrenjtë, bëhet më e lirë

Pyetja 4

Në një regjim fiks kursi këmbimi, banka qendrore do të ndërhyjë duke _____ ALL (lekë) që të _____ kursin e këmbimit

- A) Shitur, rrisë
- B) Mbajtur të pandryshuar, zvogëlojë
- C) Shitur, zvogëlojë

D) Blerë, rrisë

Pyetja 5

Një deficit i llogarisë rrjedhëse do të thotë që një vend mund të _____

- A) Të zvogëlojë stokun e saj të mjeteve të huaja
- B) Rrisë stokun e mjeteve të huaja
- C) Rrisë kursimet e tij
- D) Rrisë rezervat e saj valutore

Pyetja 6

Duke u nisur nga pozicioni i bilancit të brendshëm dhe të jashtëm, një reduktim i kërkesës agregate do të shkaktojë një llogari rrjedhëse me _____

- A) Defiçit
- B) Tepricë
- C) Rivlerësim
- D) Zhvlerësim

Pyetja 7

Brenda fluksit rrethor të të ardhurave, një rritje e të ardhurave kombëtare, pritet të shkaktojë një rritje në:

- A) Eksporte
- B) Taksa
- C) Inventarë
- D) Importe

Pyetja 8

Kur lëvizshmëria e kapitalit është perfekte, diferencat e normave të interesit do të priten të kompensohen nga _____

- A) Diferencat e çmimeve
- B) Diferencat e bilancit të pagesave
- C) Diferencat e llogarisë korrente
- D) Ndryshimet e pritura të kursit të këmbimit

Pyetja 9

Me kurse fikse këmbimi dhe pa flukse kapitali privat, për të korrigjuar një deficit të bilancit të pagesave, banka qendrore do të _____ dhe _____

- A) Blejë valutë të huaj, do të shesë valutë vendase
- B) Shesë valutë të huaj, do të blejë valutë vendase
- C) Blejë valutë të huaj, do të blejë valutë vendase
- D) Shesë valutë të huaj, shesë valutë vendase

Pyetja 10

Me kurse fikse këmbimi dhe pa flukse valutore private, kur banka qendrore blen monedhë vendase, oferta e parasë vendase është _____

- A) Rritur
- B) E pandryshuar
- C) Reduktuar
- D) Luhatur

Pyetja 11

Një kurs këmbimi fiks, plus lëvizshmëri perfekte e kapitalit _____ operimin për politikën monetare

- A) Rrit
- B) Vë ne rrezik
- C) Inkurajon
- D) Lehtëson

Pyetja 12

Avantazhi konkurrues nga një zhvlerësim ka të ngjarë të kompensohet nga _____ dhe _____

- A) Çmime më të larta të importit, rritje më të larta pagash
- B) Çmime më të ulëta të eksportit, vëllime më të ulëta të importit
- C) Çmime më të larta të importit, çmime më të ulëta të eksportit
- D) Rritje pagash më të larta, vëllime më të ulëta importi

Pyetja 13

Në afat të shkurtër, niveli i kursit fleksibël të këmbimit përcaktohet kryesisht nga:

- A) Normat e interesit
- B) Konkurrenca
- C) Tregtia
- D) Spekulumet

Pyetja 14

Karakteristikat kryesore të sistemit monetar evropian janë

- A) Monedha e përbashkët
- B) Marrëveshje këmbimi valutor ndërmjet vendeve anëtare
- C) Kurs këmbimi i njëjtë
- D) Norma të njëjta interesi

Pyetja 15

Akti Unik Evropian angazhoi qeveritë e _____ për një _____ në vitin 1992

- A) Bashkimit Evropian, treg të vetëm
- B) Europës Perëndimore, zonë me monedhë të përbashkët

- C) Bashkimit Evropian, zonë me monedhë të përbashkët
- D) Evropës Perëndimore, treg të vetëm

Pyetja 16

Marrim në analizë dy vende A dhe B, që prodhojnë dy mallra X dhe Y. Vendi A ka avantazh krahasues në prodhimin e mallit X nqse:

- A) Duhet të heqë dorë nga një sasi më e vogël e mallit Y për të prodhuar 1 njësi të mallit X në A në krahasim me vendin B.
- B) Kërkohe më pak punë për të prodhuar 1 njësi të X në A në krahasim me vendin B
- C) Kërkohe më pak kapital për të prodhuar 1 njësi të X në A në krahasim me vendin B
- D) Kërkohe më pak punë dhe kapital për të prodhuar 1 njësi të X në A në krahasim me vendin B
- E) Duhet të hiqet dorë nga një sasi më e vogël e mallit X për të prodhuar 1 njësi të Y në A në krahasim me vendin B

Pyetja 17

Vendi C mund të prodhojë 1 ton ushqime ose 4 tonë qymyr me 1 njësi te burimeve. Vendi D mund të prodhojë 2 tonë ushqime ose 5 tonë qymyr me 1 njësi të burimeve. Në këto kushte është e vërtetë që:

- A) Vendi C do të eksportojë ushqime dhe do të importojë qymyr
- B) Vendi D do të eksportojë ushqime dhe importojë qymyr
- C) Vendi C as do të eksportojë dhe as do të importojë ushqime
- D) Vendi D as do të importojë dhe as do të eksportojë qymyr

Pyetja 18

Në qoftë se Franca eksporton verë në Angli dhe Anglia eksporton tekstile në Francë, rritja e çmimit të verës (në lidhje me çmimin e tekstileve) nënkupton:

- A) Përmirësimin e raporteve të këmbimit për Francën
- B) Ndryshimin e pjerrësisë së kurbës së mundësive të tregtimit për Francën
- C) Ndryshimin e pjerrësisë së kurbës së mundësive të tregtimit për Anglinë
- D) Përkeqësimin e raporteve të këmbimit për Francën

Pyetja 19

Teoria e avantazheve krahasuese thotë që ekzistojnë përfitime nga tregtia ndërkombëtare:

- A) Vetëm në qoftë se avantazhet krahasuese dhe absolute janë të pranishme në të dy vendet
- B) Në qoftë se kostot oportune janë të njëjta në vendet e përfshira
- C) Vetëm në qoftë se ekzistojnë ekonomi të shkallës
- D) Në qoftë se vendet specializohen në prodhimin e mallrave për të cilat ata janë më të efektshëm

Pyetja 20

Përfitimet nga specializimi dhe tregtia varen nga pjesa e avantazhit____, jo e avantazhit ____

- A) Absolut, krahasues
- B) Monetar, jomonetar
- C) Absolut, reciprok
- D) Krahasues, absolut

Pyetja 21

Vendosja e një tarife mbi mallrat e importuara do të rritë çmimin që konsumatorët paguajnë për mallrat e importuara dhe:

- A) Zvogëlon vëllimin e importeve dhe atë të eksporteve
- B) Zvogëlon vëllimin e importeve dhe rrit vëllimin e eksporteve
- C) Zvogëlon vëllimin e importeve dhe lë të pandryshuar vëllimin e eksporteve
- D) Nuk ndikon as vëllimin e importeve dhe as vëllimin e eksporteve

Pyetja 22

Qëllimi i tarifave është të:

- A) Pakësojnë importet për të mbrojtur industrinë e vendit dhe punëtorët nga konkurrenca e huaj
- B) Rrisin të ardhurat e paguara për koston e transportit
- C) Të reduktojnë kostot e prodhimit
- D) Ulin të ardhurat e paguara për koston e transportit

Pyetja 23

Një ndryshim midis tarifave dhe kuotave është që tarifat vetëm:

- A) Pakësojnë tregtinë
- B) Ngrenë çmimet
- C) Mbajnë shtetin me të ardhura
- D) Ulin standardin e jetesës për vendin në tërësi

Pyetja 24

Kush përfiton nga vendosja e një tarife mbi mallin X?

- A) Konsumatori i brendshëm i mallit X
- B) Prodhuesi i brendshëm i mallit X
- C) Konsumatori i jashtëm i mallit X
- D) Prodhuesi i jashtëm i mallit X

Pyetja 25

Vendosja e një tarife mbi mallin Y, i cili është importuar nga vendi A do të bënte që:

- A) Kurba e kërkesës për këtë mall në vendin A të zhvendoset lartë
- B) Kurba e kërkesës për këtë mall në vendin A të zhvendoset poshtë

- C) Kurba e ofertës për mallin Y në vendin A të zhvendoset poshtë
- D) Kurba e ofertës dhe ajo e kërkesës në vendin A zhvendosen larte

Pyetja 26

Në qoftë se vendoset një tarifë për një mall, diferenca që krijohet midis çmimit të brendshëm dhe çmimit të eksportit përfitohet nga:

- A) Konsumatorët në vendin importues
- B) Personi që ka të drejtë ta importojë mallin
- C) Prodhuesit e brendshëm të mallit.
- D) Eksportuesit e huaj

Pyetja 27

Tregu në të cilin monedha e një vendi këmbëhet me monedha të tjera quhet:

- A) Treg monetar
- B) Treg kapitali
- C) Treg i kursit të këmbimit
- D) Treg i këmbimeve të avancuara

Pyetja 28

Cili nga pohimet e mëposhtme është i vërtetë për bilancin e pagesave?

- A) Debitë e llogarive korrente duhet të barazojnë kreditë e llogarive korrente
- B) Pagesat e dukshme duhet të barazojnë ato të padukshmet
- C) Debitë totale duhet të barazojnë kreditë totale
- D) Pagesat e dëshiruara duhet të barazojnë pagesat aktuale

Pyetja 29

Dëshira e shqiptarëve për të investuar më shumë se më përpara në Itali, kur kushtet e tjera nuk ndryshojnë, do të shkaktonte:

- A) Ngritje të çmimit të euros kundrejt lekut
- B) Zhvendosje në të djathtë të kurbës së kërkesës për euro
- C) Zhvendosje në të djathtë të kurbës së ofertës për euro
- D) Zhvendosje të kurbave të ofertës dhe të kërkesës për euro në të majtë

Pyetja 30

Banka Qëndrore nuk nevojitet të ndërhyjë në tregun e këmbimit kur:

- A) Bilanci i pagesave është i barabartë me zero
- B) Bilanci llogarisë korrente duhet të jetë pikërisht i kundërt me bilancin e llogarisë kapital
- C) Llogaria e financimit zyrtar barazon llogarinë korrente
- D) Bilanci i pagesave është negativ

Pyetja 31

Vendi, llogaria kapitale e të cilit është me teprice:

- A) Pranon ardhjen e kapitalit të huaj
- B) Është blerës neto i aktiveve të huaja
- C) Merr më tepër interes nga të huajt sesa ai paguan për ata
- D) Paguan më tepër interes për të huajt sesa ai merr nga ata

Pyetja 32

Në qoftë se norma e interesit në Itali është më e madhe se norma e interesit në Shqipëri, pariteti i normës së interesit nënkupton që:

- A) Norma e inflacionit është më e lartë në Shqipëri
- B) Aktivitetet financiare shqiptare janë më të varfra në investime
- C) Leku pritët të zhvlersohet kundrejt euros
- D) Leku pritët të vlersohet kundrejt euros

Pyetja 33

Cili nga faktorët e mëposhtëm do të shkaktonte një zhvlersim të lekut ndaj euros?

- A) Një rritje në ofertën e monedhës italiane
- B) Rritja e normave të interesit në Itali
- C) Ulja e normave të interesit në Shqipëri
- D) Rritja e importeve italiane të blera nga Shqipëria

Pyetja 34

Kursi fleksibël i këmbimit do të:

- A) Izolonte plotësisht ekonominë nga forcat e jashtme
- B) Izolonte pjesërisht ekonominë nga forcat e jashtme
- C) Krijonte varësi monetare
- D) Çonte drejt paritetit të fuqisë blerëse

Pyetja 35

Për të ulur normat e interesit shteti do të:

- A) Adaptonte një kurs këmbimi fleksibël
- B) Adaptonte një kurs këmbimi fiks
- C) Ngadalësonte normën e rritjes së ofertës së monedhës
- D) Krijojë një zhvlersim të kursit të këmbimit

Pyetja 36

Nëqoftëse BQ dëshiron të rrisë ofertën monetare atëherë ajo duhet :

- A) Të rrisë normën e rezervës së detyrueshme.
- B) Të shesë letra me vlerë
- C) të rrisë normën diskaunt për huatë që i jep bankave të nivelit të dytë

D) Të ulë normën e rezervës së detyrueshme

Pyetja 37

Cila nga normat e rezervës së detyrueshme të mëposhtëme do t'i lejojë bankës një sasi më të madhe të fondeve të dhëna hua?

- A) 10%
- B) 15%
- C) 20%
- D) 25%

Pyetja 38

Nëqoftëse Banka Qendrore dëshiron të ulë ofertën monetare atëhere ajo duhet :

- A) Të ulë normën e rezervës së detyrueshme.
- B) Të blejë letra me vlerë
- C) Të ulë normën diskaunt për huatë që i jep bankave të nivelit të dytë
- D) Të rrisë normën e rezervës së detyrueshme

Pyetja 39

Cilat nga alternativat e mëposhtme përshkruan efektet e një politike monetare e cila do të çojë në një rritje ekonomike:

- A) Një ulje në ofertën monetare do të ulë normën e interesit, si pasojë rriten shpenzimet për investime dhe si rrjedhim ulen edhe PBB reale
- B) Një rritje në ofertën monetare do të rrisë normën e interesit, si pasojë ulen shpenzimet për investime dhe si rrjedhim ulen edhe PBB reale
- C) Një rritje në ofertën monetare do të ulë normën e interesit, si pasojë rriten shpenzimet për investime dhe si rrjedhim rriten edhe PBB reale.
- D) Një rritje në kërkesën për para

Pyetja 40

Tregoni se në secilin nga rastet e mëposhtëme oferta monetare rritet :

- A) Banka Qendrore blen 10 milionë lekë bono thesari
- B) Banka Qendrore rrit normën e rezervës së detyrueshme nga 10 % në 15%.
- C) Banka Qendrore shet 20 milionë letra me vlerë.
- D) Banka Qendrore rrit normën e interesit me zbritje nga 6% në 5%.

Pyetja 41

Qëllimi kryesor i Bankës së Shqipërisë është:

- A) maksimizimi i fitimit në veprimtarinë e saj
- B) mbulimi i deficitit të buxhetit të qeverisë
- C) stabilizimi i çmimeve
- D) punëzënia e plotë

Pyetja 42

Nëse qeveria rrit shpenzimet dhe rrit taksat vetëm sa për të financuar këtë rritje, ajo do të:

- A) Mbajë prodhimin e pandryshuar
- B) Rrisë prodhimin
- C) Zvogëlojë prodhimin
- D) Rrisë MPC

Pyetja 43

Të gjitha sa vijon janë instrumenta të politikës monetare përveç

- A) Një objektiv nominal i stokut të parasë
- B) Një buxhet të balancuar
- C) Një objektiv inflacioni
- D) Ndjekja e një norme reale interesi të shënjestruar

Pyetja 44

Politika fiskale ekspansioniste në modelin klasik do të shkaktojë kërkesën agregate të _____ prodhimin potencial

- A) Tejkalojë
- B) Bjerë më poshtë
- C) Luhatet rreth
- D) Mbetet e barabarta me

Pyetja 45

Monetaristët besojnë se një reduktim në _____ mund të arrihet duke reduktuar _____

- A) Papunësi, çmimet
- B) Inflacion, pagat
- C) Papunësi, pagat
- D) Inflacion, sasinë e parasë nominale

Pyetja 46

Politika fiskale paraqet:

- A) Përpjekjet e shtetit për të rregulluar çmimet
- B) Përdorimin nga shteti të politikave të taksave dhe të shpenzimeve për të kontrolluar ofertën monetare
- C) Përdorimin nga shteti të politikave të taksave dhe të shpenzimeve për të arritur nivelin e dëshiruar të të ardhurave kombëtare
- D) Përpjekjet shtetërore për të rregulluar ndotjen e ambientit

Pyetja 47

Përdorimi i shpenzimeve shtetërore dhe i taksave për të manipuluar ekonominë njihet si:

- A) Politikë stabilizuese

- B) Politikë fiskale
- C) Shpenzime shtetërore
- D) Balancim i buxhetit

Pyetja 48

Në qoftë se ekziston një hendek inflacionist, një politikë fiskale e përshtatshme do të lidhej me :

- A) Rritjen e taksave
- B) Rritjen e shpenzimeve shtetërore për mallra dhe shërbime
- C) Uljen e taksave
- D) Rritjen e pagesave të transferueshme

Pyetja 49

Në qoftë se të ardhurat e shtetit nga taksa mbi të ardhurat personale, rriten me 5 milionë lekë dhe blerjet e mallrave dhe të shërbimeve rriten me të njëjtën sasi, efekti më i mundshëm është:

- A) Ulja neto e të ardhurave kombëtare
- B) Ngritja neto e të ardhurave kombëtare
- C) Nuk ka efekt mbi të ardhurat kombëtare
- D) Rritet vlera e multiplikatorit të buxhetit të balancuar

Pyetja 50

Bilanci i buxhetit është diferenca midis:

- A) Shpenzimeve të konsumatorit dhe të ardhurave të disponueshme
- B) Shpenzimeve shtetërore dhe të ardhurave shtetërore
- C) Shpenzimeve shtetërore dhe të ardhurave kombëtare
- D) Shpenzimeve agregate dhe të ardhurave kombëtare

Pyetja 51

Deficiti buxhetor krijohet si pasojë e rritjes së shpenzimeve shtetërore. Kjo mund të korrigjohet duke:

- A) Ulur taksat
- B) Rritur normat e interesit
- C) Rritur shpenzimet ushtarake
- D) Ulur pagesat e transferueshme

Pyetja 52

Në qoftë se shteti ndjek një politikë shpenzimesh anticiklike:

- A) Buxheti do të tentojë të jetë i balancuar nga njëri vit në tjetrin
- B) Kërkesa agregate do të tentojë të jetë konstante nga një vit tek tjetri
- C) Raporti i shpenzimeve shtetërore ndaj PBB do të jetë i pandryshueshëm
- D) Të ardhurat kombëtare pjesëtuar me shpenzimet shtetërore nuk ndryshojnë

Pyetja 53

Multiplikatori i buxhetit të balancuar llogaritet si raporti i ndryshimit në:

- A) Të ardhurat kombëtare pjesëtuar me ndryshimin në shpenzimet agregate
- B) Të ardhurat kombëtare pjesëtuar me ndryshimin në shpenzimet shtetërore
- C) Të ardhurat e taksave pjesëtuar me ndryshimin në shpenzimet shtetërore
- D) Shpenzimet shtetërore pjesëtuar me ndryshimet në të ardhurat shtetërore

Pyetja 54

Supozojmë se një person depoziton 600 mijë lekë në bankën XYZ. Pak më vonë po në të njëjtën ditë një tjetër person hyn në bisedime për të marrë po nga e njëjta bankë një hua prej 1. 200 000 lekësh. Në çfarë drejtimi dhe në çfarë sasive oferta monetare do të ndryshojë ?:

- A) rritet me 1 200 000 lekë
- B) rritet me 600 mijë lekë
- C) rritet me 1.800 000 lekë
- D) ulet me 600 mijë lekë

Pyetja 55

Cila nga alternativat e mëposhtme përbën një nga funksionet e parasë:

- A) Nuk ruan vlerën
- B) Mjet këmbimi
- C) Kosto transporti të ulëta
- D) Likuiditet I lartë.

Pyetja 56

Cilat nga format e mëposhtme të mbajtjes së parasë përfshihen tek agregati monetar M3:

- A) Depozitat e kursimit afatgjatë
- B) Çeqet e udhëtarëve
- C) Llogaritë e fondeve të përbashkëta
- D) Depozitat pa afat

Pyetja 57

Nëse kemi kursyer disa para, mënyra më mirë për ti ruajtur dhe përfituar prej tyre është:

- A) Një llogari e thjeshtë kursimi me normë interesi në masën 2%
- B) Bono thesari me afat maturimi tre mujor me normë interesi 6%
- C) Depozita kursimi afatgjata me normë interesi 4%
- D) Obligacione të korporatës me normë interesi 8%.

Pyetja 58

Cili nga funksionet e mëposhtëm të parasë i bën dy mallra të ndryshëm në njësi fizike, të krahasueshëm me njëri- tjetrin:

- A) Paraja si mjet këmbimi

- B) Paraja si matëse e vlerës
- C) Paraja si ruajtëse e vlerës
- D) Paraj e mbajtur në formën e depositës bankare

Pyetja 59

Cila nga normat e rezervës së detyrueshme të mëposhtëme do t'i lejojë bankës një sasi më të vogël të fondeve të dhëna hua?

- A) 10%
- B) 15%
- C) 20%
- D) 25%

Pyetja 60

Funksioni kryesor i një banke qendrore është:

- A) Kontrolli i ofertës së parasë
- B) Siguron kartëmonedha dhe monedha për tregti
- C) Gjeneron fitim
- D) Siguron një sistem pastrimi të parave

Pyetja 61

Funksioni kryesor i një banke të nivelit të dytë:

- A) Kontrolli i ofertës së parasë
- B) Emetimi i kartëmonedhave dhe monedhave të reja
- C) Ndërhyrja në normat e interesit
- D) Ndërmjetës financiar

Pyetja 62

Bankat krijojnë para nëpërmjet:

- A) Printimin të parasë
- B) Lëshimit të kartave të debitit
- C) Pranimi të çeqeve
- D) Dhënies hua të një pjese të depozitave të tyre

Pyetja 63

Oferta e parasë është _____

- A) Departamenti i Politikës Monetare në Bankën Qendrore
- B) Para + karta debiti + karta krediti
- C) Çeqe + para + karta debiti + karta krediti
- D) Monedha në qarkullim plus depozitat bankare

Pyetja 64

Nëse bankat dhe sektori privat vendosin të mbajnë më pak para, multiplikatori i parasë do të jetë:

- A) I pandryshuar
- B) Më i madh
- C) Më i vogël
- D) I paqëndrueshëm

Pyetja 65

Tre variabla ndikojnë në kërkesën për para; ata janë _____, _____ dhe _____

- A) Orari i punës së bankës, përqindja e punonjësve me pagesë javore, normat e interesit
- B) Niveli i çmimeve, normat e interesit, të ardhurat reale
- C) Periudha e vitit, orët e hapjes së bankës, niveli i çmimeve
- D) Përqindja e punonjësve me pagesë javore, koha e vitit, të ardhurat reale

Pyetja 66

Nëse mbaj disa para në dispozicion për ti përdorur në treg, ky është një shembull i :

- A) Kërkesës për para asetesh
- B) Kërkesës së para transaksioni
- C) Kërkesës totale për para
- D) Ofertës për para

Pyetja 67

Kur norma e interesit rritet, kushtet e tjera nuk ndryshojnë, presim që sasia e mbajtjes së parasë reale të:

- A) Bjerë
- B) Rritet
- C) Nuk ndryshon
- D) Në fillim të bjer dhe pastaj të rritet

Pyetja 68

Kur të ardhurat reale rriten, kushtet e tjera të pandryshuara, mund të presim që kërkesa për para reale të:

- A) Bjerë
- B) Mos ndryshojë
- C) Rritet
- D) Të bjerë e pastaj të rritet

Pyetja 69

Baza monetare (M1) është _____ dhe _____

- A) Depozitat bankare, depozitat në monedhë të huaj
- B) Monedha në qarkullim, rezervat e parave të bankave

- C) Depozitat pa afat, depozitat në monedhë të huaj
- D) Depozitat në monedhë vendase, depozitat me afat

Pyetja 70

Nëse banka qendrore blen letra me vlerë në tregun e hapur për të rritur bazën monetare, ky është një shembull i:

- A) Huadhënies së mundësisë së fundit
- B) Ndërmjetësimit financiar
- C) Operacioneve në tregun e hapur
- D) Rregullimit financiar

Pyetja 71

Ekulibri në tregun e parasë do të ndryshojë nëse ka

- A) Një ndryshim në ofertën reale të parasë
- B) Një ndryshim në të ardhurat e konsumatorëve
- C) Ndryshim në numrin e bankave në treg
- D) Ndryshim në bilancin tregëtar

Pyetja 72

Bankat qendrore preferojnë të fiksojnë _____ dhe të pranojnë rezultatin në _____

- A) Kërkesën për para, normat e interesit
- B) Normat e interesit, ofertën e parasë
- C) Kërkesa për para, ofertën monetare
- D) Normat e interesit, kërkesën për para

Pyetja 73

Një nga mekanizmat e transmisionit të politikës monetare është nëpërmjet kërkesës konsumatore.

Kur normat e interesit _____ pasuria e familjes _____ dhe konsumi _____

- A) Rriten, rritet, rritet
- B) Rriten, bie, rritet
- C) Rriten, rritet, bie
- D) Rritet, bie, bie

Pyetja 74

Një ulje e normave të interesit shkakton një rritje të bazës monetare që rezulton në një _____ të kredisë konsumatore dhe një _____ në koston e kredisë konsumatore.

- A) Reduktim, rritje
- B) Reduktim, reduktim
- C) Rritje, reduktim
- D) Rritje, Rritje

Pyetja 75

Një rënie e kërkesës për investime mund të rezultojë nga

- A) Norma më të larta interesi
- B) Fitime më të larta të pritshme në të ardhmen
- C) Mallra kapitale më të lira
- D) Rritja e shpenzimeve qeveritare

Pyetja 76

Paraja ka 3 funksione kryesore, ato janë, _____, _____ dhe _____

- A) Ruajtëse vlere, mbrojtje nga inflacioni, matëse vlere
- B) Mjet këmbimi, mbrojtje nga inflacionit, ruajtëse e vlerës
- C) Mjet i këmbimit, matëse vlere, mjet likuiditeti
- D) Mjet i këmbimit, matëse e vlerës, ruajtëse e vlerës

Pyetja 77

Teoria sasiore e parasë thotë se ndryshimet në _____ çojnë në ndryshime ekuivalente në _____, por nuk kanë efekt në _____

- A) Çmime, paga, prodhim dhe punësim
- B) Prodhim, çmime, punësim
- C) Para nominale, nivelin e çmimeve, prodhim dhe punësim
- D) Para nominale, prodhim, çmime

Pyetja 78

Një rritje e normave të interesit shkakton një ulje të bazës monetare që rezulton në një _____ të kredisë konsumatore dhe një _____ në koston e kredisë konsumatore.

- A) Reduktim, rritje
- B) Reduktim, reduktim
- C) Rritje, reduktim
- D) Rritje, Rritje

Pyetja 79

Nëse banka qendrore shet letra me vlerë në tregun e hapur për të ulur bazën monetare, ky është një shembull i:

- A) Huadhënies së mundësisë së fundit
- B) Ndërmjetësimit financiar
- C) Operacioneve në tregun e hapur
- D) Rregullimit financiar

Pyetja 80

Kur norma e interesit ulen, kushtet e tjera nuk ndryshojnë, presim që sasia e mbajtjes së parasë reale të:

- A) Bjerë
- B) Rritet
- C) Nuk ndryshon
- D) Në fillim të bjer dhe pastaj të rritet

Pyetja 81

Cila nga normat e rezervës së detyrueshme të mëposhtëme do t'i lejojë bankës një sasi më të madhe të fondeve të dhëna hua?

- A) 10%
- B) 15%
- C) 20%
- D) 25%

Kapitulli 7. Kuptimi i menaxhimit. Misioni dhe vizioni i kompanisë. Studimi i mjedisit, analiza konkurruese

Pyetja 1

Cila ishte kuptimi fillestar i termit "menaxhim" në Europë deri në fund të viteve '50?

- A) Kryerja e punëve rutinore në sektorin publik
- B) Administrimi dhe shfrytëzimi i kapitalit në ndërmarrje private
- C) Sistemet dhe procedurat për arritjen e objektivave në organizata
- D) Drejtimi i përditshëm i ndërmarrjeve

Pyetja 2

Cili është ndryshimi kryesor në kuptimin e menaxhimit pas viteve '50 në Europë?

- A) Furnizimi i kapitalit për ndërmarrjet
- B) Themelimi i sistemeve të mënyrave të reja të menaxhimit
- C) Fokusimi në administrim në vend të menaxhimit
- D) Perceptimi i menaxhimit si aktivitet kompleks dhe krijues

Pyetja 3

Cila është një karakteristikë e organizatave të suksesshme në ditët tona?

- A) Përdorimi i një kulture autokratike
- B) Përqendrimi vetëm në maksimizimin e fitimit
- C) Menaxhim me cilesi të plote
- D) Rritja e sasisë duke abuzuar me cilësinë

Pyetja 4

Përse është vlerësuar si mjeshtëri mësimi i menaxhimit dhe jo si talent i lindur?

- A) Sepse menaxhimi është një proces shkencor me parime themelore
- B) Sepse talenti i lindur nuk ka rëndësi në menaxhim
- C) Sepse disa aftësi dhe cilësi për menaxhim duhen të zhvillohen me trajnim dhe përvojë të vazhdueshme
- D) Sepse mjeshtëria në menaxhim është e pashmangshme në vazhdimësi

Pyetja 5

Cili nga faktorët e mëposhtëm ka ndikimin më të madh në përcaktimin e rezultateve të menaxherit?

- A) Kushtet e punës
- B) Përgjegjësia dhe pjekuria
- C) Numri i punonjësve
- D) Sistemet kompjuterike

Pyetja 6

Sipas Mintzbergut, roli i menaxherit është i rëndësishëm për:

- A) Implementimin e sistemeve të reja kompjuterike
- B) Përcaktimin nëse institucionet shërbejnë apo harxhojnë burimet
- C) Krijimin e marketingut
- D) Menaxhimin e ngjarjeve shoqërore

Pyetja 7

Cilat janë tri llojet e burimeve që një ndërmarrje duhet të zotërojë?

- A) Burimet teknike, logjistike dhe njerëzore
- B) Burimet administrative, financiare dhe teknologjike
- C) Burimet njerëzore, informatike dhe logjistike
- D) Burimet fizike, financiare dhe njerëzore

Pyetja 8

Sipas Fayol-it, cilat janë katër funksionet bazë të menaxhimit?

- A) Planifikim, organizim, udhëheqje dhe kontroll
- B) Koordinim, analizë, udhëheqje dhe mbikëqyrje
- C) Planifikim, analizë, menaxhim dhe kontroll
- D) Organizim, udhëheqje, menaxhim dhe planifikim

Pyetja 9

Çfarë nënkupton termi "menaxhim" në përkufizimin e dhënë nga H. Fayol?

- A) Menaxhimi i burimeve njerëzore
- B) Kryerja e detyrave administrative
- C) Parashikimi, planifikimi, organizimi, komandimi, koordinimi dhe kontrolli
- D) Implementimi i sistemeve teknologjike

Pyetja 10

Cilat aftësi janë më të rëndësishme për menaxherët e nivelit të ulët?

- A) Aftësitë teknike
- B) Aftësitë konceptuale
- C) Aftësitë ndërpersonale
- D) Aftësitë diagnostikuese

Pyetja 11

Cili rol i menaxherit lidhet me përfaqësimin e organizatës përpara grupeve të ndryshme jashtë saj?

- A) Lider
- B) Shpërndarës informacionesh
- C) Zëdhënës
- D) Monitorues

Pyetja 12

Menaxherët e nivelit të mesëm janë përgjegjës për:

- A) Hartimin e politikave të përgjithshme të kompanisë
- B) Realizimin e operacioneve të brendshme dhe planeve të detajuara
- C) Menaxhimin e burimeve njerëzore
- D) Kontrollin e proceseve teknike

Pyetja 13

Cili nga funksionet e menaxhimit përfshin ndikimin te njerëzit për të realizuar objektivat specifike?

- A) Planifikimi
- B) Organizimi
- C) Udhëheqja
- D) Kontrolli

Pyetja 14

Sipas Mintzbergut, cilat janë tri grupet e roleve menaxheriale?

- A) Rolet administrative, operacionale dhe strategjike
- B) Rolet ndërpersonale, informuese dhe vendimore
- C) Rolet teknike, konceptuale dhe ndërpersonale
- D) Rolet diagnostikuese, planifikuese dhe udhëheqëse

Pyetja 15

Cila është përgjegjësia kryesore e menaxherëve të nivelit të lartë?

- A) Menaxhimi i punëtorëve
- B) Hartimi i planeve afatgjata dhe marrja e vendimeve strategjike
- C) Zbatimi i procedurave të detajuara
- D) Trajnimi i stafit

Pyetja 16

Cilët menaxherë përfshihen në nivelin e lartë të menaxhimit?

- A) Mbikëqyrësit e punëtorëve
- B) Menaxherët e operacioneve
- C) Menaxherët e zyrave
- D) Drejtorët ekzekutivë dhe menaxherët kryesorë

Pyetja 17

Cila është përgjegjësia kryesore e menaxherëve të nivelit të mesëm?

- A) Zbatimi i politikave të përgjithshme të kompanisë
- B) Hartimi i planeve strategjike afatgjata
- C) Menaxhimi i direkt punëtorëve
- D) Mbajtja e inventarit

Pyetja 18

Ku qëndrojnë menaxherët e nivelit të mesëm në hierarkinë menaxheriale?

- A) Në nivelin e vendimmarrjes strategjike
- B) Midis menaxherëve kryesorë dhe menaxherëve mbikëqyrës
- C) Në nivelin mbikëqyrës
- D) Në kontakt të drejtpërdrejtë me klientët

Pyetja 19

Cili është roli kryesor i menaxherëve të nivelit të ulët?

- A) Hartimi i politikave të përgjithshme të kompanisë
- B) Mbikëqyrja e punëtorëve dhe operacioneve bazë
- C) Marrja e vendimeve strategjike
- D) Hartimi i planeve afatgjata

Pyetja 20

Pse konsiderohet puna e menaxherëve mbikëqyrës si më e vështirë?

- A) Sepse ata nuk kanë asnjë autoritet
- B) Sepse janë nën presion të dyfishtë nga menaxherët eprorë dhe punëtorët
- C) Sepse ata nuk kanë njohuri teknike
- D) Sepse janë përgjegjës vetëm për kontrollin e cilësisë

Pyetja 21

Cili është funksioni bazë i menaxhimit që ndikon te të gjitha funksionet e tjera?

- A) Kontrolli
- B) Organizimi
- C) Planifikimi
- D) Udhëheqja

Pyetja 22

Çfarë përfshin funksioni i organizimit?

- A) Përcaktimin e objektivave specifike
- B) Zbatimin e vendimeve të marra
- C) Ndarjen e detyrave dhe përcaktimin e përgjegjësive
- D) Kontrollimin e rezultateve

Pyetja 23

Cilat nivele të menaxhimit përfshihen më shumë në procesin e udhëheqjes?

- A) Vetëm niveli i lartë
- B) Vetëm niveli i mesëm
- C) Niveli i mesëm dhe mbikëqyrës
- D) Vetëm niveli i ulët

Pyetja 24

Çfarë përfshin funksioni i kontrollit?

- A) Hartimin e strategjive afatgjata
- B) Krahasimin e performancës me objektivat dhe ndërmarrjen e veprimeve korigjuese
- C) Planifikimin e operacioneve të përditshme
- D) Motivimin e punëtorëve

Pyetja 25

Cili është një nga rolet ndërpersonale të menaxherit?

- A) Monitorues
- B) Sipërmarrës
- C) Negociator
- D) Ndërlidhës

Pyetja 26

Çfarë bën një menaxher në rolin e shpërndarësit të informacioneve?

- A) Mbledh informacion nga burime të jashtme
- B) Përfaqëson organizatën përpara grupeve të ndryshme
- C) Shpërndan informacionin e mbledhur te individët apo njësitë përkatëse
- D) Ndërmerr ide të reja

Pyetja 27

Cili është një nga rolet vendimore të menaxherit?

- A) Figurë qendrore
- B) Trajtues i konflikteve
- C) Monitorues
- D) Zëdhënës

Pyetja 28

Cili nga konceptet më poshtë i referohet marrëdhënies midis sasisë dhe cilësisë së produkteve të prodhuara dhe sasisë së burimeve të përdorura për realizimin e tyre?

- A) Efektiviteti
- B) Eficienca
- C) Produktiviteti
- D) Performanca

Pyetja 29

Cili koncept nënkupton arritjen e rezultateve cilësisht të larta me përdorim minimal të burimeve?

- A) Produktiviteti
- B) Efienca
- C) Efektiviteti
- D) Rentabiliteti

Pyetja 30

Cili nga konceptet lidhet me aftësinë për të zgjedhur objektivat e përshtatshme dhe mjetet e duhura për arritjen e tyre?

- A) Produktiviteti
- B) Efienca
- C) Efektiviteti
- D) Rentabiliteti

Pyetja 31

Nëse një firmë arrin objektivin e saj të shitjeve prej 2 500 000 lekësh kur objektivi ishte 2 000 000 lekë, kjo firmë është:

- A) Eficiente
- B) Produktive
- C) Efektive
- D) Rentabile

Pyetja 32

Cila nga këto do të ishte një masë e eficiencës së një kompanie në marketing?

- A) Të ardhurat nga shitjet / Shpenzimet për marketing
- B) Të ardhurat nga shitjet / Numri i punonjësve
- C) Shpenzimet për marketing / Fitimi neto
- D) Të ardhurat nga shitjet / Numri i klientëve

Pyetja 33

Cili nga konceptet i referohet "bërjes së gjërave siç duhet"?

- A) Produktiviteti
- B) Efienca
- C) Efektiviteti
- D) Rentabiliteti

Pyetja 34

Nëse një kompani prodhon një produkt në mënyrë shumë eficiente, por ky produkt ka kërkesë të ulët në treg, atëherë prodhimi i këtij produkti është:

- A) Efektiv dhe eficient
- B) Efektiv por jo eficient
- C) Eficient por jo efektiv
- D) As eficient dhe as efektiv

Pyetja 35

Cili nga konceptet mat raportin midis outputeve dhe inputeve?

- A) Produktiviteti
- B) Eficienca
- C) Efektiviteti
- D) Performanca

Pyetja 36

Menaxherët më të mirë sot janë:

- A) Ndihmues dhe mbështetës
- B) Të drejtpërdrejtë dhe urdhër-dhënës
- C) Pasiv dhe tërheqës
- D) Autoritarë dhe të rreptë

Pyetja 37

Në një organizatë moderne, cilat janë disa nga sfidat kryesore me të cilat përballen menaxherët?

- A) Konkurrenca e ashpër dhe qëndrimi kritik i opinionit publik
- B) Qëndrimi pasiv ndaj teknologjisë
- C) Mos marrja në konsideratë e burimeve njerëzore
- D) Planifikimi i qetë dhe pa ndryshime

Pyetja 38

Çfarë është avantazhi konkurrues?

- A) Aftësia për të prodhuar më shumë produkte
- B) Aftësia për të bërë ose vepruar më mirë se organizatat e tjera
- C) Aftësia për të ulur çmimet e produkteve
- D) Aftësia për të mbajtur të njëjtat metoda pune

Pyetja 39

Cili nga elementët e mëposhtëm është një nga blloqet që ndërtojnë avantazhin konkurrues?

- A) Autoritarizmi
- B) Hierarkia
- C) Efikasiteti
- D) Centralizimi

Pyetja 40

Cila është një mënyrë për të përmirësuar produktivitetin në organizatat moderne?

- A) Trajnimi ndërdisiplinor i punonjësve
- B) Rritja e numrit të punonjësve
- C) Centralizimi i vendimmarrjes
- D) Mbajtja e metodave tradicionale të punës

Pyetja 41

Si përmirësojnë organizatat efikasitetin e tyre?

- A) Duke rritur numrin e menaxherëve në hierarki
- B) Duke zvogëluar përdorimin e teknologjisë së avancuar
- C) Duke përdorur më mirë burimet njerëzore
- D) Duke kufizuar trajnimet për punonjësit

Pyetja 42

Cili është një element kyç i përmirësimit të cilësisë në organizata?

- A) Redukimi i trajnimeve të punonjësve
- B) Investimi në menaxhimin e cilësisë totale
- C) Përdorimi i një qasjeje autokratike në vendim-marrje
- D) Ndalimi i grupeve të kontrollit të cilësisë

Pyetja 43

Procesi i inovacionit në organizata përshkruhet si:?

- A) Si një proces që ndodh vetvetiu
- B) Si një proces i drejtuar nga menaxherët e lartë
- C) Si një proces që kërkon një kulturë të inkurajimit
- D) Si një proces i përgjegjshëm për rritjen e shpenzimeve

Pyetja 44

Cili faktor është i rëndësishëm për suksesin e organizatave në një ambient global konkurrues?

- A) Përqendrimi vetëm në rritjen e fitimeve
- B) Përdorimi i vetëm burimeve teknologjike
- C) Përmirësimi i cilësisë dhe efikasitetit
- D) Ndalimi i investimeve në zhvillim global

Pyetja 45

Cili është një kriter kyç për të përcaktuar avantazhin konkurrues të një organizate?

- A) Përdorimi i plotë i automatizmit
- B) Sfidimi i teknologjive të reja
- C) Aftësia për të bërë më mirë se konkurrentët
- D) Përshpejtimi i rregullimeve ligjore

Pyetja 46

Si përshkruhet roli i fleksibilitetit në konkurrencën globale?

- A) Si një kufizim për rritjen e organizatave
- B) Si një avantazh në përputhje me rregullimin e teknologjive të reja
- C) Si një kërkesë për përdorimin vetëm të burimeve teknologjike
- D) Si një aftësi për tu përshtatur shpejt ndaj ndryshimeve

Pyetja 47

Cila është një nga sfidat për menaxherët në ditët tona?

- A) Përmirësimi i shërbimit ndaj klientëve
- B) Redukimi i përdorimit të teknologjive të avancuara
- C) Përdorimi i menaxhimit hierarkik tradicional
- D) Përshtatshmëria ndaj rritjes së fitimeve

Pyetja 48

Cila është një sfidë e përbashkët për organizatat në një ambient global konkurrues?

- A) Zvogëlimi i përdorimit të menaxhimit të cilësisë totale
- B) Përdorimi i vetëm i burimeve teknologjike
- C) Ndalimi i investimeve në trajnimin e punonjësve
- D) Ndryshimi i preferencave të klientit dhe zhvillimi i teknologjive të reja

Pyetja 49

Çfarë përfshin vizioni i një organizate?

- A) Qëllimet financiare dhe strategjitë e organizatës
- B) Një përshkrim të destinacionit ku synon të shkojë organizata
- C) Detajet teknike të produkteve
- D) Një plan të hollësishëm veprimi

Pyetja 50

Pse është i rëndësishëm vizioni për anëtarët e një organizate?

- A) Për të krijuar raporte financiare të sakta
- B) Për të shmangur konfliktet e brendshme
- C) Për t'i fokusuar dhe frymëzuar ata
- D) Për të rritur konkurrencën me kompanitë e tjera

Pyetja 51

Cilët janë tre komponentët e rëndësishëm të një vizioni?

- A) Tregjet, produktet, dhe klientët
- B) Misioni, pikësynimet dhe filozofia e kompanisë
- C) Burimet, marketingu dhe shpërndarja
- D) Teknologjia, financat dhe inovacioni

Pyetja 52

Çfarë përfshin filozofia e një organizate?

- A) Aspektin financiar bazuar tek fitimi
- B) Vlerat, besimet dhe udhëzimet për zhvillimin e biznesit
- C) Strategjitë e marketingut
- D) Struktura organizative

Pyetja 53

Cila nga këto besime është pjesë e filozofisë së kompanive të suksesshme?

- A) Besimi në rëndësinë e komunikimit brenda organizatës
- B) Fokusimi vetëm në fitime afatshkurtra
- C) Neglizhimi i nevojave të punonjësve
- D) Reduktimi i investimeve në kërkim-zhvillim

Pyetja 54

Çfarë specifikon misioni i organizatës?

- A) Tregjet ndërkombëtare të synuara
- B) Detajet teknike të produkteve
- C) Planin e veprimit afatgjatë
- D) Arsyeën përse ekziston organizata

Pyetja 55

Cila është një nga pyetjet kryesore që duhet t'i përgjigjet misioni i organizatës?

- A) Si do të financohet organizata?
- B) Çfarë teknologjie do të përdorë organizata?
- C) Cilat janë strategjitë marketingu?
- D) Për kë do t'i kryejë funksionet organizata?

Pyetja 56

Cili është një ndër qëllimet kryesore të një organizate?

- A) Shmangia e ndryshimeve
- B) Kufizimi i rritjes së tregut
- C) Maksimizimi i të ardhurave të aksionerëve
- D) Reduktimi i numrit të punonjësve

Pyetja 57

Cilët janë pretendentët e jashtëm të një organizate?

- A) Aksionarët dhe punonjësit
- B) Konsumatorët, furnitorët, qeveritë dhe publiku
- C) Zyrtarët ekzekutivë dhe anëtarët e bordit
- D) Menaxherët dhe drejtuesit e departamenteve

Pyetja 58

Si ndihmon misioni në shmangien e konflikteve në organizatë?

- A) Duke rritur fitimet e kompanisë
- B) Duke reduktuar numrin e aksionerëve
- C) Duke ulur shpenzimet operative
- D) Duke siguruar ecjen e kompanisë në përputhje me drejtimin e përgjithshëm

Pyetja 59

Cilat janë nivelet e përgjegjësisë sociale të një organizate?

- A) Ekonomik, ligjor, etik
- B) Ekonomik, ligjor, profesional
- C) Ligjor, personal, profesional
- D) Etik, ligjor, personal

Pyetja 60

Çfarë përfshin përgjegjësia etike e një organizate?

- A) Të krijojë fitime për aksionerët
- B) Të ndjekë të gjitha rregullat ligjore
- C) Të përcaktojë dhe veprojë sipas asaj që është e drejtë
- D) Të investojë në teknologji të reja

Pyetja 61

Cila është rëndësia e sjelljes etike në biznes?

- A) Shërben si model
- B) Parandalon konkurrencën
- C) Siguron rritje të shpejtë të fitimit
- D) Redukton taksat

Pyetja 62

Çfarë nënkupton parimi "Bindjuni ligjit"?

- A) Respekt për bashkëpunëtorët
- B) Singëritet në marrëdhëniet e biznesit
- C) Kryerja e aktiviteteve brenda kufijve ligjorë
- D) Investimi në aktivitete bamirëse

Pyetja 63

Çfarë përfshin respekti në etikën e biznesit?

- A) Respekt për konkurrencën dhe konsumatorët
- B) Respekt për konsumatorët, bashkëpunëtorët dhe mjedisin
- C) Respekt për mjedisin
- D) Respekt për teknologjinë

Pyetja 64

Cila është përgjegjësia e sipërmarrësve ndaj bashkëpunëtorëve?

- A) Të maksimizojnë fitimet
- B) Të ofrojnë produkte dhe shërbime me cilësi
- C) Të investojnë në marketing

D) Të ndjekin trajnime të vazhdueshme

Pyetja 65

Pse është e rëndësishme të përmbushen rezultatet në mënyrë të ligjshme dhe etike?

- A) Për të rritur fitimet e përgjithshme dhe fitimet e aksionerëve
- B) Për të mbajtur konkurrencën larg dhe për të qenë të mbrojtur
- C) Për të mbajtur besimin dhe respektin e të gjithë aktorëve të interesuar
- D) Për të ulur kostot operacionale

Pyetja 66

Çfarë përfshin menaxhimi strategjik për të rritur shanset e suksesit të biznesit?

- A) Zgjedhjen e teknologjisë më të fundit
- B) Krijimin e një strategjie të qartë dhe të strukturuar
- C) Investimin intensiv në marketing
- D) Punësimin e një menaxheri të lartë

Pyetja 67

Pse është e rëndësishme që menaxhimi strategjik të jetë i integruar në organizatë?

- A) Për të ulur koston
- B) Për të reduktuar konkurrencën
- C) Për të siguruar qëllimet dhe misionin e organizatës
- D) Për të minimizuar taksat

Pyetja 68

Cila është një nga përparësitë e sjelljes së përgjegjshme sociale për kompanitë?

- A) Zvogëlon rentabilitetin
- B) Përmirëson reputacionin
- C) Rrit varfërinë
- D) Izolon kompanitë nga shoqëria

Pyetja 69

Cila është një nga përfitimet e një reputacioni të mirë të kompanisë?

- A) Zvogëlon aftësinë për të përdorur burime
- B) Redukton rritjen e biznesit
- C) Përmirëson rentabilitetin

D) Zvogëlon interesin e aksionerëve

Pyetja 70

Çfarë i ndihmon kompanitë të përfitojnë ekonomikisht nga rritja e biznesit?

- A) Zvogëlimi i fitimeve
- B) Sjellja me përgjegjësi sociale
- C) Reduktimi i shpenzimeve
- D) Izolimi nga shoqëria

Pyetja 71

Si ndikon sjellja e kompanive ndaj punonjësve në normat dhe vlerat e shoqërisë?

- A) I zvogëlon normat dhe vlerat
- B) I promovon normat dhe vlerat
- C) I izolon normat dhe vlerat
- D) I ndryshon normat dhe vlerat

Pyetja 72

Cili është një efekt i sjelljes së kompanive me përgjegjësi sociale në nivel shoqëror?

- A) Rritja e papunësisë
- B) Zvogëlimi i normave të arsimimit
- C) Promovimi i harmonisë sociale
- D) Rritja e kriminalitetit

Pyetja 73

Cila është një arsye pse kompanitë duhet të marrin përgjegjësinë për promovimin e interesave të punonjësve?

- A) Për të rritur shpenzimet
- B) Për të zvogëluar cilësinë e produkteve
- C) Për të izoluar burimet njerëzore
- D) Për të promovuar një klimë të kujdesit në shoqëri

Pyetja 74

Çfarë duhet të bëjë një firmë për të siguruar burimet e nevojshme për zbatimin e strategjive konkurruese?

- A) Të fokusohet vetëm në zhvillimin e produktit

- B) Të ulë çmimet e produkteve
- C) Të zvogëlojë investimet në kërkime dhe zhvillim
- D) Të bashkëpunojë me furnitorët dhe kreditorët

Pyetja 75

Cili është rregulli që shpërndan përfitimet dhe dëmet në mesin e njerëzve dhe grupeve në mënyrë të drejtë?

- A) Utilitar
- B) Moral
- C) Drejtësi
- D) Praktik

Pyetja 76

Në bazë të cilës rregulli menaxherët duhet të zgjedhin kursin e veprimit që ofron përfitimet maksimale?

- A) Utilitar
- B) Moral
- C) Drejtësi
- D) Praktik

Pyetja 77

Si quhet rregulli etik që mbron të drejtat dhe privilegjet themelore të njerëzve të ndikuar nga vendimet?

- A) Utilitar
- B) Moral
- C) Drejtësi
- D) Praktik

Pyetja 78

Cili është një rregull që përcakton nëse një vendim biznesi është etik duke u fokusuar në pranimin e tij në shoqëri?

- A) Utilitar
- B) Moral
- C) Drejtësi
- D) Praktik

Pyetja 79

Si shpërndan rregulli i drejtësisë përfitimet dhe dëmet në mesin e njerëzve dhe grupeve?

- A) Në mënyrë të njëanshme
- B) Në mënyrë të drejtë
- C) Në mënyrë të pabarabartë
- D) Në mënyrë të pamundur

Pyetja 80

Si e përdorin menaxherët rregullin utilitar për të marrë vendime etike?

- A) Duke balancuar interesat e palëve të interesuara
- B) Duke marrë parasysh të drejtat morale
- C) Duke analizuar rregullat praktike
- D) Duke krijuar konflikte të drejtësisë

Pyetja 81

Si mund të ndihmojë rregulli i drejtësisë në zgjedhjen e vendimeve të drejta në një organizatë?

- A) Duke favorizuar një grup të palëve të interesuara
- B) Duke kufizuar mundësitë e zgjedhjes
- C) Duke shpërndarë të drejtat në mënyrë të paanshme
- D) Duke shmangur rregullat praktike

Pyetja 82

Si i krahasojnë menaxherët alternativat e ndryshme të veprimit në bazë të rregullave morale?

- A) Duke marrë parasysh të drejtat morale
- B) Duke balancuar interesat e palëve të interesuara
- C) Duke analizuar rregullat praktike
- D) Duke favorizuar një grup të palëve të interesuara

Pyetja 83

Cila është një mënyra e domosdoshme për të menaxhuar pretendimet e të gjithë palëve të interesuara?

- A) Duke favorizuar një grup të palëve të interesuara
- B) Duke shpërndarë të drejtat në mënyrë të paanshme
- C) Duke kufizuar mundësitë e zgjedhjes
- D) Duke analizuar rregullat praktike

Pyetja 84

Cili prej elementëve më poshtë përcakton standarde për sjelljen e individëve në një shoqëri?

- A) Etika profesionale
- B) Etika organizative
- C) Etika shoqërore
- D) Etika individuale

Pyetja 85

Çfarë përfshin etika profesionale?

- A) Normat për sjelljen në profesionet e ndryshme
- B) Standardet personale dhe vlerat
- C) Besimet personale të individëve
- D) Praktikrat udhëzuese të një kompanie

Pyetja 86

Si mund të përshkruhet etika individuale?

- A) Standardet për sjelljen në shoqëri
- B) Rregullat dhe normat e grupit profesional
- C) Standardet personale dhe vlerat
- D) Praktikrat udhëzuese të një kompanie

Pyetja 87

Cili aspekt i etikës fokusohet në praktikrat udhëzuese dhe besimet e një organizate?

- A) Etika shoqërore
- B) Etika profesionale
- C) Etika individuale
- D) Etika organizative

Pyetja 88

Në cilën nivel të etikës janë të përfshira rregullat që drejtojnë sjelljen ndërmjet profesionistëve?

- A) Etika organizative
- B) Etika profesionale
- C) Etika shoqërore
- D) Etika individuale

Pyetja 89

Cili është një shembull i shkeljes së etikës profesionale në menaxhimin e prodhimit dhe materialeve?

- A) Marketingu i pavërtetë
- B) Hedhja në treg të produkteve të rrezikshme
- C) Përdorimi i reklamave të rreme
- D) Fshehja e pagesave për menaxherët e lartë

Pyetja 90

Cili është një shembull i shkeljes së etikës profesionale në menaxhimin e shitjeve dhe marketingut?

- A) Fshehja e informacionit financiar
- B) Marketingu i përvojës së konsumatorit
- C) Reklammat bindëse të produktit por jo reale
- D) Hedhja në treg të produkteve të rrezikshme

Pyetja 91

Si mund të përshkruhet etika organizative në një kompani?

- A) Praktikrat udhëzuese dhe besimet
- B) Standardet personale dhe vlerat
- C) Rregullat dhe normat e grupit profesional
- D) Normat për sjelljen në profesionet e ndryshme

Pyetja 92

Cila prej këtyre është një përcaktim i etikës shoqërore?

- A) Standardet personale dhe vlerat
- B) Rregullat dhe normat e grupit profesional
- C) Normat për sjelljen në profesionet e ndryshme
- D) Standardet që drejtojnë anëtarët e një shoqërie

Pyetja 93

Cili është një shembull i shkeljes së etikës profesionale në menaxhimin e financës dhe kontabilitetit?

- A) Hedhja në treg të produkteve të rrezikshme
- B) Marketingu i përvojës së konsumatorit
- C) Fshehja e informacionit financiar
- D) Reklammat bindëse të produktit

Pyetja 94

Cili është një shembull i shkeljes së etikës profesionale në menaxhimin e burimeve njerëzore?

- A) Fshehja e informacionit financiar
- B) Cënimi i privatësisë së punonjësve
- C) Reklammat bindëse të produktit por jo reale
- D) Marketingu i përvojës së konsumatorit

Pyetja 95

Çfarë përfshin mjedisi i largët i një organizate?

- A) Mjedisin e industrisë dhe mjedisin e brendshëm
- B) Mjedisin politik, ekonomik, social dhe teknologjik
- C) Prodhimin dhe shpërndarjen
- D) Përdorimin e teknologjive dhe inovacionin

Pyetja 96

Cili është një faktor politik që ndikon në një firmë?

- A) Niveli i pagave
- B) Teknologjia e re
- C) Demografia
- D) Stabiliteti politik

Pyetja 97

Cili faktor ekonomik duhet të merret parasysh në planifikimin strategjik?

- A) Konkurrenca
- B) Inflacioni
- C) Stili i jetesës
- D) Zbulimet teknologjike

Pyetja 98

Pse janë të rëndësishëm faktorët teknologjikë për një firmë?

- A) Ndikon në stilin e jetesës
- B) Ndikon në cilësinë e mjedisit
- C) Nxite inovacionin
- D) Rrit stabilitetin politik

Pyetja 99

Çfarë nënkupton ekologjia në kontekstin e biznesit?

- A) Marrëdhëniet midis njeriut dhe mjedisit natyror
- B) Marrëdhëniet midis menaxherëve dhe punonjësve
- C) Sistemin e pagave të firmës
- D) Strukturën e tregut të kapitalit

Pyetja 100

Çfarë është analiza PEST?

- A) Një metodë për menaxhimin e burimeve njerëzore
- B) Një metodë për analizimin e mjedisit politik, ekonomik, social dhe teknologjik
- C) Një metodë për përmirësimin e produkteve
- D) Një metodë për rritjen e fitimeve dhe menaxhimin e brendshëm

Pyetja 101

Cila është një nga 5 forcat e Porterit?

- A) Shkalla e inovacionit teknologjik
- B) Mjedisi ekologjik
- C) Sistemet e shpërndarjes
- D) Fuqia e furnitorëve

Pyetja 102

Çfarë përfshin mjedisi i industrisë?

- A) Faktorët që ndikojnë vetëm në prodhimin e brendshëm
- B) Faktorët që ndikojnë në aftësinë e organizatës për t'u pozicionuar kundrejt rivalëve
- C) Faktorët që ndikojnë vetëm në marketing
- D) Faktorët që ndikojnë në teknologjinë e përdorur

Pyetja 103

Çfarë përfshin kërcënimi nga hyrësit e rinj në një industri?

- A) Shtimin e kapacitetit të një industrie dhe zënien e një pjese të tregut
- B) Rritjen e cilësisë së produkteve ekzistuese
- C) Rritjen e investimeve teknologjike
- D) Përmirësimin e marrëdhënieve me konsumatorët

Pyetja 104

Cila është një nga barrierat e prekshme për hyrjen në një industri?

- A) Reputacioni i firmave ekzistuese
- B) Besimi i konsumatorëve
- C) Kërkesat për kapital
- D) Aftësitë menaxheriale

Pyetja 105

Cili është një shembull i një faktori politik që mund të ndikojë në një firmë?

- A) Programet e taksave
- B) Përqindja e inflacionit
- C) Tendenca e PBB
- D) Shpejtësia e transferimit të teknologjisë

Pyetja 106

Si ndikon inflacioni në një firmë?

- A) Rrit të ardhurat e disponueshme
- B) Zvogëlon nevojën për kapital
- C) Rrit koston e materialeve dhe shërbimeve
- D) Zvogëlon kërkesën për produkte

Pyetja 107

Çfarë ndikimi ka stabiliteti politik në zhvillimin e biznesit?

- A) Nuk ka ndikim të madh
- B) Ul kërkesën për produkte
- C) Zvogëlon mundësinë për kredi
- D) Rrit investimet e huaja

Pyetja 108

Cili është një faktor ekonomik që duhet të shqyrtohet në planifikimin strategjik?

- A) Ligji mbi punësimin
- B) Sjellja në punë dhe pushim
- C) Përqindja e interesit
- D) Ndryshimet demografike

Pyetja 109

Cili faktor social ka ndikuar në rritjen e numrit të grave në tregun e punës?

- A) Shkalla e edukimit
- B) Stabiliteti i qeverisë
- C) Besimet fetare
- D) Ndryshimet teknologjike

Pyetja 110

Pse është e rëndësishme të parashikohen faktorët socialë në biznes?

- A) Për të rritur normat e interesit
- B) Për të përmirësuar legjislacionin
- C) Për të hartuar strategji afër realitetit
- D) Për të zvogëluar konkurrencën

Pyetja 111

Çfarë nënkupton parashikimi teknologjik?

- A) Zbulimin e tregjeve të reja dhe konsumatorëve të rinj
- B) Vlerësimin e efektit të ndryshimeve teknologjike në veprimtarinë e firmave
- C) Zvogëlimin e inflacionit
- D) Rritjen e besnikërisë së konsumatorëve

Pyetja 112

Cili është një përfitim i përdorimit të kompjuterëve në biznes?

- A) Ulja e pagave të punonjësve
- B) Rritja e stabilitetit politik
- C) Zvogëlimi i shpenzimeve për marketing
- D) Përpunimi i shpejtë dhe i saktë i informacionit

Pyetja 113

Si ndikojnë faktorët socialë në kërkesat e punonjësve?

- A) Rritja e qëndrueshmërisë financiare
- B) Kërkesa për kushte më të mira pune
- C) Zvogëlimi i investimeve teknologjike
- D) Ulja e çmimeve të produkteve

Pyetja 114

Cili është faktori teknologjik që ka një ndikim të madh në konkurrencën e firmave?

- A) Politikat e marketingut
- B) Legjislacioni mbi taksat
- C) Shpejtësia e adoptimit të teknologjive të reja
- D) Ndryshimet demografike

Pyetja 115

Çfarë përfshin mjedisi i industrisë?

- A) Faktorët që ndikojnë në ekonominë globale
- B) Faktorët që ndikojnë kundrejt rivalëve të saj
- C) Faktorët që ndikojnë vetëm te konsumatorët
- D) Faktorët që ndikojnë vetëm te furnizuesit

Pyetja 116

Cila nga këto forca nuk është pjesë e pesë forcave të Porterit?

- A) Mjedisi i brendshëm
- B) Rivaliteti konkurrues
- C) Fuqia e furnitorëve
- D) Kërcënimi nga produktet zëvendësuese

Pyetja 117

Cili nga këta faktorë e bën rivalitetin konkurrues intensiv?

- A) Shumë konkurrentë të vegjël dhe të dobët
- B) Barriera të larta hyrjeje
- C) Dallim i madh mes produkteve dhe shërbimeve
- D) Barriera të larta daljeje

Pyetja 118

Çfarë mund të bëjë një kompani për të ulur rivalitetin konkurrues?

- A) Të rrisë çmimet e produkteve
- B) Të diferencojë produktin
- C) Të rrisë kostot e prodhimit
- D) Të fokusohet në tregje me kosto të larta fikse

Pyetja 119

Çfarë janë barrierat e hyrjes?

- A) Pengesat që duhet të kapërcejë një firmë për të dalë nga një industri

- B) Pengesat që duhet të kapërcejë një firmë për të hyrë në një industri
- C) Rregullat që përcaktojnë konkurrencën brenda një industrie
- D) Kostot e transportit dhe shpërndarjes

Pyetja 120

Çfarë ndikon në fuqinë e blerësve?

- A) Kur industria furnizuese dominohet nga pak firma
- B) Kur blerësit blejnë një pjesë të vogël të produkteve
- C) Kur furnizuesit janë të shumtë dhe ndërrimi i tyre nuk i kushton shumë
- D) Kur nuk ka produkte zëvendësuese

Pyetja 121

Çfarë ndikon në fuqinë e furnitorëve?

- A) Kur furnitorët integrohen me blerësit
- B) Kur zëvendësuesit janë të shumtë
- C) Kur blerësit kanë shumë mundësi për ndërrim
- D) Kur industria blen pjesën më të madhe të produkteve nga grupi i furnitorëve

Pyetja 122

Çfarë përfshin analiza SWOT?

- A) Rivaliteti konkurrues dhe kërcënimet nga hyrësit e rinj
- B) Fuqitë, dobësitë, shanset dhe kërcënimet
- C) Fuqia e blerësve dhe fuqia e furnitorëve
- D) Strategjitë e marketingut dhe pozicionimin e produktit

Pyetja 123

Çfarë është një dobësi sipas analizës SWOT?

- A) Një avantazh kundrejt konkurrentëve
- B) Një mundësi për rritje në treg
- C) Një kërcënim nga produktet zëvendësuese
- D) Një kufizim apo mungesë burimesh

Pyetja 124

Cili nga elementët është një tregues i pozitës konkurruese?

- A) Shpenzimet e transportit
- B) Përvoja e personelit

- C) Të drejtat ligjore
- D) Mjedisi politik

Pyetja 125

Çfarë përfshin mikromjedisi i një kompanie?

- A) Faktorët politikë, ekonomikë, social dhe teknologjikë
- B) Konkurrentët, konsumatorët, punonjësit dhe furnitorët
- C) Rivaliteti konkurrues, hyrësit e rinj dhe produktet zëvendësuese
- D) Tregjet ndërkombëtare dhe produktet

Pyetja 126

Cila është një nga katër postulatet e e konsumit?

- A) Konsumatorët kanë të drejtë të informohen
- B) Konsumatorët kanë të drejtë të injorohen
- C) Konsumatorët kanë të drejtë të manipulojnë tregun
- D) Konsumatorët kanë të drejtë të diktojnë çmimet

Pyetja 127

Cili nga këto faktorë ndikon në mundësinë e një firme për të gjetur personelin e kualifikuar?

- A) Pagat e larta
- B) Imazhi i kompanisë
- C) Konkurrenca
- D) Specializimi i individeve

Pyetja 128

Cili nga këta elementë është pjesë e mjedisit operues të një firme?

- A) Burimet njerëzore
- B) Teknologjia e avancuar
- C) Ndikimet klimatike
- D) Politikat ndërkombëtare

Pyetja 129

Çfarë përfshin analiza e brendshme në analizën SWOT?

- A) Faktoret ekonomike dhe politike

- B) Shanset dhe kërcënimet
- C) Fuqitë dhe dobësitë
- D) Rivalitetin konkurrues dhe kërcënimin nga hyrësit e rinj

Pyetja 130

Çfarë përfshin analiza e jashtme në analizën SWOT?

- A) Fuqitë dhe dobësitë
- B) Shanset dhe kërcënimet
- C) Faktoret demografike dhe kulture
- D) Konkurrentët dhe furnitorët

Pyetja 131

Çfarë ndodh kur ekzistojnë nivele të larta barrierash në një industri?

- A) Konkurenca bie me kalimin e kohës
- B) Konkurenca rritet me kalimin e kohës
- C) Konkurenca mbetet e pandryshuar
- D) Industria bëhet më e fragmentuar

Pyetja 132

Si mund të ndikohet strategjikisht kompania nga produktet zëvendësuese?

- A) Duke rritur çmimet e produkteve ekzistuese
- B) Duke përmirësuar cilësinë e produkteve ekzistuese
- C) Duke injoruar konkurrencën
- D) Duke ulur koston e prodhimit

Pyetja 133

Çfarë është një avantazh konkurrues për një kompani?

- A) Një disavantazh kundrejt konkurrentëve
- B) Një kufizim në burime
- C) Një kompetencë dalluese që i jep përparësi
- D) Një kërcënim nga produktet zëvendësuese

Kapitulli 8. Planifikimi dhe marrja e vendimeve

Pyetja 1

Cili është një element kyç për mbijetesën dhe suksesin e çdo organizate?

- A) Planifikimi
- B) Kontrolli
- C) Organizimi
- D) Motivimi

Pyetja 2

Cili faktor ndihmon në përcaktimin e mënyrave më fitimprurëse të alokimit të burimeve?

- A) Lidërshipi
- B) Planifikimi
- C) Financat
- D) Inovacioni

Pyetja 3

Çfarë lidhje ka procesi i planifikimit me procesin e kontrollit?

- A) Janë procese të pavarura
- B) Kontrolli pasqyron vetëm realizimin e planeve
- C) Kontrolli shoqërohet me planifikimin
- D) Planifikimi nuk influencon procesin e kontrollit

Pyetja 4

Cili është një nga parimet e përgjithshme të procesit të planifikimit?

- A) Mbivendosja e detyrave
- B) Përfshirja e njerëzve të paefektshëm
- C) Injorimi i faktorëve mjedisorë
- D) Përcaktimi i qartë i objektivave

Pyetja 5

Plane të hartuara për arritjen e një objektivi të papërsëritshëm e ku përfshihet një diapazon i gjerë aktivitetesh janë:

- A) Strategjitë
- B) Programet
- C) Politikat

D) Rregullat

Pyetja 6

Planet që janë udhëheqje për veprim, por nuk bëjnë specifikime në lidhje me kohën se kur duhen kryer këto apo ato veprime janë:

- A) Buxhetet
- B) Programet
- C) Politikat
- D) Rregullat

Pyetja 7

Plane, të cilat pasqyrojnë politikën dhe japin metodën e kryerjes së aktiviteteve të ardhshme, nëpërmjet një tërësie kronologjike të veprimeve të domosdoshme janë:

- A) Procedurat
- B) Programet
- C) Politikat
- D) Rregullat

Pyetja 8

Planet që shprehin mënyrat përmes të cilave do të arrihen objektivat e kompanisë dhe zakonisht marrin formën e akteve normative, të cilat u tregojnë punonjësve se si duhet të veprohet në situata të caktuara, janë:

- A) Procedurat
- B) Programet
- C) Politikat
- D) Rregullat

Pyetja 9

Planet që lidhen me përcaktimin e objektivave afatgjata të një kompanie dhe të veprimeve që do të kryen, si dhe me shpërndarjen e burimeve të nevojshme për të përmbushur objektivat, janë:

- A) Procedurat
- B) Strategjitë
- C) Politikat
- D) Rregullat

Pyetja 10

Planet që përcaktohen si përfundime që duhen arritur, me qëllim që të realizohet misioni i kompanisë, janë:

- A) Procedurat
- B) Strategjitë
- C) Politikat
- D) Strategjitë

Pyetja 11

Planet që shprehen në gjuhën financiare nëpërmjet burimeve financiare, të cilat mbështesin objektivat e synuara për t'u arritur përmes një plani të caktuar, janë:

- A) Buxhetet
- B) Programet
- C) Politikat
- D) Rregullat

Pyetja 12

Si dallon misioni nga qëllimi në kontekstin e organizatave?

- A) Qëllimi është për të mbijetuar, misioni është për të fituar
- B) Qëllimi është përfitimi, misioni është universal
- C) Qëllimi është universal, misioni është i veçantë për organizatën
- D) Qëllimi është për të rritur fitimet, misioni është për të rritur investimet

Pyetja 13

Cili është hapi i parë në procesin e vendimmarrjes?

- A) Kontrolli dhe vlerësimi i rezultateve
- B) Zbatimi i alternativës më të mirë
- C) Vlerësimi i alternativave
- D) Identifikimi i problemit

Pyetja 14

Cila nga këto është një arsye për të marrë vendime të gabuara?

- A) Koha e pamjaftueshme
- B) Informacion i besueshëm
- C) Objektivat e qarta
- D) Një procedurë e strukturuar

Pyetja 15

Çfarë përfshin procesi i vendimmarrjes analitik?

- A) Bazohet në intuitë dhe ndjenjë
- B) Përfshin gjetjen e alternativave dhe vlerësimin e tyre
- C) Përcakton objektivat pa njohur problemet
- D) Mund të zbatohet në kushte të pasigurta

Pyetja 16

Cila është dallimi kryesor midis vendimmarrjes në kushte të rrezikut dhe asaj në kushte të pasigurisë?

- A) Informacioni i plotësuar
- B) Burime të besueshme
- C) Probabiliteti i ndodhjes së alternativave
- D) Vendimet e marra në kushte të sigurisë

Pyetja 17

Cili është thelbi i marrjes në mënyrë intuitiv të vendimeve?

- A) Identifikimi i problemeve komplekse
- B) Zbatimi i procedurave sistematike
- C) Analizimi i të gjitha alternativave
- D) Mbështetet në intuitë dhe parashikim

Pyetja 18

Cili është një qëllim kryesor i analizës së pikës kritike?

- A) Përcaktimi i kostove dhe shpenzimeve
- B) Identifikimi i problemeve të mundshme
- C) Përcaktimi i nivelit të çmimit për të mbuluar kostot
- D) Kontrolli dhe vlerësimi i rezultateve

Pyetja 19

Cila formulë përshkruan pikën kritike?

- A) $TC = FC + Q \times VC$
- B) $Q = FC / (P - VC)$
- C) $Q \times P = FC + P \times VC$
- D) $TR = Q \times P$

Pyetja 20

Cila është karakteristika kryesore e pikës kritike në analizën e kostove?

- A) Kostot janë më të ulëta se të ardhurat
- B) Të ardhurat janë të barabarta me kostot totale
- C) Rritja e humbjes me prodhimin më të madh
- D) Mungesa e informacionit për të marrë vendime

Pyetja 21

Cili është qëllimi i paraqitjes grafike në analizën e pikës kritike?

- A) Identifikimi i sasisë kritike
- B) Vlerësimi i avantazheve dhe disavantazheve
- C) Përcaktimi i kufijve të ndryshimeve
- D) Shpjegimi i konceptit të vendimmarrjes

Pyetja 22

Si ndihmon pema e vendimeve në procesin e marrjes së vendimeve?

- A) Duke shfaqur detaje të mundshme të alternativave.
- B) Duke shkruar emrat e alternativave në mënyrë të qartë.
- C) Duke shënuar probabilitetet e ngjarjeve për të gjitha alternativat.
- D) Duke bërë një analizë të plotë për alternativat e mundshme

Pyetja 23

Cili është hapi i parë në vlerësimin e pemës së vendimeve?

- A) Llogaritja e vlerës monetare për çdo rezultat të mundshëm të vendimeve.
- B) Përcaktimi i probabilitetit për secilin rreth në pemën e vendimeve.
- C) Shumëzimi i vlerave monetare me probabilitetet për secilin rezultat të mundshëm.
- D) Vizatimi i rrethëve për të paraqitur mundësitë e vendimeve.

Pyetja 24

Cili është avantazhi kryesor i përdorimit të pemës së vendimeve në marrjen e vendimeve?

- A) Paraqet vetëm një opsion për të marrë vendime.
- B) Siguron një analizë të plotë dhe të qartë për alternativat e mundshme.
- C) Shfaq fotografi të rezultateve të mundshme.
- D) Jep mundësinë për të vendosur emrat e alternativave në mënyrë të qartë.

Pyetja 25

Një kompani po planifikon t'i shtojë një artikull të ri gamës së artikujve që ajo ofron. Ky investim ka një kosto fikse 45 000\$. Kostot variabël janë vlerësuar të jenë 12,75 \$. Firma dëshiron që sasia e produkteve të prodhuara dhe të shitura në pikën kritike të jetë 8 000 njësi në vit. Cili do të jetë çmimi i artikullit të ri?

- A) 14.25 \$
- B) 17.00 \$
- C) 16.50 \$
- D) 18.75 \$

Pyetja 26

Një kompani po planifikon t'i shtojë një artikull të ri gamës së artikujve që ajo ofron. Ky investim ka një kosto fikse 45 000\$. Kostot variabël janë vlerësuar të jenë 12,75 \$. Firma dëshiron që sasia e produkteve të prodhuara dhe të shitura në pikën kritike të jetë 8 000 njësi në vit. Sa është kostoja totale për të arritur pikën kritike në sasinë e dëshiruar prej 8,000 njësi?

- A) 96,000 \$
- B) 112,500 \$
- C) 173,500 \$
- D) 141,000 \$

Pyetja 27

Një shërbim i ri mund të shitet 12 \$ për çdo klient. Kostoja variabël për të siguruar këtë shërbim të ri është 7\$ /njësi. Nëse sasia në pikën kritike është 10 000 klientë në vit, cila do të jetë kostoja fikse vjetore për ta blerë pajisjen? Cila është kostoja fikse vjetore për ta blerë pajisjen për shërbimin e ri në pikën kritike?

- A) 50,000 \$
- B) 70,000 \$
- C) 80,000 \$
- D) 90,000 \$

Pyetja 28

Kompania po analizon dy procese me intensitet kapitali të ndryshëm për prodhimin e një produkti. Të dhënat janë si më poshtë:

	Procesi 1	Procesi 2
Kosto fikse vjetore \$	50 000	200 000
Kostoja variabël \$/njësi	400	150

Sa është sasia e indiferences?

- A) 300 njësi
- B) 400 njësi

- C) 500 njësi
- D) 600 njësi

Pyetja 29

Kompania po analizon dy procese me intensitet kapitali të ndryshëm për prodhimin e një produkti. Të dhënat janë si më poshtë:

	Procesi 1	Procesi 2
Kosto fikse vjetore \$	50 000	200 000
Kostoja variabël \$/njësi	400	150

Referuar tabelës së mësipërme, për ç'sasi procesi i prodhimit 1 bëhet më i mirë se procesi i prodhimit 2?

- A) Për sasi më të vogla se 600 njësi
- B) Për sasi më të vogla se 500 njësi
- C) Për sasi më të vogla se 400 njësi
- D) Për sasi më të vogla se 300 njësi

Pyetja 30

Kompania po analizon dy procese me intensitet kapitali të ndryshëm për prodhimin e një produkti. Të dhënat janë si më poshtë:

	Procesi 1	Procesi 2
Kosto fikse vjetore \$	50 000	200 000
Kostoja variabël \$/njësi	400	150

Referuar tabelës së mësipërme, për ç'sasi procesi i prodhimit 1 bëhet më i mirë se procesi i prodhimit 2?

Referuar tabelës së mësipërme, për ç'sasi procesi i prodhimit 2 bëhet më i mirë se procesi i prodhimit 1?

- A) Për sasi më të mëdha se 300 njësi
- B) Për sasi më të mëdha se 400 njësi
- C) Për sasi më të mëdha se 500 njësi
- D) Për sasi më të mëdha se 600 njësi

Pyetja 31

Mënyra se si organizata do të bëjë shpërndarjen e burimeve në funksion të synimeve të saj strategjike ka të bëjë me:

- A) Fushën e strategjisë
- B) Sinergjinë
- C) Organizimin e burimeve
- D) Avantazhet konkurruese

Pyetja 32

Çfarë përfaqëson strategjia e nivelit të biznesit sipas Michael Porter?

- A) Një plan për të rritur cilësinë e produkteve
- B) Një plan për të fituar një avantazh konkurrues në një treg ose industri të caktuar
- C) Një metodë për të ulur kostot e prodhimit
- D) Një mënyrë për të zgjeruar biznesin globalisht

Pyetja 33

Sipas Porter-it, cilat janë dy mënyrat themelore për të rritur vlerën e produkteve të organizatës?

- A) Zgjerimi dhe diversifikimi
- B) Diferencimi i produktit dhe ulja e kostove të prodhimit
- C) Rritja e marketingut dhe përmirësimi i shërbimit ndaj klientit
- D) Zgjerimi në tregje të reja dhe inovacioni

Pyetja 34

Cila strategji përfshin fokusimin në uljen e shpenzimeve të kompanisë poshtë shpenzimeve të rivalëve të saj të industrisë?

- A) Strategjia me kosto të ulët
- B) Strategjia e diferencimit
- C) Strategjia e zgjerimit
- D) Strategjia e marketingut

Pyetja 35

Cila strategji përfshin fokusimin në të bërit të dallueshëm produktet e organizatës nga ato të konkurrentëve?

- A) Strategjia me kosto të ulët
- B) Strategjia e zgjerimit
- C) Strategjia e diferencimit
- D) Strategjia e inovacionit

Pyetja 36

Sipas Porter-it, çfarë ndodh kur një organizatë ndjek në të njëjtën kohë një strategji me kosto të ulët dhe një strategji diferencimi?

- A) Arrin fitime maksimale
- B) "Të mbërthyer në mes" dhe performon më dobët
- C) Bëhet lider i industrisë
- D) Rrit shpejtësinë e zhvillimit të produkteve

Pyetja 37

Çfarë përfaqëson strategjia e koston së ulët të fokusuar?

- A) Shërbimi i nevojave të klientëve në shumë segmente të tregut
- B) Rritja e marketingut për të tërhequr më shumë klientë

- C) Inovacioni në dizenjimin e produkteve
- D) Fokusimi në një segment të caktuar të tregut me kosto të ulët

Pyetja 38

Cila është detyra e menaxherëve pasi kanë formuluar strategjitë e nivelit të biznesit?

- A) Të punësojnë staf të ri
- B) Të planifikojnë investimin e fitimeve për të rritur performancën
- C) Të ndryshojnë emrin e kompanisë
- D) Të krijojnë strategji të reja të marketingut

Pyetja 39

Çfarë përfshin strategjia në nivel korporate?

- A) Zgjedhja e industrisë dhe vendeve për investim të burimeve
- B) Zgjedhja e logo-s së kompanisë
- C) Përcaktimi i pagave të punonjësve
- D) Zgjedhja e politikave të marketingut

Pyetja 40

Çfarë është përqendrimi në një industri të vetme?

- A) Zgjerimi në tregje ndërkombëtare
- B) Blerja e kompanive të vogla në industri të ndryshme
- C) Riinvestimi i fitimeve për të forcuar pozitën konkurruese në një industri ekzistuese
- D) Hapja e dyqaneve të reja në tregje të reja

Pyetja 41

Çfarë nënkupton integrimi vertikal i hershëm (prapa)?

- A) Zgjerimi në një industri që prodhon inpute për kompaninë
- B) Hapja e dyqaneve të reja në tregje të reja
- C) Bashkimi me një kompani konkurrense
- D) Përmirësimi i strategjive të marketingut

Pyetja 42

Kur një kompani zgjeron operacionet e saj duke hyrë në industri ose tregje të reja që janë të lidhura me aktivitetet e saj ekzistuese, themi se kemi të bëjmë me:

- A) Integrim vertikal i hershëm (prapa)
- B) Integrim vertikal i vonshëm (përpara)

- C) Diversifikim i lidhur
- D) Diversifikim i palidhur

Pyetja 43

Cili është avantazhi kryesor i një strategjie lokale?

- A) Ulja e kostove të prodhimit
- B) Përshtatja e produkteve dhe marketingut për kushte lokale
- C) Rritja e fitimeve të kompanisë
- D) Shitja e produkteve

Pyetja 44

Çfarë është diversifikimi i pa lidhur?

- A) Ndërtimi i fabrikave të reja jashtë vendit
- B) Shitja e produkteve të ekzistuese në tregje të reja
- C) Përmirësimi i strategjive të marketingut
- D) Hyrja në industri të reja që nuk kanë lidhje me bizneset ekzistuese

Pyetja 45

Çfarë nënkupton integrimi vertikal përpara?

- A) Hyrja në një biznes të ri të shpërndarjes dhe shitjes së produktit të gatshëm
- B) Zgjerimi i operacioneve të biznesit në një industri që prodhon inpute për kompaninë
- C) Bashkimi me një kompani konkurrenente
- D) Përmirësimi i strategjive të marketingut

Pyetja 46

Çfarë është sinergjia në kontekstin e diversifikimit të lidhur?

- A) Rritja e kostos së prodhimit
- B) Vlera e krijuar nga bashkëpunimi i dy ose më shumë divizioneve
- C) Ulja e pagave të punonjësve
- D) Shitja e produkteve ekzistuese në tregje të reja

Pyetja 47

Cili është rreziku kryesor i ndjekjes së një strategjie globale?

- A) Rritja e kostos së prodhimit dhe vendosja e çmimeve të larta
- B) Ulja e pagave të punonjësve
- C) Përdorimi i strategjive të marketingut të paefektshme në tregje të ndryshme

D) Shitja e produkteve ekzistuese

Pyetja 48

Cili është avantazhi kryesor i ndjekjes së një strategjie lokale?

- A) Ulja e kostos së prodhimit
- B) Rritja e fitimeve të kompanisë
- C) Përshtatja e produkteve dhe marketingut për kushte lokale
- D) Shitja e produkteve ekzistuese

Pyetja 49

Cili është avantazhi kryesor i diversifikimit të palidhur?

- A) Krijon mundësi për të transferuar aftësitë e menaxhimit në kompani të tjera
- B) Ulja e kostos së prodhimit
- C) Përdorimi i strategjive të marketingut të paefektshme në tregje të ndryshme
- D) Shitja e produkteve ekzistuese në tregje të reja

Pyetja 50

Cili është disavantazhi kryesor i diversifikimit të palidhur?

- A) Rritja e kostos së prodhimit
- B) Vështirësia në menaxhimin e shumë industrive të ndryshme
- C) Ulja e pagave të punonjësve
- D) Shitja e produkteve ekzistuese në tregje të reja

Pyetja 51

Çfarë është një strategji e portofolit?

- A) Ndërtimi i fabrikave të reja jashtë vendit
- B) Shpërndarja e burimeve financiare mes divizioneve për të rritur kthimet financiare
- C) Ulja e kostos së prodhimit
- D) Përmirësimi i strategjive të marketingut

Pyetja 52

Çfarë është zgjerimi ndërkombëtar?

- A) Shitja e produkteve ekzistuese në tregje lokale
- B) Ndërtimi i fabrikave të reja branda vendit
- C) Përmirësimi i strategjive të marketingut
- D) Konkurrimi në më shumë se një treg kombëtar

Pyetja 53

Cila është detyra kryesore e menaxherëve kur ndërmarrin zgjerimin ndërkombëtar?

- A) Përcaktimi i pagave të punonjësve
- B) Përcaktimi i mënyrës së përshtatjes së produkteve dhe marketingut për tregjet ndërkombëtare
- C) Shitja e produkteve ekzistuese në tregje të reja
- D) Ndërtimi i fabrikave të reja jashtë vendit

Pyetja 54

Cili nga operacionet globale, referuar nivelit të përfshirjes dhe investimeve të huaja, është më pak kompleks?

- A) Franshiza
- B) Aleanca strategjike
- C) Importi dhe eksporti
- D) Licensimi

Pyetja 55

Cili është avantazhi kryesor i eksportit?

- A) Shpenzime të ulëta të transportit
- B) Investim i vogël jashtë vendit
- C) Kontroll i plotë mbi prodhimin
- D) Shpërblime të mëdha

Pyetja 56

Cili është rreziku kryesor i licensimit?

- A) Humbja e kontrollit mbi teknologjinë dhe njohuritë
- B) Shpenzime të mëdha të zhvillimit
- C) Investim i lartë kapitali
- D) Investim i madh jashtë vendit

Pyetja 57

Cili është avantazhi kryesor i franshizës për franshizuesin?

- A) Kontroll i plotë mbi operacionet
- B) Investim i ulët për zgjerim jashtë vendit
- C) Rreziqe të ulëta financiare
- D) Shpenzime të ulëta të transportit

Pyetja 58

Cili është rreziku kryesor i franshizës për franshizuesin?

- A) Shpenzime të larta fillestare
- B) Kontroll i plotë mbi prodhimin
- C) Investim i lartë kapitali
- D) Humbja e emrit të mirë

Pyetja 59

Cili është avantazhi kryesor i një filiali në pronësi të plotë të huaj?

- A) Investim i ulët fillestar
- B) Koordinim i lehtë me partnerët e huaj
- C) Kontroll i plotë mbi operacionet
- D) Shpenzime të larta të transportit

Pyetja 60

Cili është disavantazhi kryesor i një filiali në pronësi të plotë të huaj?

- A) Rrezik i lartë për humbjen e teknologjisë
- B) Kontroll i ulët mbi prodhimin
- C) Koordinim i vështirë me partnerët e huaj
- D) Investim i lartë kapitali

Pyetja 61

Cila strategji ndihmon në reduktimin e rreziqeve të humbjes së kontrollit mbi operacionet e huaja?

- A) Aleanca strategjike
- B) Eksporti
- C) Licensimi
- D) Franchising

Pyetja 62

Cila është strategjia më e shtrenjtë për zgjerimin ndërkombëtar?

- A) Eksporti
- B) Licensimi
- C) Franchising
- D) Filiali në pronësi të plotë të huaj

Pyetja 63

Cili është një avantazh i aleancave strategjike në krahasim me licensimin?

- A) Kontroll i plotë mbi teknologjinë
- B) Investim i ulët fillestar
- C) Ndarja e rreziqeve
- D) Shpenzime të ulëta të transportit

Pyetja 64

Cila nga alternativat e mëposhtme është një shembull i vendimmarrjes së programuar?

- A) Investimi në një teknologji të re
- B) Zhvillimi i një lloji të ri të produktit
- C) Urdhërimi i furnizimeve bazë të zyrës kur inventari bie nën një nivel të caktuar
- D) Hyrja në një treg të ri

Pyetja 65

Cila nga alternativat e mëposhtme përshkruan më mirë vendimmarrjen e jo programuar?

- A) Fillimi i një biznesi të ri
- B) Vendosja se sa inventar duhet mbajtur
- C) Kur do të paguhen faturat
- D) Urdhërimi i materialeve kur raftet e magazinës janë tre të katërtat të zbrazëta

Pyetja 66

Cilat vendime janë të karakterizuara nga zhvillimi i rregullave dhe udhëzimeve specifike?

- A) Vendimmarrja e jo programuar
- B) Vendimmarrja e programuar
- C) Vendimmarrja strategjike
- D) Vendimmarrja taktike

Pyetja 67

Cili nga këto shembuj është vendimmarrje e jo programuar?

- A) Punësimi i punëtorëve të rinj kur puna jashtë orarit rritet me më shumë se 10%
- B) Zhvillimi i një lloji të ri të produktit
- C) Vendosja se kur duhen paguar faturat
- D) Urdhërimi i letrës kur inventari bie nën një nivel të caktuar

Pyetja 68

Në cilën situatë ndodh vendimmarrja e programuar?

- A) Kur nuk ka rregulla të gatshme për vendimmarrje
- B) Kur një situatë është e papritur dhe e pasigurt
- C) Kur menaxherët kanë informacion të mjaftueshëm për të krijuar rregulla
- D) Kur një menaxher duhet të përgjigjet ndaj kërcënimeve të reja

Pyetja 69

Cili është përshkrimi më i mirë i vendimmarrjes së jo programuar?

- A) Proces rutinë dhe automatik
- B) Krijimi i rregullave për situata të përsëritura
- C) Marrja e vendimeve bazuar në udhëzime të përcaktuara mirë
- D) Marrja e vendimeve në situata jo të zakonshme dhe të papritura

Pyetja 70

Cili kriter ka të bëjë me sigurinë që një veprim i mundshëm është etik dhe nuk dëmton ndonjë grup interesi?

- A) Fizibiliteti ekonomik
- B) Etika
- C) Ligjshmëria
- D) Prakticiteti

Pyetja 71

Cili kriter ka të bëjë me mundësinë e realizimit të një alternative duke pasur parasysh burimet njerëzore dhe teknologjinë në dispozicion?

- A) Prakticiteti
- B) Fizibiliteti ekonomik
- C) Ligjshmëria
- D) Etika

Pyetja 72

Cili është qëllimi i kriterit të fizibilitetit ekonomik?

- A) Të zbatohen politika të reja financiare
- B) Të përcaktohet përputhshmëria me rregullat qeveritare
- C) Të përcaktohet nëse një alternativë është ekonomikisht e realizueshme
- D) Të përcaktohet nivelin e sigurisë në vendin e punës

Kapitulli 9. Natyra e organizimit. Motivimi dhe menaxhimi i burimeve njerëzore

Pyetja 1

Cili është përshkrimi më i saktë për organizimin formal?

- A) Është rrjeti i marrëdhënieve të krijuara spontanisht midis individëve brenda organizatës.
- B) Përcaktohet nga politikat dhe procedurat e caktuara në organizatë, duke përshkruar veprimet e ardhshme.
- C) Përfshin lidhjet dhe marrëdhëniet që nuk janë të përcaktuara zyrtarisht nga struktura e organizatës.
- D) Krijon një atmosferë të lirë dhe të përgjegjshme për të mbështetur inovacionin dhe kreativitetin.

Pyetja 2

Cila është një përfitimi i organizimit formal për një kompani?

- A) Lejon zhvillimin e lidhjeve informale midis punonjësve.
- B) Bëhet shumë burokratik dhe të ulë fleksibilitetin në organizatë.
- C) Inkurajon autonome dhe vetë-drejtimin midis vartësve.
- D) Siguron një strukturë të qartë dhe rrjete të komunikimit formal në organizatë.

Pyetja 3

Cilat janë disavantazhet e organizimit formal?

- A) Inkurajon inovacionin dhe lirinë për të eksperimentuar.
- B) Mund të bëhet shumë burokratik dhe të ulë fleksibilitetin në organizatë.
- C) Nuk pasqyron marrëdhëniet njerëzore dhe ndihmon në ndërtimin e lidhjeve të fuqishme midis punonjësve.
- D) Jep një pamje statike të strukturës organizative dhe duhet të përditësohet shpesh.

Pyetja 4

Organizimi informal në një organizatë mund të përkufizohet si:

- A) Rrjeti i marrëdhënieve personale dhe shoqërore që nuk janë përcaktuar zyrtarisht nga struktura formale.
- B) Politikat dhe procedurat e caktuara për veprimet e ardhshme në organizatë.
- C) Rrjeti i kanaleve zyrtare të komunikimit brenda departamenteve.
- D) Organizimi formal dhe formalitetet e detyrimeve për punonjësit.

Pyetja 5

Cila është një arsye pse organizimi informal mund të jetë i rëndësishëm për menaxherët?

- A) Për shkak se këto marrëdhënie janë gjithmonë në drejtimin e kundërt me marrëdhëniet formale.
- B) Sepse organizimi informal ndihmon në sigurimin e një strukture të qartë të organizatës.
- C) Për shkak se ndihmon në zgjidhjen e detyrave të rëndësishme dhe krijon një mënyrë të komunikimit të drejtë midis departamenteve.
- D) Sepse organizimi formal është gjithmonë më i rëndësishëm sesa organizimi informal.

Pyetja 6

Si mund të përshkruhet organizimi informal në kontekstin e një organizate?

- A) Si një strukturë e caktuar me politika dhe procedura të shkruara në dokumente.
- B) Si një rrjet i marrëdhënieve shoqërore dhe personale që ka lindur spontanisht ndërsa individët punojnë bashkë.
- C) Si një mënyrë për të përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë për pozitat në organizatë.
- D) Si një mënyrë për të pasqyruar rrjedhën e autoritetit dhe përgjegjësisë në të gjitha nivelet e hierarkisë së organizatës.

Pyetja 7

Cila është një karakteristikë e organizimit sipas funksioneve?

- A) Grupimi i punonjësve bazuar në lokacionin fizik të tyre në organizatë.
- B) Grupimi i punonjësve bazuar në një kombinim të përgjegjësive të ndryshme të punës.
- C) Grupimi i punonjësve të cilët kryejnë funksione të njëjta, si shitja, prodhimi, financat.
- D) Grupimi i punonjësve bazuar në nivelin e tyre hierarkik në organizatë.

Pyetja 8

Cilat janë avantazhet e departamentizimit sipas funksioneve?

- A) Përqendrimi më shumë në specifika dhe shmangie nga objektivat e përgjithshme.
- B) Çdo departament përbëhet nga specialiste të funksioneve të veçanta.
- C) Pozitat drejtuese kërkojnë njerëz me përvojë.
- D) Rrit problemet për menaxherët e nivelit të lartë në ushtrimin e kontrollit të duhur.

Pyetja 9

Cilat janë disavantazhet e departamentizimit sipas funksioneve?

- A) Çdo departament përbëhet nga specialiste të funksioneve të veçanta.
- B) Nuk zbatohet lehtë në praktikë.
- C) Përqendrimi më shumë në specifika dhe shmangie nga objektivat e përgjithshme.
- D) Menaxheri mund të kontrollojë dhe koordinojë me efektivitet.

Pyetja 10

Cili është një avantazh i departamentizimit sipas metodës së funksioneve?

- A) Fushat e përgjegjësisë janë përcaktuar qartë
- B) Njihen më mirë nevojat lokale.
- C) Përfiton nga avantazhet e ekonomizimeve nga operacionet lokale.
- D) Rrit problemet për menaxherët e nivelit të lartë në ushtrimin e kontrollit të duhur.

Pyetja 11

Cili është një disavantazh i departamentizimit sipas funksioneve?

- A) Sjell koordinim në rajon.
- B) Përqendrimi më shumë në specifika dhe shmangie nga objektivat e përgjithshme.
- C) Përfiton nga avantazhet e ekonomizimeve nga operacionet lokale.
- D) Komunikim më i lehtë marketing.

Pyetja 12

Cili është një përfitim i rëndësishëm i departamentizimit sipas funksioneve?

- A) Kërkon më tepër persona me cilësi të përgjithshme menaxheriale.
- B) Rrit problemet për menaxherët e nivelit të lartë në ushtrimin e kontrollit të duhur.
- C) Japin një pamje statike të organizimit.
- D) Menaxheri mund të kontrollojë e koordinojë me efektivitet.

Pyetja 13

Pse departamentizimi sipas funksioneve zbatohet lehtë në praktikë?

- A) Për shkak të njohjes më të mirë të nevojave lokale.
- B) Sepse përqendron më shumë në specifika dhe shmang objektivat e përgjithshme.
- C) Sepse është e lehtë të vendosen rregullat formale dhe procedurat.
- D) Sepse menaxheri mund të kontrollojë e koordinojë me efektivitet.

Pyetja 14

Cili është një avantazh i departamentizimit sipas ndarjes gjeografike në organizim?

- A) Sjell koordinim në rajon
- B) Përqendrohet në specializime të veçanta
- C) Rrit efikasitetin në prodhim
- D) Minimizon shpenzimet administrative

Pyetja 15

Cilën nga këto përfitime ka departamentizimi sipas ndarjes gjeografike në organizatë?

- A) Rrit efikasitetin e prodhimit
- B) Ndhomon në zhvillimin e produkteve të reja
- C) Lehtëson transferimin e punonjësve
- D) Përfiton nga avantazhet e ekonomizimeve nga operacionet lokale

Pyetja 16

Cili është një përfitim i departamentizimit sipas ndarjes gjeografike në organizatë?

- A) Menaxhimi i lehtë i punonjësve
- B) Shumë fleksibilitet në rrjetin e shpërndarjes
- C) Komunikim më i lehtë në marketing
- D) Specializimi në çdo rajon të organizatës

Pyetja 17

Cili është një avantazh i departamentizimit sipas ndarjes gjeografike në organizatë?

- A) Shfrytëzimi optimal i burimeve njerëzore
- B) Njohja e nevojave lokale
- C) Specializimi në sektorë të ndryshëm
- D) Përqendrimi në rritjen e të ardhurave

Pyetja 18

Cili është një disavantazh i departamentizimit sipas ndarjes gjeografike në organizatë?

- A) Kërkon më tepër persona me cilësi të përgjithshme menaxheriale
- B) Përqendrohet në specializime të veçanta
- C) Rrit efikasitetin në prodhim
- D) Minimizon shpenzimet administrative

Pyetja 19

Cili është një nga problemet e departamentizimit sipas ndarjes gjeografike në organizatë?

- A) Shfrytëzimi i efektshëm i burimeve njerëzore
- B) Rrit probleme për menaxherët e nivelit të lartë në ushtrimin e kontrollit të duhur
- C) Lehtëson transferimin e punonjësve
- D) Përfiton nga avantazhet e ekonomizimeve nga operacionet lokale

Pyetja 20

Cila nuk është një avantazh i departamentizimit sipas produktit në organizim?

- A) Ka koordinim mes departamenteve
- B) Përdor teknologji të specializuara
- C) Shfrytëzohen aftësitë e veçanta
- D) Thjeshtëson trajnimin

Pyetja 21

Cili është një disavantazh i departamentizimit sipas produktit në organizim?

- A) Lehtëson transferimin e punonjësve
- B) Përqendrimi më shumë në specifika dhe shmangie nga objektivat e përgjithshme.
- C) Përfiton nga avantazhet e ekonomizimeve nga operacionet lokale
- D) Koordinimi mes departamenteve është i vështirë

Pyetja 22

Cila është një avantazh i metodës së departamentizimit sipas kohës në organizim?

- A) Lehtëson koordinimin mes departamenteve
- B) Përmirëson komunikimin në mes të departamenteve
- C) Mundëson specializimin në shërbimet pa ndërprerje
- D) Zvogëlon nevojën për trajnim të vazhdueshëm

Pyetja 23

Cili është një avantazh i ofruar nga ndarja e punës në firmat e vogla të biznesit?

- A) Zvogëlon numrin e punëtorëve në njësi
- B) Rrit kostoja për njësi
- C) Rrit eficiencën dhe produktivitetin
- D) Shkakton monotoninë në punë

Pyetja 24

Cili është një sfidë e ndarjes së punës në kontekstin e firmave të vogla të biznesit?

- A) Lejon përdorimin e makinerive të specializuara
- B) Rrit eficiencën dhe motivimin e punëtorëve
- C) Mundëson autonomi dhe mendim krijues nga punëtorët
- D) Shkakton rënien e produktivitetit pas një kohe të caktuar

Pyetja 25

Cilën sfidë mund të shkaktojë ndarja e punës në pjesë të thjeshta, siç janë linjat e prodhimit të automobilave në fabrika?

- A) Rrit lodhjen dhe monotominë e punës
- B) Përmirëson kualifikimin e punëtorëve
- C) Rrit efikasitetin dhe produktivitetin
- D) Zvogëlon numrin e punëtorëve në linjë

Pyetja 26

Cilën përfitim sjell rotacioni në punë për punëtorët në linjat e prodhimit?

- A) Rrit efikasitetin dhe produktivitetin
- B) Ul kualifikimin e punëtorëve
- C) Mundëson qarkullimin e punëtorëve në disa punë
- D) Shkakton mungesa dhe largime nga puna

Pyetja 27

Cila është arsyeja për përdorimin e zmadhimit të punës në kontekstin e specializimit të punëtorëve?

- A) Përmirëson kualifikimin e punëtorëve
- B) Zbut pasojat negative të monotonisë
- C) Rrit numrin e punëtorëve në një linjë
- D) Zvogëlon numrin e operacioneve

Pyetja 28

Cilën sfidë paraqet zmadhimi i punëve, edhe pse fusha e punës për një punëtor bëhet më e gjerë?

- A) Rrit efikasitetin e punës
- B) Ofron stimulim dhe sfidë të mjaftueshme
- C) Ul motivimin e punëtorëve
- D) Përmirëson koordinimin mes departamenteve

Pyetja 29

Cilin përfitim paraqet pasurimi i përmbajtjes së punës për punonjësit?

- A) Rrit efikasitetin e punës
- B) Zvogëlon përgjegjësinë
- C) Ul nivelin e motivimit të punonjësve
- D) Mundëson zhvillim të vazhdueshëm

Pyetja 30

Cili nga elementët e mëposhtëm përbën një pjesë të rëndësishme të kulturës së organizatës?

- A) Produktet
- B) Konkurrentët
- C) Vlerat
- D) Klientët

Pyetja 31

Si ndihmon kultura e organizatës në përcaktimin e sjelljes së punonjësve?

- A) Përmirëson aftësitë teknike
- B) Shpreh dhe reflekton misionin e saj
- C) Shpërndan dividende
- D) Rrit numrin e kontratave të reja

Pyetja 32

Cili nga llojet e pushtetit përfshin drejtuesin që jep urdhra nga pozita e tij hierarkike dhe është pranuar si legjitim nga vartësit e tij?

- A) Pushteti i shpërblimit
- B) Pushteti i lidhjeve
- C) Pushteti i referencës
- D) Pushteti i pozitës

Pyetja 33

Cili aspekt i pushtetit personal sjell ndikim tek të tjerët për shkak të besimit në idetë dhe aftësitë e një individi të veçantë?

- A) Pushteti referent
- B) Pushteti i lidhjeve
- C) Pushteti shpërblyes
- D) Pushteti i informacionit

Pyetja 34

Çfarë e karakterizon pushtetin legjitim në kontekstin e organizatave private?

- A) Mundësia për të dhënë shpërblime
- B) Bazohet në njohuritë eksperte të menaxherit
- C) Është i lidhur me sistemin e të drejtave dhe detyrimeve
- D) Buron nga lidhjet e menaxherit me persona të influencës

Pyetja 35

Cilin element përfshin pushteti shpërblyes në një organizatë?

- A) Pozita pranohet nga vartësit si diçka legjitime
- B) Stimuli moral dhe përfitimi i pushimeve suplementare
- C) Informacioni i rëndësishëm për operacionet e organizatës
- D) Dënimet si transferimi dhe pushimi nga puna

Pyetja 36

Cila është natyra kryesore e pushtetit shtrëngues në organizatat e biznesit?

- A) Bazohet në lidhjet personale të menaxherit
- B) Është pushtet i mbështetur në njohuritë eksperte
- C) Përdoret për të dhënë urdhra dhe direktiva të natyrshme
- D) Bazohet në frikën e vartësit përpara eprorit

Pyetja 37

Cila është natyra e pushtetit të informacionit në kontekstin e organizatave?

- A) Është i lidhur me sistemin e të drejtave dhe detyrimeve
- B) Buron nga kompetencat për të dhënë shpërblime
- C) Bazohet në privilegjet për akses dhe kontroll të informacionit
- D) Përdoret për të dënuar vartësit në rastet e shkeljeve disiplinore

Pyetja 38

Cila është karakteristikë kryesore e pushtetit të ekspertit?

- A) Bazohet në lidhjet e menaxherit me njerëz influentë.
- B) Rrjedh nga njohuritë dhe dijet e një personi.
- C) Është i lidhur me besimin që vartësit kanë në idetë e një personi.
- D) Ndihmon në përdorimin e dënimeve disiplinore.

Pyetja 39

Pse është e rëndësishme njohja e natyrës njerëzore në një organizatë?

- A) Për të ndihmuar në promovimin e produkteve
- B) Për të përcaktuar mënyrën e organizimit të punës dhe stilin e lidhshimit
- C) Për të ulur kostot e prodhimit
- D) Për të rritur inventarin e materialeve

Pyetja 40

Cila është një nga arsyet themelore për studimin e motivimeve?

- A) Për të zgjidhur konfliktet ndërmjet departamenteve
- B) Për të përmirësuar dizajnin e produkteve
- C) Për të kuptuar dhe përmirësuar performancën e burimeve njerëzore
- D) Për të menaxhuar financat e kompanisë

Pyetja 41

Çfarë nënkupton motivimi?

- A) E drejta për të dhënë urdhra dhe për të kërkuar bindje
- A) Mënyra se si shtytjet, aspiratat, nxitjet dhe nevojat drejtojnë sjelljen njerëzore
- B) Menaxhimi i inventarit të kompanisë
- C) Strategjitë për uljen e kostove operative

Pyetja 42

Çfarë janë stimujt e motivimit?

- A) Gjërat që nxitin individët për të vepruar në një mënyrë të caktuar
- B) E drejta për të dhënë urdhra dhe për të kërkuar bindje
- C) Drejtimet strategjike të organizatës
- D) Metodatat e marketingut të produkteve

Pyetja 43

Çfarë përfaqëson kënaqësia në kontekstin e motivimit?

- A) Shkalla e dobisë së provuar kur kërkesa është përmbushur
- B) Forca dhe përpjekjet për të kënaqur një kërkesë apo synim
- C) Strategjitë për rritjen e produktivitetit
- D) Metodatat për të ulur konfliktet në vendin e punës

Pyetja 44

Cila është një cilësi e rëndësishme e një menaxheri që motivon vartësit e tij?

- A) Kryerja e detyrave administrative
- B) Kënaqja e nevojave, dëshirave dhe kërkesave të vartësve
- C) Mbikëqyrja e procesit të prodhimit
- D) Menaxhimi i burimeve financiare të organizatës

Pyetja 45

Cila është pika fillestare e procesit motivues?

- A) Kënaqja e nevojave
- B) Sjellja e caktuar e individit
- C) Nevojat e paplotësuara
- D) Arritja e qëllimeve të organizatës

Pyetja 46

Çfarë ndodh pas një nevoje të paplotësuar?

- A) Njerëzit pushojnë së punuari
- B) Shfaqet një tension fizik ose psikologjik
- C) Organizata ndryshon strategjinë
- D) Njerëzit marrin pushime

Pyetja 47

Çfarë përfaqëson mbyllja e ciklit motivues?

- A) Arritja e kënaqësisë
- B) Fillimi i një projekti të ri
- C) Ndryshimi i vendit të punës
- D) Përfundimi i një raporti të punës

Pyetja 48

Çfarë bëjnë njerëzit kur nevojat e tyre bëhen të mëdha?

- A) Ndërrojnë profesion
- B) Përpiqen t'i plotësojnë
- C) Ndërpresin marrëdhënien me organizatën
- D) Fillojnë një kurs trajnimi

Pyetja 49

Si ndikon kënaqja e një nevoje në sjelljen e ardhshme?

- A) E bën individin më të ngadaltë në veprime
- B) E bën individin të largohet nga puna
- C) Mund të nxisë dëshirën për të plotësuar nevoja të tjera
- D) Ul nivelin e produktivitetit

Pyetja 50

Çfarë karakteristike ka procesi motivues?

- A) Stabiliteti
- B) Formaliteti
- C) Dinamizmi
- D) Pasiviteti

Pyetja 51

Çfarë ndodh kur një individ nuk i plotësohet një nevojë në punë?

- A) Individit i jepet një rritje page
- B) Individit i bie motivimi dhe mund të kërkojë një punë tjetër
- C) Individit i ndryshohet pozita në organizatë
- D) Individit i jepet më shumë përgjegjësi

Pyetja 52

Cila është shkalla e parë e hierarkisë së nevojave sipas Maslowt?

- A) Nevojat e sigurisë
- B) Nevojat e vlerësimit
- C) Nevojat fiziologjike
- D) Nevojat shoqërore

Pyetja 53

Çfarë përfshijnë nevojat fiziologjike?

- A) Nevoja për dashuri dhe afekcion
- B) Nevoja për ushqim, ujë, ajër dhe veshje
- C) Nevoja për siguri dhe mbrojtje
- D) Nevoja për pushtet dhe prestigj

Pyetja 54

Cila nevojë është e lidhur me kërkesën për të qenë të sigurt nga rreziqet fizike dhe humbja e punës?

- A) Nevojat shoqërore
- B) Nevojat fiziologjike
- C) Nevojat e sigurisë
- D) Nevojat e vetaktualizimit

Pyetja 55

Cila fazë e procesit të rekrutimit përfshin njohjen e punëtorit të ri me detyrat dhe instruksionet e punës?

- A) Testimi
- B) Intervistimi
- C) Orientimi
- D) Kontrolli për kualifikimin

Pyetja 56

Cila nevojë lidhet me dëshirën për t'u njohur dhe respektuar nga të tjerët?

- A) Nevojat e sigurisë
- B) Nevojat e vlerësimit
- C) Nevojat fiziologjike
- D) Nevojat shoqërore

Pyetja 57

Cilat nevoja përfshijnë dëshirat për rritjen dhe zhvillimin e aftësive të individit?

- A) Nevojat shoqërore
- B) Nevojat fiziologjike
- C) Nevojat e vlerësimit
- D) Nevojat e vetaktualizimit

Pyetja 58

Cilat janë nevojat e nivelit më të lartë sipas Maslowt?

- A) Nevojat e sigurisë
- B) Nevojat shoqërore
- C) Nevojat e vlerësimit
- D) Nevojat e vetaktualizimit

Pyetja 59

Kur lindin nevojat e vlerësimit sipas Maslowt?

- A) Pas kënaqjes së nevojave fiziologjike
- B) Pas kënaqjes së nevojave të sigurisë
- C) Pas kënaqjes së nevojave shoqërore
- D) Pas kënaqjes së nevojave të vetaktualizimit

Pyetja 60

Cili prej faktorëve ndihmon në plotësimin e nevojave të vlerësimit?

- A) Siguria e punës
- B) Titujt e punës dhe madhësia e zyrës
- C) Miqësitë në punë
- D) Ushqimi dhe veshmbathja

Pyetja 61

Cilat nevoja dalin në plan të parë vetëm pasi janë kënaqur nevojat e katër niveleve paraardhëse?

- A) Nevojat fiziologjike
- B) Nevojat e sigurisë
- C) Nevojat shoqërore
- D) Nevojat e vetaktualizimit

Pyetja 62

Cili faktor motivues lidhet drejtpërdrejt me pagën dhe shpërblimet?

- A) Pjesëmarrja e punonjësve
- B) Ristrukturimi i punës
- C) Paraja ose paga
- D) Ndryshimi i orarit të punës

Pyetja 63

Për cilat grupe punonjësish paga është një faktor motivues shumë i rëndësishëm?

- A) Punonjësit që kanë plotësuar nevojat minimale të jetës
- B) Punonjësit që sapo kanë filluar punë
- C) Punonjësit e nivelit të lartë
- D) Punonjësit me përvojë të gjatë

Pyetja 64

Cili parim duhet të udhëheqë menaxherët në ndërtimin e një sistemi të drejtë shpërblimi?

- A) Të sigurojnë trajnime të vazhdueshme
- B) Të lidhin pagën me performancën
- C) Të paguajnë punonjësit njësoj për të njëjtën punë
- D) Të krijojnë një atmosferë miqësore

Pyetja 65

Si mund të përdoret paga për të tërhequr dhe mbajtur punonjës të kualifikuar?

- A) Duke ofruar mundësi trajnimi
- B) Duke ndarë punën midis punonjësve
- C) Duke rritur pagën në mënyrë konkurruese
- D) Duke krijuar një mjedis pune fleksibël

Pyetja 66

Cila është një mënyrë për të rritur motivimin e punonjësve përmes pjesëmarrjes?

- A) Shkurtimi i javës së punës
- B) Fleksibiliteti i orarit ditor
- C) Përfshirja në vendimmarrje
- D) Rotacioni i punëve

Pyetja 67

Cili element është i rëndësishëm për efektivitetin e skemave të pjesëmarrjes së punonjësve?

- A) Kushtet e përshtatshme të punës
- B) Shkalla e besimit reciprok
- C) Numri i orëve të punës
- D) Rritja e pagës

Pyetja 68

Cili aspekt përfshihet në ristrukturimin e punës për rritjen e motivimit?

- A) Ndryshimi i orarit të punës
- B) Zmadhimi dhe pasurimi i përmbajtjes së punëve
- C) Pjesëmarrja në vendimmarrje
- D) Ofrimi i shpërblimeve të veçanta

Pyetja 69

Cili variant i ndryshimit të orarit të punës synon reduktimin e energjisë së konsumuar dhe rritjen e kënaqësisë në punë?

- A) Fleksibiliteti i orarit ditor
- B) Puna me dy turne të njëpasnjëshme
- C) Shkurtimi i javës së punës
- D) Ndarja e punës

Pyetja 70

Cili është një avantazh i zbatimit të orarit fleksibël?

- A) Ulja e lodhjes
- B) Rritja e kontrollit të vazhdueshëm
- C) Rritja e moralit dhe produktivitetit
- D) Shmangia e aksidenteve

Pyetja 71

Cili disavantazh është i lidhur me punën me dy turne të njëpasnjëshme?

- A) Rritja e pagës
- B) Lodhia dhe ulja e cilësisë së shërbimit
- C) Rritja e fleksibilitetit
- D) Ulja e numrit të mungesave

Pyetja 72

Cili është qëllimi kryesor i menaxhimit të burimeve njerëzore?

- A) Përmirësimi i pajisjeve teknologjike
- B) Rritja e përfitimeve financiare
- C) Sigurimi i mirëqenies së punonjësve dhe maksimizimi i kontributit të tyre
- D) Reduktimi i shpenzimeve operative

Pyetja 73

Çfarë nënkupton termi “Menaxhim i burimeve njerëzore” në krahasim me “Menaxhimi i personelit”?

- A) Fokusimi vetëm në trajnime
- B) Punonjësit konsiderohen si një burim i rëndësishëm i kompanisë
- C) Ndryshimi i strukturës organizative
- D) Rritja e pagave

Pyetja 74

Cila është detyra kryesore e planifikimit të burimeve njerëzore?

- A) Të rrisë pagat e punonjësve
- B) Të identifikojë nevojat e ardhshme për personel dhe të përcaktojë strategjinë për përmbushjen e tyre
- C) Të përmirësojë teknologjinë e punës
- D) Të zvogëlojë orarin e punës

Pyetja 75

Çfarë përfshin rekrutimi i brendshëm?

- A) Përdorimi i agjencive publike të punësimit
- B) Gjetja e kandidatëve nga radhët e punonjësve të punësuar në organizatë
- C) Shpallja e vendeve të lira në gazetatat lokale
- D) Krijimi i marrëveshjeve me universitetet

Pyetja 76

Cili është qëllimi i seleksionimit paraprak (shoshitjes)?

- A) Të testojë aftësitë e kandidatëve
- B) Të verifikojë kualifikimet e kandidatëve
- C) Të eliminojë kandidatët që nuk i përmbushin kërkesat
- D) Të zhvillojë intervista formale

Pyetja 77

Cili tip testimi përqendrohet në aftësitë e kandidatëve për të plotësuar kërkesat e vendit të punës?

- A) Testet e aftësisë
- B) Testet e personalitetit
- C) Testet e performancës
- D) Testet e kualifikimit

Pyetja 78

Çfarë është procesi i kontrollit për kualifikimin?

- A) Bisedë formale me kandidatët
- B) Verifikimi i të dhënave të ofruara nga kandidatët për kualifikimin e tyre
- C) Ekzaminimi fizik i kandidatëve
- D) Marrja e vendimit për punësimin

Pyetja 79

Cili proces përfshin vendimin për marrjen në punë?

- A) Seleksionimi paraprak
- B) Intervistimi
- C) Ekzaminimi fizik
- D) Hartimi i kontratës së punës

Kapitulli 10. Kontrolli

Pyetja 1

Cili është qëllimi kryesor i funksionit të kontrollit në menaxhim?

- A) Të rrisë shpenzimet operative
- B) Të verifikojë dhe rregullojë aktivitetet organizative
- C) Të rritë numrin e punonjësve
- D) Të përmirësojë teknologjinë e kompanisë

Pyetja 2

Pse është e rëndësishme kryerja e funksionit të kontrollit në organizatat e biznesit?

- A) Sepse rrit përfitimet financiare
- B) Sepse parashikon me saktësi të ardhmen
- C) Sepse ndihmon në zbulimin e dobësive dhe gabimeve
- D) Sepse redukton numrin e punonjësve

Pyetja 3

Si ndihmon kontrolli në përgjigjen ndaj ndryshimeve në mjedisin e jashtëm të biznesit?

- A) Duke reduktuar shpenzimet operative
- B) Duke përmirësuar teknologjinë e brendshme
- C) Duke përgatitur organizatën për t'iu përgjigjur sfidave të mjedisit të jashtëm
- D) Duke rritur numrin e punonjësve

Pyetja 4

Pse është procesi i kontrollit i domosdoshëm për organizatat e mëdha dhe ndërkombëtare?

- A) Sepse redukton pagat e punonjësve
- B) Sepse ndihmon në verifikimin e operacioneve që realizohen
- C) Sepse përmirëson teknologjinë e brendshme
- D) Sepse rrit numrin e klientëve

Pyetja 5

Cila është një nga arsyet kryesore për kontrollin e vazhdueshëm?

- A) Për të reduktuar numrin e produkteve të prodhuara
- B) Për të zbuluar devijimet e vogla përpara se të rriten
- C) Për të rritur shpenzimet operative
- D) Për të përmirësuar teknologjinë

Pyetja 6

Çfarë përfshin kontrolli strategjik?

- A) Kontrollin e përditshëm të operacioneve
- B) Kontrollin e zbatimit të planeve taktike
- C) Kontrollin e planeve strategjike nga menaxherët e nivelit të lartë
- D) Kontrollin e inventarëve të përditshëm

Pyetja 7

Cili është funksioni kryesor i kontrollit taktik?

- A) Të kontrollojë operacionet e përditshme
- B) Të kontrollojë dhe zbatojë planet taktike
- C) Të kontrollojë dhe zgjidhë problemet strategjike
- D) Të kontrollojë performancën e punonjësve të nivelit të ulët

Pyetja 8

Kush është përgjegjës për kontrollin operacional?

- A) Menaxherët e nivelit të lartë
- B) Menaxherët e nivelit të mesëm
- C) Menaxherët e nivelit të ulët
- D) Presidenti i kompanisë

Pyetja 9

Sa shpesh kryhet kontrolli strategjik?

- A) Çdo ditë
- B) Çdo muaj
- C) Çdo javë
- D) Një herë në 3 apo 6 muaj

Pyetja 10

Cila nga këto nuk është një arsye për kryerjen e procesit të kontrollit?

- A) Për të zbuluar dobësitë e organizatës
- B) Për të gjetur shanse të reja për fitime
- C) Për të përmirësuar teknologjinë e brendshme
- D) Për të siguruar performancën e duhur të organizatës

Pyetja 11

Cili lloj kontrolli mbulon burimet që hyjnë në një organizatë biznesi nga mjedisi i jashtëm?

- A) Kontrolli i ndërmjetëm
- B) Kontrolli përfundimtar
- C) Kontrolli paraprak
- D) Kontrolli strategjik

Pyetja 12

Cili lloj kontrolli përfshin aktivitete si zgjedhja dhe seleksionimi i burimeve njerëzore?

- A) Kontrolli i ndërmjetëm
- B) Kontrolli paraprak
- C) Kontrolli përfundimtar
- D) Kontrolli taktik

Pyetja 13

Cili lloj kontrolli ka të bëjë me performancën e punonjësve në intervale të rregullta gjatë procesit të prodhimit?

- A) Kontrolli paraprak
- B) Kontrolli përfundimtar
- C) Kontrolli i ndërmjetëm
- D) Kontrolli operacional

Pyetja 14

Cili lloj kontrolli mbulon cilësinë dhe sasinë e produkteve të prodhuara pasi ka përfunduar ciklin e prodhimit?

- A) Kontrolli paraprak
- B) Kontrolli përfundimtar
- C) Kontrolli i ndërmjetëm
- D) Kontrolli strategjik

Pyetja 15

Cili nga këto nuk është një komponent i kontrollit paraprak?

- A) Kontrolli i burimeve fizike
- B) Kontrolli i burimeve njerëzore
- C) Kontrolli i informacionit
- D) Kontrolli i marketingut

Pyetja 16

Cili lloj kontrolli ofron të dhëna për të projektuar një plan efektiv për periudhat e ardhshme?

- A) Kontrolli paraprak
- B) Kontrolli përfundimtar
- C) Kontrolli i ndërmjetëm
- D) Kontrolli taktik

Pyetja 17

Cila është një nga arsyet kryesore për kontrollin financiar?

- A) Për të rritur pagat e punonjësve
- B) Për të siguruar që informacioni është i mjaftueshëm dhe cilësor
- C) Për të siguruar përdorimin efikas të burimeve financiare
- D) Për të përmirësuar teknologjinë e brendshme

Pyetja 18

Cili lloj kontrolli përfshin rishikimin periodik të burimeve financiare?

- A) Kontrolli paraprak
- B) Kontrolli përfundimtar
- C) Kontrolli i ndërmjetëm
- D) Kontrolli strategjik

Pyetja 19

Cili lloj kontrolli kontrollon cilësinë e rezervave dhe pajisjeve që hyjnë në procesin e transformimit?

- A) Kontrolli paraprak
- B) Kontrolli përfundimtar
- C) Kontrolli i ndërmjetëm
- D) Kontrolli strategjik

Pyetja 20

Cili lloj kontrolli ka për objekt të tij burimet fizike, njerëzore, financiare dhe informative?

- A) Kontrolli i ndërmjetëm
- B) Kontrolli përfundimtar
- C) Kontrolli paraprak
- D) Kontrolli operacional

Pyetja 21

Cila është faza e parë e procesit të kontrollit?

- A) Matja e performancës
- B) Vendosja e standardeve
- C) Krahasimi i performancës me standardet
- D) Vlerësimi dhe rregullimi i gjendjes

Pyetja 22

Cila nga alternativat e mëposhtme është një shembull i standardit të shprehur në njësi kohore?

- A) Vëllimi i shitjes për çdo shitës
- B) Sasia e prodhimit ditor të një punëtori
- C) Koha e shërbimit të një klienti në një fast-food jo më shumë se 5 minuta
- D) Fitimi i përmuajshëm i kompanisë

Pyetja 23

Në cilën fazë të procesit të kontrollit përcaktohet se si dhe sa shpesh do të matet performanca?

- A) Vendosja e standardeve
- B) Matja e performancës
- C) Krahasimi i performancës me standardet
- D) Vlerësimi dhe rregullimi i gjendjes

Pyetja 24

Çfarë veprimi duhet të ndërmerret kur devijimet nga standardet janë shumë të vogla ose të papërfillshme?

- A) Të lihen gjërat të pandryshueshme
- B) Korrigjimi i devijimeve
- C) Ndryshimi i standardeve
- D) Ndërhyrja e menjëhershme

Pyetja 25

Në cilën fazë menaxherët mund të vendosin për ndryshimin e standardeve?

- A) Vendosja e standardeve
- B) Matja e performancës
- C) Krahasimi i performancës me standardet
- D) Vlerësimi dhe rregullimi i gjendjes

Pyetja 26

Çfarë duhet të bëjnë menaxherët kur standardet janë duke u arritur me lehtësi?

- A) Të lihen gjërat të pandryshueshme
- B) Korrigjimi i devijimeve
- C) Ndryshimi i standardeve
- D) Ndërhyrja e menjëhershme

Pyetja 27

Cili veprim ndërmerret kur performanca është më e ulët se standardet e përcaktuara?

- A) Të lihen gjërat të pandryshueshme
- B) Korrigjimi i devijimeve
- C) Ndryshimi i standardeve
- D) Eliminimi i punonjësve të dobët

Pyetja 28

Në cilën fazë menaxherët mund të përdorin stimuj apo shpërblime për të motivuar punonjësit?

- A) Vendosja e standardeve
- B) Matja e performancës
- C) Krahasimi i performancës me standardet
- D) Vlerësimi dhe rregullimi i gjendjes

Pyetja 29

Kur standardet janë të shprehura në pikëpamje josasiore, procesi i krahasimit bëhet:

- A) Më i lehtë
- B) Më i vështirë
- C) Më i saktë
- D) Më i thjeshtë

Pyetja 30

Cila nga këto nuk është një fazë e procesit të kontrollit?

- A) Vendosja e standardeve
- B) Matja e performancës
- C) Krahasimi i performancës me standardet
- D) Planifikimi strategjik

Pyetja 31

Çfarë duhet të përshtatet me natyrën e punës dhe të organizimit për të pasur një sistem kontrolli efektiv?

- A) Planifikimi
- B) Sistemi i kontrollit
- C) Menaxhimi i burimeve njerëzore
- D) Strukturat organizative

Pyetja 32

Me kë duhet të harmonizohet kontrolli?

- A) Menaxhimin e burimeve njerëzore
- B) Procesin e prodhimit
- C) Planifikimin
- D) Marketingun

Pyetja 33

Duhet të jetë kostoefektiv:

- A) Burimet njerëzore
- B) Procesi i prodhimit
- C) Sistemi i kontrollit
- D) Planifikimi strategjik

Pyetja 34

Si duhet të jetë informacioni i dhënë nga sistemi i kontrollit?

- A) Objektiv dhe i detajuar
- B) Subjektiv dhe i përgjithshëm
- C) I thjeshtë dhe i pamjaftueshëm
- D) I pavërtetueshëm dhe i papërdorshëm

Pyetja 35

Cila është rëndësia e saktësisë së informacionit të kontrollit?

- A) Redukton koston e kontrollit
- B) Ndikon në mënyrë të pashmangshme në vendimet e marra
- C) E bën procesin më të shpejtë
- D) E eliminon nevojën për planifikim

Pyetja 36

Çfarë kupton termi "Just in time" në kontekstin e kontrollit?

- A) Kontrolli duhet të jetë në kohën e duhur
- B) Proceset e prodhimit duhet të jenë të shpejta
- C) Kontrolli duhet të jetë i përhershëm
- D) Planifikimi duhet të jetë fleksibël

Pyetja 37

Për çfarë duhet të jetë fleksibël sistemi i kontrollit?

- A) Për të përmbushur kërkesat e menaxhimit
- B) Për të përmbushur kërkesat e reja të mjedisit organizativ
- C) Për të ulur kostot e prodhimit
- D) Për të përmirësuar marketingun

Pyetja 38

Si duhet të jetë sistemi i kontrollit për t'u përdorur nga stafi?

- A) Kompleks dhe i ndërlikuar
- B) I kuptueshëm dhe i thjeshtë
- C) I shpejtë dhe i pashpjegueshëm
- D) I kushtueshëm dhe i ngurtë

Pyetja 39

Pse sistemi i kontrollit duhet të jetë i kuptueshëm?

- A) Për të rritur kostot e kontrollit
- B) Për të ulur motivimin e stafit
- C) Për t'ju përshtatur nivelit të kualifikimit të stafit
- D) Për të zvogëluar fleksibilitetin

Pyetja 40

Si ndikon një sistem kontrolli fleksibël në organizatë?

- A) E bën organizatën më pak të përshtatshme ndaj ndryshimeve
- B) E bën organizatën më të ngurtë
- C) E bën organizatën më të përgjegjshme ndaj ndryshimeve të mjedisit
- D) E bën organizatën më të ngadalshme në marrjen e vendimeve

Pyetja 41

Çfarë nxit rezistencën e punonjësve ndaj sistemit të kontrollit?

- A) Shkalla e arsyeshme e kontrollit
- B) Kontrolli i tepërt
- C) Pjesëmarrja e punonjësve në vendosjen e standardeve
- D) Shpërblimi i efikasitetit

Pyetja 42

Sistemet e reja të kontrollit mund të shkaktojnë pasiguri te punonjësit kur:

- A) Përdoren teknologji tradicionale
- B) Kanë kosto të larta
- C) Matin performancën në fusha të reja
- D) Janë shumë të thjeshta

Pyetja 43

Çfarë tregon kontrolli përveç devijimeve nga standardet?

- A) Koha e pushimeve të punonjësve
- B) Niveli i pagave të punonjësve
- C) Personat përgjegjës për gjendjen përkatëse
- D) Niveli i arsimit të punonjësve

Pyetja 44

Pse vendosja e standardeve pa pjesëmarrjen e punonjësve mund të jetë problematike?

- A) Rrit kostot e prodhimit
- B) Zvogëlon autonominë e menaxherëve
- C) I bën punonjësit të pakënaqur dhe kundërshtues
- D) Rrit efektivitetin e kontrollit

Pyetja 45

Çfarë duhet të shmangin menaxherët për të reduktuar rezistencën ndaj kontrollit?

- A) Kontrollin e performancës
- B) Shpërblimin e efikasitetit
- C) Shpërblimin e joeficiencës
- D) Vendosjen e standardeve

Pyetja 46

Cila është një mënyrë për të reduktuar rezistencën ndaj kontrollit?

- A) Përfshirja e punonjësve në procesin e kontrollit
- B) Rritja e nivelit të kontrollit
- C) Reduktimi i autonomisë së punonjësve
- D) Rritja e numrit të menaxherëve

Pyetja 47

Çfarë nënkupton menaxhimi me anë të objektivave?

- A) Vendosja e objektivave të arsyeshme dhe të matshme për punonjësit
- B) Shmangia e vendosjes së objektivave për punonjësit
- C) Rritja e autonomisë së menaxherëve
- D) Eliminimi i kontrolleve të performancës

Pyetja 48

Çfarë do të thotë fleksibiliteti i sistemit të kontrollit?

- A) Përshtatja e sistemit të kontrollit me ndryshimet dhe kërkesat e reja
- B) Eliminimi i sistemit të kontrollit
- C) Ulja e numrit të standardeve të performancës
- D) Rritja e rregullsisë së kontrolleve të performancës

Pyetja 49

Cili është një shkak kryesor për rezistencën e punonjësve ndaj kontrollit?

- A) Rritja e pagave të punonjësve
- B) Vendosja e standardeve me pjesëmarrjen e punonjësve
- C) Kontrolli i performancës në fusha të reja
- D) Shpërblimi i performancës së lartë

Pyetja 50

Çfarë duhet të ndërtojnë menaxherët për të reduktuar rezistencën ndaj kontrollit?

- A) Një sistem kontrolli të ngurtë
- B) Një sistem kontrolli efektiv
- C) Një sistem kontrolli të shtrenjtë
- D) Një sistem kontrolli të centralizuar

Pyetja 51

Çfarë paraqet pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve?

- A) Gjendjen e mjeteve dhe burimeve të kompanisë në një moment të caktuar kohe
- B) Aftësinë e kompanisë për të plotësuar detyrimet afatshkurtra
- C) Rezultatit financiar të kompanisë për një periudhë të caktuar kohe
- D) Niveli i qarkullimit të inventarit

Pyetja 52

Çfarë tregon bilanci i një kompanie?

- A) Të ardhurat dhe shpenzimet për një periudhë kohe
- B) Gjendjen e mjeteve dhe burimeve në një moment të caktuar kohe
- C) Aftësinë e kompanisë për të shlyer borxhet
- D) Efektivitetin e përdorimit të aktiveve

Pyetja 53

Çfarë tregon kapitali i pronarit në bilanc?

- A) Burimet materiale dhe monetare që zotëron kompania
- B) Pjesën e aktiveve të mbuluar nga detyrimet afatshkurtra dhe afatgjata
- C) Fitimin e realizuar nga shitjet
- D) Pjesën e aktiveve të mbuluar nga kapitali i vetë pronarit

Pyetja 54

Çfarë përfaqëson treguesi korrent?

- A) Aftësinë e kompanisë për të plotësuar detyrimet afatshkurtra ndaj kreditorëve
- B) Efektivitetin e përdorimit të aktiveve të kompanisë
- C) Masën në të cilën kompania përdor borxhet për financim
- D) Shlyerjen e kapitalit të vetë pronarit

Pyetja 55

Çfarë mat treguesi i shpejtë apo i provës acid?

- A) Aftësinë e kompanisë për të plotësuar detyrimet afatgjata
- B) Aftësinë e kompanisë për të plotësuar detyrimet afatshkurtra me paratë në arkë dhe llogaritë e arkëtueshme
- C) Niveli i borxheve të kompanisë
- D) Efektivitetin e përgjithshëm të menaxhimit

Pyetja 56

Çfarë mat treguesi i qarkullimit të inventarit?

- A) Aftësinë e kompanisë për të paguar borxhet afatgjata
- B) Aftësinë e kompanisë për të gjeneruar fitim nga investimet
- C) Efektivitetin e përdorimit të inventarit të kompanisë
- D) Shlyerjen e shitjeve neto

Pyetja 57

Kur konsiderohet i ulët treguesi i qarkullimit të inventarit?

- A) Kur inventari është tejkaluar mbi normën e domosdoshme
- B) Kur kompania ka një kapital të lartë të pronarit
- C) Kur kompania ka detyrime afatgjata të larta
- D) Kur shitjet neto janë më të ulëta se investimet

Pyetja 58

Çfarë tregon raporti i totalit të detyrimeve ndaj totalit të aktiveve?

- A) Aftësinë e kompanisë për të paguar borxhet afatshkurtra
- B) Masën në të cilën kompania përdor borxhet për të financuar
- C) Shlyerjen e kapitalit të vetë pronarit
- D) Efektivitetin e përdorimit të aktiveve

Pyetja 59

Çfarë preferojnë kreditorët në lidhje me raportin e borxhit?

- A) Raporte të ulta të borxhit
- B) Raporte të larta të borxhit
- C) Raporte të barabarta të borxhit dhe kapitalit të pronarit
- D) Raporte të larta të aktiveve korente

Pyetja 60

Çfarë tregon treguesi i shlyerjes së shitjeve?

- A) Efektivitetin e përgjithshëm të menaxhimit në gjenerimin e fitimit
- B) Aftësinë e kompanisë për të paguar borxhet afatgjata
- C) Efektivitetin e përdorimit të aktiveve
- D) Raportin e të ardhurave neto ndaj shitjeve neto

Pyetja 61

Çfarë tregon treguesi i shlyerjes së investimeve?

- A) Raportin e të ardhurave neto ndaj shitjeve neto
- B) Efektivitetin e përgjithshëm të menaxhimit në gjenerimin e fitimit nga investimet
- C) Aftësinë e kompanisë për të paguar borxhet afatshkurtra
- D) Efektivitetin e përdorimit të inventarit

Pyetja 62

Kur duhet të ndërmarrin veprime korigjuese menaxherët?

- A) Kur kompania ka një nivel të lartë të likuiditetit
- B) Kur treguesi i qarkullimit të inventarit është i lartë
- C) Kur organizata nuk i plotëson standardet e performancës si ROI
- D) Kur raporti i borxhit është nën 50%

Pyetja 63

Përse janë të rëndësishme kontrollet financiare për menaxherët?

- A) Për të llogaritur borxhet afatgjata
- B) Për të vlerësuar efikasitetin dhe efektivitetin e organizatave të tyre
- C) Për të ulur numrin e punonjësve
- D) Për të rritur kapitalin e pronarit

Pyetja 64

Cili është treguesi më i përdorshëm për zgjidhjet afatshkurtra?

- A) Treguesi i qarkullimit të inventarit
- B) Treguesi i borxhit
- C) Treguesi i fitimit
- D) Treguesi korrent

Pyetja 65

Cili nga treguesit pasqyron aftësinë e kompanisë për të plotësuar detyrimet afatshkurtra me paratë në arkë dhe llogarinë e arkëtueshme?

- A) Treguesi korrent
- B) Treguesi i qarkullimit të inventarit
- C) Treguesi i provës acid
- D) Treguesi i borxhit

Pyetja 66

Nëse detyrimet korente ose afatshkurtra rriten më shpejt se aktivet korente apo afatshkurtra, raporti korent do të:

- A) Rritet
- B) Ulet
- C) Mbetet i njëjtë
- D) Nuk ndikohet

Pyetja 67

Cili tregues përdoret për të matur efektivitetin e përgjithshëm të menaxhimit në gjenerimin e fitimit nga investimet e kryera për aktivet e kompanisë?

- A) Treguesi i shlyerjes së investimeve
- B) Treguesi i shlyerjes së shitjeve
- C) Treguesi i qarkullimit të inventarit
- D) Treguesi i provës acid

Pyetja 68

Bilanci mbështetet në cili ekuacion?

- A) $\text{Aktivet} = \text{Pasivet} + \text{Kapitali i vet}$
- B) $\text{Aktivet} = \text{Pasivet} - \text{Kapitali i vet}$
- C) $\text{Aktivet} + \text{Pasivet} = \text{Kapitali i vet}$
- D) $\text{Aktivet} - \text{Pasivet} = \text{Kapitali i vet}$

Pyetja 69

Cili tregues llogaritet si raport i të ardhurave neto ndaj shitjeve neto?

- A) Treguesi i borxhit
- B) Treguesi i likuiditetit
- C) Treguesi i shlyerjes së shitjeve
- D) Treguesi i qarkullimit të inventarit

Pyetja 70

Niveli i treguesit të borxhit mbi 100% tregon se kompania:

- A) Mbështet financime më tepër në borxhet sesa në kapitalin e vetë pronarit
- B) Mbështet financime më tepër në kapitalin e vetë pronarit
- C) Ka bilanc të ekuilibruar
- D) Ka fitime të larta

Kapitulli 11. Firmat dhe Sipërmarrja

Pyetja 1

Çfarë është një firmë?

- A) Një njësi që prodhon vetëm shërbime
- B) Një njësi që organizon dhe koordinon faktorët e prodhimit
- C) Një njësi që vetëm shet produkte
- D) Një njësi që vetëm importon mallra

Pyetja 2

Cili është objektivi kryesor i një firme?

- A) Rritja e pjesëmarrjes në treg
- B) Ruajtja e mjedisit
- C) Krijimi i një imazhi të mirë në fushën e punësimit
- D) Maksimizimi i fitimit

Pyetja 3

Çfarë janë të ardhurat totale?

- A) Shpenzimet për prodhimin e mallrave dhe shërbimeve
- B) Diferenca ndërmjet të ardhurave dhe kostove totale
- C) Të gjitha të ardhurat nga shitja e mallrave dhe shërbimeve
- D) Të gjitha investimet në firmë

Pyetja 4

Çfarë janë kostot totale?

- A) Të gjitha të ardhurat nga shitjet
- B) Të gjitha shpenzimet për prodhimin dhe shitjen e mallrave dhe shërbimeve
- C) Diferenca ndërmjet të ardhurave dhe fitimit
- D) Shpenzimet për marketingun

Pyetja 5

Çfarë janë ekonomizimet e shkallës?

- A) Ulja e kostos për njësi prodhimi kur sasia e prodhimit rritet
- B) Rritja e kostos për njësi prodhimi kur sasia e prodhimit rritet
- C) Ulja e shpenzimeve për marketing
- D) Rritja e kostos për ruajtjen e mjedisit

Pyetja 6

Cila nga arsyet e mëposhtme është një përfitim organizativ i firmave?

- A) Kostot e larta të transaksioneve
- B) Rritja e pagave të punonjësve
- C) Ndarja e punës dhe specializimi
- D) Shpenzimet për reklama

Pyetja 7

Çfarë ndodh kur firmat bëhen shumë të mëdha dhe rrisin shkallën e diversitetit të produkteve?

- A) Kostot e përgjithshme për njësi prodhimi ulen
- B) Kostot e përgjithshme për njësi prodhimi rriten
- C) Firma bëhet më efiçente
- D) Firma fiton më shumë prestigj

Pyetja 8

Çfarë quhen organizatat që nuk kanë fitimin si synim kryesor?

- A) Firma të mëdha
- B) Firma me diversitet produktesh
- C) Organizata jofitimprurëse
- D) Firma teknologjike

Pyetja 9

Cila nga këto forma organizimi e firmës është pronë e një personi të vetëm dhe drejtohet vetëm prej tij?

- A) Korporata
- B) Firma individuale
- C) Firma me ortakë
- D) Shoqëri aksionare

Pyetja 10

Cili është një avantazh i firmës individuale?

- A) Lehtësia për t'u futur dhe për të dalë nga biznesi
- B) Përgjegjësia e pakufizuar financiare
- C) Kostot e larta të organizimit

D) Burime të kufizuara financiare për investime

Pyetja 11

Cili është një disavantazh i firmës individuale?

- A) Fitimi tatimohet dy herë
- B) Përgjegjësia e pakufizuar financiare
- C) Struktura komplekse drejtuese
- D) Fleksibiliteti i ulët në përshtatje ndaj kërkesave të konsumatorëve

Pyetja 12

Krahasuar me llojet e tjera të firmave, firmat individuale kanë një avantazh të veçantë në:

- A) Burime të mëdha financiare
- B) Struktura komplekse drejtuese
- C) Vendimmarrje të shpejtë dhe fleksibile
- D) Jetëgjatësia e gjatë e firmës

Pyetja 13

Pse firmat individuale kanë burime të kufizuara financimi për investime?

- A) Sepse kanë shumë pronarë
- B) Sepse kanë përgjegjësi të kufizuar financiare
- C) Sepse fitimi tatimohet dy herë
- D) Sepse burimet financiare kufizohen nga mundësitë financiare të pronarit

Pyetja 14

Cili nga këto është një avantazh i strukturës drejtuese të firmës individuale?

- A) Ndërlikimi i vendimmarrjes
- B) Kostoja e lartë e organizimit
- C) Kënaqësia personale në drejtimin e firmës
- D) Pjesëmarrja e shumë ortakëve në drejtim

Pyetja 15

Cili është një disavantazh i firmës individuale?

- A) Varet nga jetëgjatësia ose vullneti i pronarit
- B) Ka shumë pronarë
- C) Është e vështirë për t'u organizuar

D) Fitimi tatimohet dy herë

Pyetja 16

Cila nga këto karakteristika është tipike për firmat me ortakë?

- A) Të gjitha vendimet merren nga një person i vetëm
- B) Lehtësia për t'u futur dhe për të dalë nga biznesi
- C) Fitimi taksohet dy herë
- D) Përgjegjësia e ortakëve është e pakufizuar

Pyetja 17

Cila është një avantazh i firmave me ortakë në krahasim me firmat individuale?

- A) Shkalla më e lartë e kënaqësisë personale në drejtimin e firmës
- B) Mundësia më e madhe për të marrë kredi nga banka
- C) Kostot më të ulëta të organizimit
- D) Vendimet merren më shpejt

Pyetja 18

Cili nga këto është një disavantazh i firmave me ortakë?

- A) Fitimi taksohet dy herë
- B) Vendimet merren vetëm nga një ortak
- C) Tërheqja e një ortaku mund të shkaktojë shpërbërjen e firmës
- D) Aftësitë drejtuese dhe organizuese janë më të ulëta

Pyetja 19

Cili është një nga rreziqet e përgjegjësisë së pakufizuar në firmat me ortakë?

- A) Shkalla e lartë e kënaqësisë personale
- B) Një ortak mund të mbajë përgjegjësi për gabimet e ortakëve të tjerë
- C) Specializimi i ortakëve në funksione të caktuara
- D) Vendimet merren me pëlqimin e shumicës

Pyetja 20

Cila nga këto është një arsye për shpërbërjen e firmës me ortakë?

- A) Kufizueshmëria e numrit të ortakëve
- B) Futja e një ortaku të ri
- C) Vendosja e kapitalit nga ortakët

D) Organizimi i thjeshtë i firmës

Pyetja 21

Cili nga këto është një faktor që kufizon mundësitë financiare të firmave me ortakë?

- A) Shkalla e lartë e kënaqësisë personale
- B) Kufizimi i numrit të ortakëve
- C) Përgjegjësia e kufizuar financiare
- D) Lehtësia për të dalë nga biznesi

Pyetja 22

Çfarë është një aksion në kontekstin e korporatave?

- A) Një titull pronësie ndaj një pjese të pasurisë së shoqërisë
- B) Një dokument që vërteton detyrimin ndaj korporatës
- C) Një marrëveshje për furnizimin me lëndë të parë
- D) Një kontratë për shitjen e produkteve të korporatës

Pyetja 23

Çfarë formë fitimi marrin aksionerët nga një korporatë?

- A) Pagë
- B) Komision
- C) Divident
- D) Bonuse

Pyetja 24

Cili është një avantazh i korporatave në krahasim me format e tjera të organizimit të biznesit?

- A) Tatimi i njëfishtë mbi të ardhurat
- B) Përgjegjësia e kufizuar për aksionerët
- C) Struktura e thjeshtë organizative
- D) Të ardhurat e pa tatueshme

Pyetja 25

Cili nga këto është një disavantazh i korporatave?

- A) Mungesa e mundësisë për të marrë kredi
- B) Tatimi i dyfishtë mbi të ardhurat
- C) Përgjegjësia e pakufizuar financiare për aksionerët

D) Mungesa e mundësisë për të shitur aksionet

Pyetja 26

Si mundet një korporatë të shmangë tatimin e dyfishtë mbi të ardhurat?

- A) Duke mos shpërndarë dividendë dhe duke riinvestuar fitimet
- B) Duke shpërndarë të gjithë fitimin në formë dividenti
- C) Duke ulur pagat e punonjësve
- D) Duke rritur çmimet e produkteve

Pyetja 27

Çfarë ndodh kur një aksion shitet në bursë me një çmim më të ulët se vlera nominale?

- A) Realizohet fitim nga kapitali
- B) Realizohet humbje nga kapitali
- C) Nuk ndodh asgjë
- D) Rritet vlera nominale e aksionit

Pyetja 28

Cila është struktura e organizimit në një korporatë të madhe?

- A) Të gjitha vendimet merren nga presidenti
- B) Aksionerët vendosin për çështjet kryesore
- C) Mbledhja e përgjithshme e aksionerëve zgjedh bordin e drejtorëve
- D) Bordi i drejtorëve zgjedh presidentin dhe nuk ka drejtorë ekzekutivë

Pyetja 29

Cili është roli i drejtorëve ekzekutiv në një korporatë?

- A) Të vendosin për emetimin e aksioneve
- B) Të drejtojnë sektorë të veçantë si prodhimi, marketingu, financat etj.
- C) Të zgjedhin aksionerët
- D) Të vendosin për shpërndarjen e dividendëve

Pyetja 30

Cila nga këto forma të organizimit të firmës është më e thjeshtë për t'u krijuar dhe drejtuar?

- A) Firma individuale
- B) Firma me ortakë
- C) Korporata

D) Shoqëri anonime

Pyetja 31

Cili është një disavantazh i firmave me ortakë krahasuar me korporatat?

- A) Të ardhurat tatimohen dy herë
- B) Vështirësia në tërheqjen e kapitalit
- C) Kontrolli i thjeshtë mbi vendimet e biznesit
- D) Përgjegjësia e pakufizuar financiare

Pyetja 32

Cila formë organizimi është më e përshtatshme për bizneset që kërkojnë kapital të madh për të operuar dhe zgjeruar?

- A) Firma individuale
- B) Firma me ortakë
- C) Korporata
- D) Shoqëri tregtare

Pyetja 33

Cili lloj aksioni i jep pronarit të tij të drejtën të jetë bashkëpronar i korporatës dhe të votojë në mbledhjen e përgjithshme?

- A) Aksion i zakonshëm
- B) Aksion preferencial
- C) Aksion i konvertueshëm
- D) Obligacion

Pyetja 34

Cili lloj aksioni është më i ngjashëm me obligacionet për shkak të normës fikse të interesit?

- A) Aksion i zakonshëm
- B) Aksion preferencial
- C) Aksion i konvertueshëm
- D) Aksion i përhershëm

Pyetja 35

Cila nga këto është një burim i brendshëm financiar për korporatat?

- A) Shitja e obligacioneve
- B) Emetimi i aksioneve

- C) Marrja e kredive bankare
- D) Rifutja e fitimit në biznes

Pyetja 36

Në rast falimentimi të korporatës, cilët aksionerë marrin të parët pagesat e interesit?

- A) Mbajtësit e aksioneve të zakonshme
- B) Mbajtësit e aksioneve të preferuara
- C) Mbajtësit e obligacioneve
- D) Të gjithë marrin pagesat në të njëjtën kohë

Pyetja 37

Cila nga këto forma të financimit lejon rinvestimin e fitimit për të eliminuar tatimin e dyfishtë?

- A) Shitja e obligacioneve
- B) Emetimi i aksioneve
- C) Marrja e kredive bankare
- D) Rifutja e fitimit në biznes

Pyetja 38

Cili nga këto bashkime ndodh kur dy ose më shumë firma që realizojnë stadi të ndryshme të procesit të prodhimit bashkohen?

- A) Bashkimi horizontal
- B) Konglomerat
- C) Bashkimi vertikal
- D) Bashkimi diagonal

Pyetja 39

Cili lloj bashkimi ndodh kur dy ose më shumë firma që prodhojnë të njëjtin produkt ose shërbim bashkohen?

- A) Bashkimi horizontal
- B) Konglomerat
- C) Bashkimi vertikal
- D) Bashkimi i kontraktuar

Pyetja 40

Cili lloj bashkimi përfshin firma me aktivitete që nuk lidhen drejtpërdrejt me njëri-tjetrin?

- A) Bashkimi horizontal

- B) Konglomerat
- C) Bashkimi vertikal
- D) Bashkimi strategjik

Pyetja 41

Cili nga këto bashkime mund të ndihmojë në kontrollin e furnizimit dhe shpërndarjes së materialeve?

- A) Bashkimi vertikal
- B) Bashkimi horizontal
- C) Konglomerat
- D) Bashkimi strategjik

Pyetja 42

Cili nga këto bashkime mund të ndihmojë firmat të rrisin pjesën e tyre të tregut për një produkt të caktuar?

- A) Bashkimi vertikal
- B) Bashkimi horizontal
- C) Konglomerat
- D) Bashkimi i shpërndarë

Pyetja 43

Një dokument gjithëpërfshirës që ndihmon sipërmarrësin të analizojë tregun dhe të planifikojë strategjinë e biznesit është një:

- A) Deklaratë misioni
- B) Plan biznesi
- C) Strategji marketingu
- D) Skanim i mjedisit

Pyetja 44

Planet e biznesit për start-up dhe bizneset ekzistuese janë të ngjashme; megjithatë,

- A) Fokusi ndryshon pak
- B) Plani për një biznes ekzistues nuk ka përmbledhje ekzekutive
- C) Plani për një start-up nuk ka përmbledhje ekzekutive
- D) Plani për një biznes ekzistues nuk ka nevojë për një seksion mbi vendndodhjen sepse biznesi tashmë ka marrë me qira ose ka blerë një vend

Pyetja 45

Një përmbledhje dyfaqëshe e fakteve më të rëndësishme në planin e biznesit njihet si:

- A) Marrëveshje ekskluzive
- B) Studim mjedisi
- C) Përmbledhje ekzekutive
- D) Operacioni i përgjithshëm i biznesit

Pyetja 46

Një shpjegim i shkurtër dhe mirëpërcaktuar i qëllimit të biznesit dhe filozofisë së menaxhimit njihet si:

- A) Përmbledhje ekzekutive
- B) Plan biznesi
- C) Studim i industrisë
- D) Deklaratë misioni

Pyetja 47

Ndryshimet në tendencat demografike dhe një rritje në numrin e grave që punojnë jashtë shtëpisë janë shembuj të

- A) Tendencave kombëtare
- B) Tendencave të industrisë
- C) Tendencave legjislativë
- D) Tendencave ekonomike

Pyetja 48

Trendi më i rëndësishëm demografik në vendet e zhvilluara është

- A) Fakti që ka më shumë gra se burra
- B) Plakja e popullsisë
- C) Numri i madh i adoleshentëve
- D) Numri i madh i foshnjave të lindura çdo vit

Pyetja 49

Ndryshimet demografike, ndryshimet në stilin e jetës dhe tendencat legjislativë janë shembuj të

- A) Tendencave kombëtare
- B) Tendencave të industrisë
- C) Tendencave lokale
- D) Fakteve të përfshira në deklaratën e misionit

Pyetja 50

Kostot për të blerë produkte nga furnizuesit dhe kostot e pagave për të kryer një shërbim njihen si

- A) Kërkesë elastike
- B) Kosto direkte
- C) Kërkesë joelastike
- D) Kosto indirekte

Pyetja 51

Ndarja e konsumatorëve në grupe me nevoja të njëjta ose të ngjashme, njihet si:

- A) Përcaktimi i avantazhit konkurrues
- B) Diferencimi i kompanisë
- C) Segmentimi i tregut
- D) Një objektiv marketingu

Pyetja 52

Nëse klientët grupohen sipas kodit postar, kjo është një shembull i:

- A) Segmentimit gjeografik
- B) Segmentimit demografik
- C) Segmentimit psikografik
- D) Segmentimit të përfitimeve

Pyetja 53

Nëse klientët grupohen sipas moshës, gjinisë, të ardhurave, racës, etj., ky është një shembull i:

- A) Segmentimit gjeografik
- B) Segmentimit të përfitimeve
- C) Segmentimit psikografik
- D) Segmentimit demografik

Pyetja 54

Nëse klientët grupohen bazuar në arsyet e tyre të blerjes së një produkti, kjo njihet si:

- A) Segmentimi gjeografik
- B) Segmentimi i përfitimeve
- C) Segmentimi psikografik
- D) Segmentimi demografik

Pyetja 55

Nëse adoleshentët që blejnë këpucë tenisi grupohen në ata që i blejnë për status dhe ata që i blejnë për komoditet dhe mbështetje, kjo është një shembull i:

- A) Segmentimit gjeografik
- B) Segmentimit demografik
- C) Segmentimit psikografik
- D) Segmentimit të përfitimeve

Pyetja 56

Nëse një kompani identifikon një grup të vogël të klientëve por që realizojnë një pjesë të madhe të të gjitha shitjeve të kompanisë, kjo njihet si:

- A) Segmentimi gjeografik
- B) Segmentimi i shfrytëzimit të shërbimeve
- C) Segmentimi i përfitimeve
- D) Segmentimi psikografik

Pyetja 57

Grupimi i klientëve bazuar në stilin e jetës njihet si:

- A) Segmentimi gjeografik
- B) Segmentimi psikografik
- C) Segmentimi i shfrytëzimit të shërbimeve
- D) Segmentimi i përfitimeve

Pyetja 58

Qëndrueshmëria është e nevojshme për suksesin e biznesit dhe kjo do të thotë që një avantazh konkurrues duhet të jetë:

- A) I qëndrueshëm
- B) Përfaqësues për të gjithë
- C) I fokusuar në produkt
- D) I bazuar në çmim

Pyetja 59

Një avantazh konkurrues duhet të jetë i qëndrueshëm. Kjo do të thotë se ai:

- A) Është i fokusuar në produkt
- B) Është përfaqësues për të gjithë
- C) Nuk kopjohet lehtë
- D) Është i bazuar në çmim

Pyetja 60

Konsumatorët nuk blejnë thjesht produkte dhe shërbime, por në vend të saj ata blejnë:

- A) Avantazhe konkurruese
- B) Segmentim tregu
- C) Përfitime të ofruara nga produkti/shërbimi
- D) Produkte të qëndrueshme

Pyetja 61

Nëse një sipërmarrës përshkruan tregun e tij synuar si "të gjitha gratë mbi moshën 18 vjeç,"

- A) Ai ka për të pasur një vëllim të madh të shitjeve
- B) Ai nuk ka përcaktuar qartë tregun e synuar
- C) Ai po përdor segmentimin e përfitimeve
- D) Ai po përdor segmentimin psikografik

Pyetja 62

Konkurrenca për një restorant italian në zonën tregtare do të përfshinte:

- A) Vetëm restorantet italiane të tjera në zonën tregtare
- B) Vetëm restorantet shumë afër me restorantin italian
- C) Të gjitha restorantet përveç restoranteve fast-food
- D) Të gjitha restorantet e tjera në zonën tregtare

Pyetja 63

Cili nga elementët e mëposhtëm është një formë e marketingut të drejtpërdrejtë?

- A) Katalogët e porosisë me postë
- B) Reklamimi
- C) Publiciteti
- D) Marrëdhëniet publike

Pyetja 64

Një mesazh jo personal i drejtuar në një numër të madh njerëzish quhet:

- A) Marketing i drejtpërdrejtë
- B) Reklamim
- C) Promocion i shitjeve
- D) Marrëdhëniet publike

Pyetja 65

Aktivitetet e marketingut që ofrojnë vlerë shtesë ose stimul për forcat e shitjes, shpërndarësit, ose konsumatorin përfundimtar quhen:

- A) Marketing i drejtpërdrejtë
- B) Reklamim
- C) Promocion i shitjeve
- D) Marrëdhëniet publike

Pyetja 66

Informacioni i kompanisë i paraqitur si lajm në radio, televizion, ose në gazeta quhet:

- A) Promocion i shitjeve
- B) Marketing i drejtpërdrejtë
- C) Marrëdhëniet publike
- D) Publicitet

Pyetja 67

Aktivitetet komunitare të një kompanie të projektuara për të krijuar përshtypje të favorshme me publikun quhen:

- A) Promocion i shitjeve
- B) Reklamim
- C) Marrëdhëniet publike
- D) Publicitet

Pyetja 68

Kombinimi i marketingut të drejtpërdrejtë, promocionit të shitjeve, publicitetit dhe marrëdhënieve publike quhet:

- A) Shitje miks
- B) Marketingu miks
- C) Promocioni miks
- D) Reklama miks

Pyetja 69

Nëse një kompani përdor metodën e buxhetimit sipas objektivave për reklamim, ajo do të:

- A) paguajë të gjitha faturat e tjera dhe pastaj të reklamojë nëse janë të disponueshme paratë.
- B) përcaktojë qëllimet e reklamimit dhe pastaj do të vlerësojë se sa reklamë do të nevojitet për të arritur qëllimet
- C) reklamojë në të njëjtin nivel si konkurrentët.

D) buxhetojë të njëjtën shumë parash çdo vit.

Pyetja 70

Nëse një sipërmarrës punëson një shitës, tipi i personit që punësohet si shitës duhet të varet nga:

- A) produkti ose shërbimi i shitur dhe gjatësia e ciklit të shitjeve.
- B) personaliteti i sipërmarrësit.
- C) shuma e parave që sipërmarrësi ka për pagat.
- D) fakti nëse shitësi ka llogari klientësh ekzistues.

Pyetja 71

Nëse një sipërmarrës punëson dikë për të ndihmuar klientët që vijnë në biznes, ose ata që telefonojnë në biznes, ky punonjës është një:

- A) menaxher i llogarive.
- B) mbikëqyrës i shitjeve
- C) telemarketues.
- D) shitës i brendshëm

Pyetja 72

Dy llojet kryesore të promocionit të shitjeve janë:

- A) publiciteti dhe marrëdhëniet me publikun.
- B) shitjet dhe marketingu i drejtpërdrejtë.
- C) mostrat dhe rimbursimet.
- D) të orientuara drejt konsumatorit dhe të orientuara drejt tregëtisë.

Pyetja 73

Promocionet si mostrat, rimbursimet dhe kuponat janë lloje të:

- A) promociioneve të orientuara drejt tregëtisë.
- B) marrëdhënieve me publikun.
- C) promociioneve të orientuara drejt konsumatorit.
- D) marketingu i drejtpërdrejtë.

Pyetja 74

Promocionet e përdorura nga shitësit me pakicë për të inkurajuar konsumatorët që të bëjnë blerje në një dyqan të caktuar njihen si:

- A) promociione të orientuara drejt konsumatorit.

- B) promocione të orientuara drejt tregëtisë.
- C) marrëdhëniet me publikun.
- D) marketingu i drejtpërdrejtë.

Pyetja 75

Promocionet të hartuara për të inkurajuar shpërndarësit dhe shitësit me pakicë për të mbajtur një produkt ose për të bërë përpjekje shtesë për të shitur një produkt njihen si:

- A) marrëdhëniet me publikun.
- B) promocione të orientuara drejt tregëtisë.
- C) promocione të orientuara drejt konsumatorit.
- D) marketingu i drejtpërdrejtë.

Pyetja 76

Informuese, bindëse dhe kujtuese janë tre lloje të:

- A) promovimit.
- B) reklamimit.
- C) kuponave.
- D) mediave.

Pyetja 77

Reklama që shpjegon produktet dhe shërbimet e kompanisë dhe është e dobishme në ndërtimin e klientelës fillestare është:

- A) reklamim informues.
- B) reklamim bindës.
- C) reklamim përkujtues.
- D) reklamim mirëmbajtjeje.

Pyetja 78

Reklama që është dizajnuar për të bindur klientin që kompania e re është më e mirë se konkurenca është:

- A) reklamim informues.
- B) reklamim përkujtues.
- C) reklamim bindës.
- D) reklamim mirëmbajtjeje.

Pyetja 79

Reklama e përdorur për të mbajtur një ndërgjegjësim për kompaninë është:

- A) reklamim informues.
- B) reklamim bindës.
- C) reklamim përkujtues
- D) reklamim selektiv.

Pyetja 80

Mediat si gazetat, revistat dhe fletushkat janë të njohura si:

- A) media të shtypura.
- B) panele posterash.
- C) media të transmetuara.
- D) fletë të verdha.

Pyetja 81

Kur zgjedh median, sipërmarrësi duhet të zgjedhë atë që do të:

- A) arrijë numrin më të madh të njerëzve.
- B) jetë më e lirë.
- C) arrijë një numër të madh njerëzish në tregun e synuar pa shpenzuar paratë e reklamës për ata që nuk janë në tregun e synuar.
- D) arrijë një numër të vogël njerëzish për një kosto të arsyeshme.

Pyetja 82

Numri i njerëzve që do të shohin ose dëgjojnë një reklamë i referohet _____ të mediumit.

- A) frekuencës
- B) shpërndarjes
- C) selektivitetit
- D) arritjes

Pyetja 83

Numri i njerëzve që marrin një gazetë ose revistë njihet si:

- A) shpërndarje.
- B) qarkullim.
- C) frekuencë.
- D) publicitet.

Pyetja 84

Numri i herëve që një klient sheh ose dëgjon një reklamë quhet:

- A) shtrirje.
- B) selektivitet.
- C) dorëzim.
- D) frekuencë.

Pyetja 85

Qëllimi i marrëdhënieve me publikun është të:

- A) krijojë ndërgjegjësime për kompaninë.
- B) krijojë një përshtypje të favorshme të publiku.
- C) rrisë shitjet.
- D) të zvogëlojë stokun sezonal.

Pyetja 86

Çfarë janë kanalet marketing?

- A) Sisteme të organizuara që ndihmojnë lëvizjen fizike dhe kalimin e pronësisë së të mirave nga prodhuesi tek konsumatori
- B) Sisteme të shpërndarjes së mallrave vetëm brenda një vendi
- C) Sisteme vetëm për shpërndarjen e informacionit marketing
- D) Sisteme të organizimit të eventeve promociionale

Pyetja 87

Pse janë të rëndësishme kanalet marketing?

- A) Sepse prodhuesit prodhojnë në sasi të vogla
- B) Sepse prodhuesit nuk janë të interesuar për konsumatorët
- C) Sepse prodhuesit prodhojnë në sasi të mëdha ndërsa konsumatorët blejnë në sasi të vogla
- D) Sepse konsumatorët janë gjithmonë të pranishëm në fabrikat e prodhuesve

Pyetja 88

Çfarë është një shitës me shumicë?

- A) Një ndërmjetës që shet produkte direkt tek konsumatorët
- B) Një ndërmjetës që ble produktet nga prodhuesit dhe i shet ato tek shitësit me pakicë ose konsumatorët finalë
- C) Një ndërmjetës që vetëm ofron informacion për produktet
- D) Një ndërmjetës që prodhon produkte

Pyetja 89

Cili është funksioni kryesor i klasifikimit në kanalet marketing?

- A) Ndarja e produkteve në kategori homogjene
- B) Reklama e produkteve
- C) Transporti i produkteve
- D) Paketimi i produkteve

Pyetja 90

Çfarë është grupimi në kanalet marketing?

- A) Ndarja e produkteve në kategori homogjene
- B) Kombinimi i produkteve nga shumë prodhues për të ofruar një paketë të përshtatshme për klientët
- C) Grumbullimi i prodhimeve në sasi të vogla
- D) Transportimi i produkteve tek konsumatorët finalë

Pyetja 91

Cili është avantazhi kryesor i shitjes direkte nga prodhuesi tek konsumatori?

- A) Shpenzime më të ulëta për reklama
- B) Kohë më e gjatë për të shitur produktet
- C) Zvogëlimi i mundësisë së gabimeve në blerje
- D) Më shumë ndërmjetës për të kontaktuar

Pyetja 92

Cili nga këta nuk është një ndërmjetës marketing?

- A) Shitës me shumicë
- B) Shitës me pakicë
- C) Agjent
- D) Prodhues

Pyetja 93

Çfarë është një agjent në kanalet marketing?

- A) Një ndërmjetës që prodhon produkte
- B) Një ndërmjetës që blen dhe shet produkte
- C) Një ndërmjetës që vepron si krah shitjeje për prodhuesit pa e blerë produktin
- D) Një ndërmjetës që bën transportin e produkteve

Pyetja 94

Cili është avantazhi kryesor i përdorimit të ndërmjetësve marketing?

- A) Ulja e kostove për reklama
- B) Përdorimi i më shumë agjentëve
- C) Rritja e numrit të transaksioneve
- D) Shkurtimi i numrit të kontakteve të nevojshme për të realizuar shitjen

Pyetja 95

Cili është avantazhi kryesor i shitjes me shumicë për prodhuesit?

- A) Ulja e sasisë së prodhimit
- B) Rritja e numrit të produkteve të grumbulluara
- C) Sigurimi i informacionit për sjelljen e konkurrentëve
- D) Transportimi i produkteve tek konsumatorët finalë

Pyetja 96

Çfarë është shitja me pakicë?

- A) Shitja e produkteve tek ndërmjetësit marketing
- B) Shitja e produkteve direkt tek konsumatorët
- C) Prodhimi i produkteve
- D) Transportimi i produkteve nga prodhuesi tek shitësit me shumicë

Pyetja 97

Cili është funksioni kryesor i agjentëve në kanalet marketing?

- A) Të blejnë dhe të shesin produktet
- B) Të sigurojnë informacion për porositë dhe të caktojnë shpërndarjen
- C) Të prodhojnë produkte të reja
- D) Të reklamojnë produktet

Pyetja 98

Çfarë është shitja me shumicë me funksione të plota?

- A) Shitësit që sigurojnë një asortiment të plotë të shërbimeve për shitësit me pakicë dhe blerësit industrialë
- B) Shitësit që sigurojnë vetëm transportin e produkteve
- C) Shitësit që sigurojnë vetëm magazinimin e produkteve
- D) Shitësit që sigurojnë vetëm informacion për produktet

Pyetja 99

Cili është roli kryesor i shitësve me shumicë për shitësit me pakicë?

- A) Prodhimi i produkteve
- B) Reklama e produkteve
- C) Sigurimi i një game të gjerë produktesh të grumbulluar nga një numër i madh prodhuesish
- D) Paketimi i produkteve

Pyetja 100

Çdo biznes përballet me dy lloje rreziqesh:

- A) tregtare dhe konsumatore
- B) tregtare dhe industriale
- C) të kontrollueshme dhe pa kontrollueshme
- D) marketing dhe shpërndarje

Pyetja 101

Një shembull i një risku të kontrollueshëm është:

- A) një konkurrent i ri që lokalizohet pranë.
- B) një ekonomi me recesion.
- C) ndryshime në teknologji.
- D) një zjarr

Pyetja 102

Cili nga opsionet vijues është një risk i pa kontrollueshëm?

- A) Zjarr
- B) Vandalizëm
- C) Një luftë për çmim nga konkurrentët
- D) Të gjitha opsionet e mësipërme

Pyetja 103

Qëllimi në identifikimin e rreziqeve të pa kontrollueshme është:

- A) të kuptosh rrezikun e lartë të sipërmarrjes.
- B) të vendosësh nëse vërtet dëshiron të jesh pronar i një biznesi.
- C) të zhvillosh një strategji për të minimizuar rreziqet.
- D) të eliminosh rreziqet.

Pyetja 104

Rreziqet e kontrollueshme janë:

- A) të parandalueshme.
- B) të sigurueshme.
- C) të lehta për t'u identifikuar.
- D) të pamundshme për të ndodhur.

Pyetja 105

Cili është elementi i vetëm i "marketingut miks" që gjeneron të ardhura direkt?

- A) Produkti
- B) Promocioni
- C) Vendi
- D) Çmimi

Pyetja 106

Faktorët e brendshëm të kompanisë që ndikojnë në vendosjen e çmimeve të produkteve përfshijnë?

- A) Natyra e tregut
- B) Strategjitë e marketingut miks
- C) Konkurrenca
- D) Faktorët ekonomikë

Pyetja 107

Cila nga këto është një metodë për caktimin e çmimit të produktit bazuar në kosto?

- A) Metoda e pikës kritike
- B) Çmimi FOB
- C) Çmimi sipas zonave
- D) Çmimi uniform

Pyetja 108

Cili është një nga objektivat kryesore të kompanive në lidhje me çmimin e produkteve?

- A) Mbrojtja nga konkurrenca
- B) Ulja e kostove
- C) Reduktimi i buxhetit
- D) Rritja e stokut

Pyetja 109

Çmimi i produktit sipas shtesës mbi koston përfshin?

- A) Vetëm koston totale
- B) Koston totale dhe normën e fitimit
- C) Vetëm normën e fitimit
- D) Vetëm koston fikse

Pyetja 110

Një nga avantazhet e metodës së shtesës mbi koston në vendosjen e çmimit të produktit është?

- A) Ndhmon në uljen e kostove
- B) Ndhmon në krijimin e strategjive të marketingut mik
- C) Ndhmon në vendosjen e një norme fitimi për produktin
- D) Ndhmon në analizën e konkurrentëve

Pyetja 111

Cili faktor i jashtëm ndikon në çmimin e produkteve?

- A) Strategjitë e marketingut mik
- B) Kostot fikse
- C) Faktorët ekonomikë
- D) Faktori organizativ

Pyetja 112

Kur kompania vendos për nivelin e çmimit të produkteve, cilin faktor duhet të ketë parasysh?

- A) Një sërë faktorësh të brendshëm dhe të jashtëm
- B) Vetëm kostot
- C) Vetëm konkurrencën
- D) Vetëm objektivat e marketingut

Pyetja 113

Cili është një objektiv i zakonshëm i politikave të çmimeve të kompanive?

- A) Reduktimi i prodhimit
- B) Maksimizimi i fitimeve
- C) Rritja e kostove
- D) Ulja e të ardhurave

Pyetja 114

Kur konsumatorët perceptojnë se çmimi është më i madh se vlera e produktit, ata?

- A) Do ta blejnë produktin
- B) Do të rrisin kërkesën
- C) Nuk do ta blejnë produktin
- D) Do të rrisin ofertën

Pyetja 115

Cila nga këto është një metodë për caktimin e çmimit bazuar në vendndodhjen e blerësit dhe shitësit?

- A) Çmimi në bazë të kërkesës
- B) Metoda e shtesës mbi koston
- C) Metoda e pikës kritike
- D) Çmimi sipas pikave bazë

Pyetja 116

Metoda e vendosjes së çmimit sipas metodës së shtesës mbi koston ndihmon në?

- A) Caktimin e çmimeve bazuar në kërkesë
- B) Analizën e konkurrentëve
- C) Vendosjen e një norme fitimi për produktin
- D) Analizën e tregut

Pyetja 117

Një nga detyrat e drejtuesit të marketingut është:

- A) Menaxhimi i departamentit të prodhimit.
- B) Mbikëqyrja e vazhdueshme e ndryshimeve të mjedisit të marketingut.
- C) Mbikëqyrja e departamentit të financës.
- D) Menaxhimi i burimeve njerëzore.

Pyetja 118

Qëllimi i tërë sistemit të dhënies së vlerës është:

- A) Të rrisë fitimet e kompanisë.
- B) Të krijojë marrëdhënie të forta me klientët.
- C) Të sigurojë furnizime të lira.
- D) Të ulë koston e prodhimit.

Pyetja 119

Një nga funksionet e ndërmjetësve të marketingut është:

- A) Kërkimi i klientëve.
- B) Prodhimi i mallrave.
- C) Menaxhimi i buxhetit.
- D) Zhvillimi i teknologjisë.

Pyetja 120

Klientët industrialë janë:

- A) Tregje që blejnë mallra për përpunim të mëtejshëm.
- B) Konsumatorët përfundimtarë.
- C) Agjensitë qeveritare.
- D) Grupi që ndikon në të ardhurat e ndërmarrjes.